

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 SHTATOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 18. SEPTEMBRA 2003.

Shtator – Septembar
2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВО
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i situatës politike në Kosovë,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale (2003/17),
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inspektoratin sanitar (2003/24),
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 25 shtatorit 2003:
 - 5.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe mjedisit të punës (2003/20),
 - 5.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike (2003/25).

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Разматрање политичке ситуације на Косову,
3. Прво разматрање Нацрта закона о медицинским производима и медицинску опрему (2003/17),
4. Прво разматрање Нацрта закона о санитарној инспекцији (2003/24),
5. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 25 септембра 2003 године :
 - 5.1 Друго разматрање Нацрта закона о заштити на раду, заштиту здравља и животне средине (2003/20),
 - 5.2 Прво разматрање Нацрта закона о измени и допуни Закона о менаџирању јавним финансијама (2003/25).



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting,
2. Review of the Political Situation in Kosovo,
3. First reading of the Draft Law on Medical Products and Medical Equipments (2003/17),
4. First reading of the Draft Law on Sanitary Inspectorate (2003/24),
5. Proposal of the agenda for plenary session on 25 September 2003 :
 - 5.1 Second reading of the Draft Law for Health Insurance and Safety working environment (2003/20),
 - 5.2 First reading of the Draft Law on changing and completing of the Law on Management of Public Finances (2003/25).

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR 18 SHTATOR 2003

Seanca Plenare u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal –
Prishtinë.

SEANCËN E KRYESOI, AKADEMIK NEXHAT DACI,
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.

BASHKËKRYESUES, HYDAJET HYSENI, ANËTAR I
KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirëseerdhët në Seancën e rregullt plenare.

Rendi i ditës dhe materialet tjera të nevojshme për këtë Seancë ju janë dorëzuar
me kohë.

Prandaj po fillojmë me pikën e parë – Miratimi i Procesverbalit nga Seanca e
kaluar.

Nëse ndokush ndien nevojë që edhe gojarisht të bëjë ndonjë vërejtje, le të
urdhërojë. Zoti Saviq e ka fjalën.

GOJKO SAVIĆ:

Poštovani predsedavajući, drage kolege poslanici,

S obzirom da je predsednik rekao da je materijal dobijen na vreme, i tako dalje, ja sam žele u tom pravcu da nešto kažem. Prilikom ulaska, vi ste videli da smo mi ovog trenutka stigli svi u transporterima i ušli neposredno posle vas. Poštanski fahovi su na nekom drugom mestu. Niko od nas nema materijal za današnju sednicu. Ja predlažem... Verovatno je to u poštanskim fahovima. Međutim, nas transporteri voze direktno u ovu zgradu i direktno u ovo dvorište. Ja predlažem da napravimo pauzu od pola sata, da mi pokupimo naše materijale da bi smo mogli da učestvujemo u raspravi, jer mi praktično nemamo ni dnevni red. Hvala.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Të falemnderit, zoti anëtar i Kryesisë. Unë nuk jam “predsedavajuqi”, por jam kryetar, ndërsa materialet të gjitha janë të vjetra, sepse në shqyrtim janë ligjet. Në shqyrtim është pika e parë e rendit të ditës dhe është e njohur nga seanca e kaluar. Do të mundohemi që Sekretaria vërtetë t’na ndihmojë në këtë. Megjithatë, ne po vazhdojmë me rendin e ditës.

Meqë nuk ka vërejtje në Procesverbal, por nëse ndokush ka vërejtje, ato le t’i bëjë me shkrim, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i situatës politike në Kosovës.

Zoti Sabri Hamiti, udhëheqës i Grupit Parlamentar të LDK e ka fjalën.

Ndërkohë, ju lus, që celularët t’i ç’kyçni të gjithë!

SABRI HAMITI:

Zotni kryetar i Kuvendit të Kosovës, kolegë të çmuar e të nderuar,

Situatën politike në Kosovë tashpërtash e përcaktojnë një qeverisje dykrenëshe – në mes të UNMIK-ut dhe institucioneve të Kosovës, një ekonomi në mbrapambetje dhe një gjendje sociale që mund t’shpërthejë. Kompetencat dhe përgjegjësitë në këtë qeverisje nuk kanë një drejtpeshim. UNMIK-u ende pretendon të ruajë apo rrisë kompetencat. Në anën tjetër, institucionet e Kosovës, mbajnë përgjegjësinë para qytetarëve, duke pretenduar t’i marrin edhe kompetencat. Ky raport i pazgjidhur, sikur ka mbështetje në dokumentet sistimore, në veçanti, në Rezolutën 1244 dhe në Kornizën kushtetuese. Në anën tjetër, zhvillimet politike dhe shoqërore në Kosovë, kanë provuar prej dite në ditë që Rezoluta 1244, duke lënë Kosovën pa status të përcaktuar politik, pandërmjetshëm pengon zhvillimin e saj. Po kështu, Korniza kushtetuese, është

tepër restriktive përballë nevojave të qeverisjes dhe vetëqeverisjes së Kosovës. Këto raporte ndihen edhe në jetën e përditshme të qytetarëve në të gjitha fushat e jetës. UNMIK-u rezervon për vete kontrollin e fushave më vitale të qeverisjes dhe të zhvillimit të shoqërisë, përfaqësimin politik, financat, drejtësinë dhe sigurinë. Në të gjitha këto fusha, përfaqësuesit vendas nuk e kanë fuqinë e vërtetë të veprimit përpos retorikës për zhvillimin e shoqërisë përpara. Në anën tjetër, në po këto fusha, shihen problemet më të ndieshme që kanë të bëjnë me statusin, me qeverisjen dhe me jetën e qytetarëve të Kosovës. UNMIK-u nuk e ka shtrirë pushtetin e vet në gjithë territorin e Kosovës, duke lejuar organizime paralele pushtetore në veri të Mitrovicës dhe në enklava, edhe pse, në anën tjetër, është i siguruar një përfaqësim madje joprofesional i serbëve në institucionet e Kosovës. Drejtpërdrejt me këtë situatë lidhet gjendja e sigurisë në tërë Kosovën, e cila është e kushtëzuar nga ndërhyrjet e pakontrolluara nga jashtë dhe nga zhvillimet e tensionet e brendshme. Kjo ka prodhuar edhe lloje të krimeve të cilat, në rastet më të shpeshta, janë evidentuar dhe janë dënuar me fjalë, mirëpo nuk janë zbuluar dhe sjellë para drejtësisë autorët e tyre ose rrjeta e tyre.

Kontrollimi joracional i financave, përballë nevojave imamente të fushave të ndryshme të jetës në Kosovë, po krijon suficitin e buxhetit. Në anën tjetër, shtresa të tëra të njerëzve janë në gjendje sociale të padurueshme, diku-diku para shpërthimit.

Kjo situatë kërkon një marrëveshje, pa humbur kohë, ndërmjet UNMIK-ut dhe Qeverisë, për të marrë – e dyta, kompetencat e domosdoshme për ta qeverisur vendin. Kjo duhet të bëhet menjëherë e jo të humbet koha, siç ka ndodhur që nga fillimi i vitit e deri më tash. Ky kalim kompetencash është i domosdoshëm dhe duhet të bëhet qoftë në nivel që i lejon Korniza kushtetuese ose nëse jo – edhe të ndërmirren hapa institucional për ndryshimin e saj që duhet të bëhet në këtë Kuvend.

Me një fjalë: statusi i tashëm i papërcaktuar politik i Kosovës, është bërë pengesë për zhvillimin dhe për demokracinë e saj. Standardet e shpallura nga UNMIK-u, si faza që duhen të kalohen para statusit, janë bërë gati formulë retorike, e pazbërthyeshme në praktikë. Çështja jështë: kush i shpallë standardet, kush i realizon dhe kush e vlerëson këtë realizim.

Nëse të gjitha standardet bien në fushën e pushteteve të rezervuara të UNMIK-ut, atëherë fuqia e veprimit të institucioneve të vendit për to dhe rreth tyre – është shumë e vogël.

Në këtë mënyrë Kosova do të bëhet peng i kërkesave, të cilat nuk varen nga kompetencat dhe fuqia e saj. Ato vetëvetiu bëhen jo udhë për ta gjetur, por pengesë për ta arritur statusin. Duhet qartësi, afat e saktësi për të provuar në jetë, në mënyrë operacionale, kërkesat e parashtruara.

Tensionet në Kosovë, në mënyrë permanente i shton ndërhyerja e Serbisë, e cila bëhet në mënyra të ndryshme, por më së shpeshti duke instrumentalizuar politikisht qytetarët serbë në Kosovë, madje edhe në institucionet e vendit për politikën e tyre dhe në mënyrë të organizuar shtetërore duke aprovuar dokumente kushtetuese për ta bërë aneksimin e Kosovës.

Bashkësia ndërkombëtare, deri më tash, ka reaguar tepër dobët, për të mos thënë – pahetueshëm kundrejt këtij agresiviteti kushtetues të unionit Serbi – Mali i zi dhe të Serbisë. Është i domosdoshëm një artikulum i qartë i Këshillit të Sigurimit, i SHBA-ve dhe i BE-s për ç'vlerësimin juridik të këtyre deklaratave para se të kërkohet një stabilitet politik në Kosovë dhe në rajon.

Nga ana e tij, Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues, të gjitha këto i konsideroi pa asnjë vlerë për Kosovën dhe këtë e ka bërë deri më sot me rezolutat për paprekshmërinë e kufijve të Kosovës dhe për pavlerësinë e preambulës së unionit Serbi-Mali i zi. Këtë duhet ta rikonfirmojnë në çdo kohë dhe në çdo situatë. Ky është kuadri aktual politik e konstitucional kur po artikulohej kërkesat për një bisedim të mundshëm ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit lidhur me çështje të veçanta që kanë të bëjnë me nevojat dhe jetën e qytetarëve, në radhë të parë, duke pretenduar në një rrafsh tjetër një shtensionim në Kosovë dhe rajon.

Mirëpo, ky problem e ka edhe historinë e vet që është tepër e afërt. Serbia ka bërë një pushtim të Kosovës dhe ka ushtruar gjenocidin mbi popullin shqiptar.

Në Kosovë është organizuar rrezistenca – nga ajo paqësore e demokratike, duke kaluar në rrezistencë të armatosur deri në luftën për çlirim. Të gjitha këto zhvillime të domosdoshme dhe të detyrueshme, që lidhen me ekzistencën e një populli dhe të një vendi, të gjitha këto mësimet të historisë më të re, kanë dhënë përfundimet se Kosova ka të kushtëzuarën – ekzistencën e vet nga pavarësia e saj dhe demokracia e saj. Pa to është tepër utopik qëllimi për integritet të mëtejshme, qoftë në rajon qoftë në Evropë.

Çdo bisedim për një të ardhme, pra – duhet t'i ketë në evidencë e në kujdesë këto të dhëna të së tashmes dhe të së kaluarës së afërt të Kosovës. Po nuk u patën parasysh dhe në kujdes këto evidenca, të gjitha bisedimet bëhen të vështira, të pamundshme dhe në instancën e fundit – me përfundime vështirë të realizueshme.

Nëse bëhet prova për ardhmërinë, e kjo duhet të bëhet, atëherë duhet një përkufizim shumë i qartë: çfarë do të bisedohet; kush është garant i këtyre bisedimeve dhe kush është garant i zbatimit të rezultatit të tyre.

Situata politike e shoqërore në Kosovë dëshmon që dialogu me Beogordin nuk ka si të jetë prioriteti i institucioneve të saj. Zhvillimi ekonomik dhe gjendja sociale janë prioritete në rrafshin praktik të jetës për qytetarët e Kosovës. Zhvillimi i institucioneve dhe i demokracisë si dhe përfaqësimi i plotë në raportin ndërkombëtar, janë prioritete politike për qytetarët e Kosovës. Konteksti politik dhe shoqëror i Kosovës së sotme dhe i rrethinës së saj tregon se është vështirë të bëhen bisedime konkrete e praktike me Serbinë rreth nevojave të qytetarëve pa prekur ngjyrimin politik.

Prandaj, nëse është e domosdoshme të nisim bisedimet, atëherë duhet të përcaktohet sakt: niveli i barabart i përfaqësimit të të dy palëve; ndërmjetësuesit e besueshëm – SHBA dhe BEE dhe regjistri i sakt i problemeve që do të shqyrtohen, pastaj është punë për kompetentët e fushave të veçanta që do të shqyrtohen nga fushat e tyre.

Duhet të theksohet me këtë rast që, UNMIK-u apo Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në bisedimet eventuale Prishtinë – Beograd, nuk mund të shërbejë si ndërmjetës sepse përmga funksioni është pushtet dhe përfaqësues i Kosovës i nivelit ndërkombëtar.

Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues, do të ushtrojë kompetencat e veta në këtë proces, nëse ndodhë pra, duke ruajtur të drejtën e korrektimit të tyre, implusimit të tyre nëse ka nevojë, ndërprerjes së tyre nëse janë të padobishme apo, në fund të fundit - ratifikimin e tyre nëse janë në dobi të qytetarëve të Kosovës. E kemi fjalën gjithnjë për bisedime e marrëveshje për çështje teknike konkrete, të cilat në asnjë mënyrë nuk prekin dhe paragjykojnë statusin përfundimtar të Kosovës që përcaktohet nga vullneti politik i qytetarëve të saj.

Kuvendi i Kosovës, si dhe institucionet e tjera, duhet të marrin hapa të domosdoshëm institucional që të krijojnë statusin e saj me veprime, qoftë në jetën e brendshme shoqërore, politike e konstitucionale, qoftë në zhvillimet diplomatike. Duhet të shpërthehet situata e çuditshme e një izolimi që i bëhet Kosovës në vitet e fundit. Ka kaq shumë pushtet dhe përfaqësim ndërkombëtar në Kosovë dhe ka kaq pak përfaqësim të Kosovës dhe të institucioneve të saj në botën e jashtme. Është koha që varianta e gjendjes në Kosovë, që del nga institucionet e saj, të shkojë drejtpërdrejt në Këshillin e Sigurimit të OKB, në SHBA dhe në Bashkimin Evropian.

Lidhja Demokratike e Kosovës, duke i qëndruar besnike zbatimit të Programit të saj naciona, politik e qytetar, e pranon dialogun si metodë të zgjidhjes së problemeve shoqërore dhe politike, e mirëpret bashkëpunimin ndërkombëtar për zgjidhjen e të gjitha çështjeve që dalin në udhën e krijimit të Kosovës së pavarur

dhe demokratike. Veprimet politike që në çfarëdo mënyre pengojnë këto qëllime, nuk mund të kenë përkrahjen tonë.

I nderuari kryetar,

Unë që t'mos dal edhe një herë, në cilësinë e kryetarit të Komisionit për marrëdhënie ndërkombëtare, do të kumtoj përfundimet e mbledhjes së këtij Komisioni, të datës 8 shtator:

Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe Kuvendi i Kosovës, mbështetur në Deklaratën e mëhershme, i konsiderojnë të pavlefshme deklaratat e Serbisë dhe të Malit të zi dhe pretendimet e tyre për ta vënë Kosovën në kornizat e tyre kushtetuese, duke i konsideruar këto deklarata si agresion kushtetues ndaj Kosovës.

Komisioni fton Këshillin e Sigurimit të OKB, BE dhe SHBA që t'i shpallin të pavlefshme juridikisht deklaratat Serbi – Mali i zi, duke i konsideruar si dokumente agresive që destabilizojnë Kosovën dhe regjionin.

Komisioni konsideron se mund të bisedohet vetëm për çështje që, në asnjë mënyrë nuk prekin, nuk paragjykojnë statusin përfundimtar politik të Kosovës, që duhet të zgjidhet në bazë të vullnetit të qytetarëve të saj.

Komisioni konsideron se duhet të ketë pajtim të institucioneve të Kosovës, për të përfshirë Kuvendin e Kosovës rreth bisedimeve Prishtinë – Beograd. Bisedimet mund të bëhen vetëm në baza të barabarta të përfaqësimit dhe të statusit të palëve në bisedime.

Komisioni konsideron se Harri Hollkery, si Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm në asnjë mënyrë nuk mund të jetë ndërmjetësues në këto bisedime, sepse nuk e lejon statusi i tij i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB në Kosovë. Harry Hollkeri duhet të ketë kontakte të domosdoshme me Kuvendin dhe komisionet e veçanta rreth bisedimeve.

Pa ndërmjetësimin e fuqishëm të SHBA-ve dhe të BE, asfarë bisedimesh nuk do të kenë sukses dhe nuk do të mund të zbatohen. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të PDK, zoti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë, të nderuar ministra,

Sot po diskutojmë një çështje të rëndësishme dhe çështje mjaft aktuale rreth zhvillimeve aktuale politike dhe duhet të pretendojmë që si Kuvend, si organ që ka përgjegjësi edhe para popullit, por edhe para dokumenteve kushtetuese, të marrim qëndrime për sfidat që po kalon Kosova dhe të arrijmë një konsensus institucional dhe në një mënyrë të kemi pozicione shumë të qarta karshi sfidave në të cilat po kalon Kosova.

Në këtë kontekst, me qëllim të arritjes së një konsensusi institucional çfarë i duhet Kosovës për këto probleme me të cilat po ballafaqohet, ka qenë e domosdoshme që në këtë seancë të vjen kryeministri i Kosovës dhe kryetari i Kosovës, të cilët janë ftuar dhe unë, edhe një herë përsëris kërkesën e Grupit Parlamentar që për seancën e ardhshme të ftohen, të ftohen edhe formalisht këta dy udhëheqës të institucioneve të Kosovës për të marrë pjesë në diskutimin për zhvillimet aktuale politike, ashtu siç patëm rastin në mbledhjen e kaluar për të dëgjuar opinionet dhe qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare të shprehura përmes zotit Hollkery dhe Paten. Mendoj se kjo është e domosdoshme për shkak se, duke patur parasysh provokimet dhe sulmet që bëhen nga jashtë ndaj procesit dhe administrimit ndërkombëtar të Kosovës, ne duhet ta kemi një konsensus institucional dhe ta ndërtojmë një bazë të fortë për Qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera për t'u marrur me përgjegjësitë që kanë.

Mendoj se situata aktuale politike në Kosovë karakterizohet me disa veçori, me disa probleme. Unë do t'i veçoja tri më të rëndësishmet dhe shpresoj se ky Kuvend do të ketë vullnet dhe fuqi që për këto sfida të marrë qëndrime unike dhe në një mënyrë të obligojë edhe Qeverinë edhe institucionet tjera për t'i ushtruar përgjegjësitë që i kanë.

E para. Ka kohë që Kosova, gjithmonë po atakohet nga jashtë, sidomos nga Qeveria e Beogradit, e cila ka një interes të dyfishtë në Kosovë. Interesi i saj i parë, është për ta destabilizuar gjithmonë Kosovën, për ta ndalur rrugën e progresit të saj demokratik dhe, e dyta – për ta kompromituar edhe Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Dhe, Serbia, për ta arritur këtë qëllim, ka zgjedhur rrugën e provokimeve dhe agresioneve kushtetuese, duke tentuar që të prejudiojë statusin final, do të thojë, duke tentuar në një mënyrë edhe që të pengojë realizimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, pra përgatitjen e popullit të Kosovës që në një fazë të mëvonshme të vetëqeverisë veten, apo ta qeverisë plotësisht veten. Dhe, në këtë kontekst, këto veprime janë krejtësisht institucionale, sa i përket Serbisë, për shkak se ajo ka arritur të ndërtojë një konsensus institucional lidhur me Kosovën, të shprehur edhe në preambulën e kartës kushtetuese të unionit Serbi – Mali i zi, në deklaratën e

qeverisë... në memorandumit e kishës dhe sidomos në përgatitjen që po bën për ta miratuar kushtetutën e re serbe.

Mendoj se ky Kuvend, në proces, ka tentuar që në vetëmbrojtje t'i paralizojë këto provokime. Provokime që, po e përsëris, kanë qenë të dyfishta ndaj Kosovës, por edhe ndaj Misionit ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara. Dhe është e nevojshme që përsëri, ky Kuvend, të marrë një qëndrim që çdo përpjekje e tillë të jetë e pavlefshme në raport me Kosovën dhe të jetë inekzistent. Kosova ka rrugën e vet, rrugën e ecjes përpara bashkë me bashkësinë ndërkombëtare dhe rrugës drejt implementimit të vullnetit politik të popullit shumicë.

Mendoj se rreth kësaj çështjeje duhet të marrim përsëri një qëndrim dhe të rikonfirmojmë se deklarohen të pavlefshme këto përpjekje dhe përpjekjet e ardhshme që po bën Serbia.

Mirëpo, mendoj se në këtë drejtim, ne duhet të sqarohemi edhe me faktorin ndërkombëtar. Për shkak se faktori ndërkombëtar, përpos deklarimeve politike verbale që këto veprime nuk mund të prejjudikojnë statusin final, nuk kanë ndërmarrë veprime institucionale që kanë qenë të mundshme të ndërmerren, sidomos nga ata që këtu administrojnë Kosovën dhe ata që janë të obligueshëm ta mbrojnë procesin e Rezolutës 1244. Mendoj se ka pasë mundësi që edhe Këshilli i Sigurimit, edhe Bashkimi Evropian, dhe mekanizmat tjerë, që shprehimisht me mjete ligjore legale ta shpallin të pavlefshëm këtë tentativë të Serbisë dhe mendoj se ky Kuvend duhet të kërkojë që krahas përgjegjësisë sonë, reagimit tonë që do ta kemi që edhe bashkësia ndërkombëtare, me mjete ligjore, me mjete legale, të shpallë të pavlefshme dhe në një mënyrë ta ruajë procesin e finalizimit të administrimit ndërkombëtar.

Çështja e dytë, e cila është një gjenerator që gjithmonë po reprodukon kriza dhe po ngadalëson procesin e avancimit demokratik të Kosovës, padyshim është procesi i ngadalshëm i bartjes së përgjegjësisë.

Kaluan tani katër vite që Kosova është nën administrimin ndërkombëtar dhe akoma këtu nuk kemi vetëqeverisje substanciale, siç thotë Rezoluta 1244. Do të thoja, nuk kemi fare vetëqeverisje. Kemi një proces shumë të ngadalshëm të bartjes së kompetencave që në një mënyrë po e ngadalëson procesin e avancimit demokratik.

Mendoj se ka ardhur koha, meqenëse dy nga qëllimet strategjike të Rezolutës 1244 janë realizuar. Pra, qëllimi i parë – ndalja e luftës dhe qëllimi i dytë – ngritja e strukturës demokratike. Ato janë realizuar për shkak se sot kemi struktura demokratike në nivel të Kosovës dhe në nivel të komunave, ka kardhur koha që Kosova të përgatitet dhe të jetë e gatshme për fazën e tretë, pra fazën e definimit të statusit final dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK kërkoj nga

bashkësia ndërkombëtare, sidomos nga UNMIK-u që të fillojë menjëherë pashtyeshëm t'i bartë të gjitha kompetencat në mënyrë që të përgatitet zgjidhja e statusit final të Kosovës.

Mendoj se në këtë drejtim, është e domosdoshme që, pashtyeshëm, të bëhen ndryshime legale dhe konstitucionale në atë mënyrë që duhet të ndryshohet Korniza kushtetuese dhe të kompletohet struktura qeveritare e Kosovës; t'i mundësohet këtij Parlamenti demokratik që të bjerë ligje sistemore, ligje organike, të cilat i duhen Kosovës; t'i mundësohet ndërtimi i një sistemi të pavarur gjyqësor dhe një sistemi të sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë. Në këtë drejtim, shpresoj se do të kemi mirëkuptim të bashkësia ndërkombëtare dhe mendoj se vetëm në atë rast kur institucionet e Kosovës marrin kompetenca dhe përgjegjësi ato janë më të afta dhe më të përgjegjshme edhe për situatën, edhe për luftimin e krimit dhe për zhvillimet tjera negative që, mendoj, riprodukohen edhe nga ky cungim i kompetencave të organeve të Kosovës.

Dhe, çështja e tretë, që është mjaft aktuale dhe për të cilën sot në emër të Grupit Parlamentar të PDK kërkojnë qëndrim të qartë të Kuvendit, është çështja e të ashtuquajturave kontaktet e para midis Kosovës dhe Serbisë. Pra, një proces që shumë po përfolet, një proces që kërkon qëndrim institucional, jo qëndrim politik, jo dhënie të deklaratave pompoze, por një seriozitet të këtij Kuvendit, në mënyrë që vërtetë këtu të ndërtojmë një bazë të mirë dhe të sqarohen shungjëra.

Unë mendoj se këto kontakte po imponohen në një kontekst shumë të papërshtatshëm për Kosovën. Pra, në një kontekst, kur Kosova ballafaqohet me shumë probleme, të cilat i përmenda, pra: atakimet që bëhen nga jashtë; mungesa e kompetencave; mosfrimi i garancioneve që këto kontakte duhet të jenë vërtetë të përgatitura mirë dhe të kenë një ndërmjetësues të fuqishëm, një ndërmjetësues i cili ka fuqinë jo vetëm të përgatitjes por edhe të implementimit të rezultateve.

Njëkohësisht, të ashtuquajturat bisedat teknike krijojnë një konfuzion për shkak se akoma nuk kemi një agjendë të qartë se cilat do të jenë temat e këtyre kontakteve. Në fakt, shumica e atyre çështjeve që janë dëgjuar në media, nuk kanë të bëjnë me çështje teknike, por do të thoja janë çështje sistemore dhe substanciale, të cilat kanë dhe reflektojnë në statusin final të Kosovës.

Për këtë arsye, unë angazhohem që Kuvendi i Kosovës sot të debatojë gjerësisht për nevojën – ka apo s'ka nevojë Kosova të hyjë në këto bisedime. Ne nuk do të bijmë nën presionin e presioneve për të hyrë në këto bisedime. Ne si organ më i lartë kemi përgjegjësinë për të vendosur se – janë pjekur apo s'janë pjekur kushtet. Dhe në qoftë se këtu ekziston një shumicë apo një vullnet i shumicës që megjithatë janë pjekur kushtet për këto kontakte, atëherë ne duhet, si organ ligdhënës, por edhe si organ më i lartë në Kosovë, të obligojmë Qeverinë, që

është organ që e kemi zgjedhë ne, pra një qeveri tipike parlamentare, jo një qeveri e kabinetit, siç po interpretohet nganjëherë në media; një qeveri që është zgjedhë nga ky Kuvend dhe që i përgjigjet këtij Kuvendi, por edhe kryetarin e Kosovës që, në frymën e Kornizës kushtetuese, ka disa kompetenca ndërkombëtare – që ata të vijnë, të prezentojnë opinionet dhe platformën e tyre se si li shohin këto bisedime.

Mendoj që këtu duhet të veprojmë bashkë. Nuk mund të lëmë vetëm Qeverinë, Kuvendin apo kryetarin. Këtu duhet të reflektojmë një rezon se kjo është çështje unike, çështje konsensuale, që don konsensusin institucional por do të thojë edhe politik të partive parlamentare, sidomos të partive që kanë ndërtuar koalicionin qeveritar.

Kështu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK kërkoj që, sot Kuvendi të deklarohet se është apo s'është për bisedime në këtë kontekst politik për të cilin fola dhe në qoftë se ekziston një vendim pozitiv, atëherë ta obligojmë Qeverinë, në mënyrë të pashtyeshme të vjen këtu në Kuvend, ashtu siç është vepruar edhe me parlamentet tjera serioze dhe të shprehë njëllor platforme initiale në mënyrë që ne të jemi në proces qënga fillimi.

Çështja e fundit, për të cilën dëshiroj të diskutoj, është çështja e përgatitjes së këtij Kuvendi, do të thojë të Kosovës dhe institucionet e Kosovës për të qenë faktorë i finalizimit të statusit final të Kosovës.

Unë përmenda edhe në pjesën ku fola për transferin e kompetencave. Unë mendoj se ky Kuvend duhet të përgatitet tani që ta ushtrojë përgjegjësinë që ka, përgjegjësinë e dyfishtë: përgjegjësinë para elektoratit, i cili na ka dhënë besimin dhe na ka dhënë legjitimitetin demokratik, por edhe përgjegjësinë ligjore që të përgatitet për të qenë subjekt i finalizimit të statusit final të Kosovës. Dhe, në këtë drejtim, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kërkoj që të fillohet puna në përgatitjen e bazës së re kushtetuese, një baze plotësisht të re kushtetuese, e cila nënkupton Kosovën pa kufizime, pa kufizime ekzistuese dhe në një mënyrë të përgatitet që me një proces të deklarimit demokratik vetë të përcaktojë statusin final dhe pastaj Kosova do't është plotësisht e përgatitur për çdo proces të negociatave. Pra ne, atëherë bëhemi vërtetë faktorë të negociimit për implementimin e asaj që vendosë ky Kuvend dhe që vendosë populli në një referendum të ardhshëm. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Përnga numri i ulëseve në Parlament, grupi i tretë është "Kthimi". Zoti Ivanoviq, në emër të "Kthimit".

OLIVER IVANOVIĆ:

Poštovane kolege,

Nesumnjivo da smo ovu temu – pitanje političke situacije ali i bezbednosne situacije mogli postaviti nešto ranije i mislim da bi diskusija razvijala u jednom drugom pravcu. Nikad nije kasno i u ovom trenutku uoči... očigledno već spremnih i dogovorenih razgovora sa Beogradom možemo razgovarati o tome šta zapravo ti razgovori znače za sve nas, šta znače za privremene institucije, šta znače za običan narod, šta znači zapravo za nekakvu našu budućnost. Ja mislim da imamo godinu i po dana staža u ovom Parlamentu, što znači da bi odgovornost za svoju ulogu, za svoj posao, odgovornost prema onima koji su nas birali treba da bude prioritet i osnovni princip kojim se rukovodimo. Mislim da smo u dosadašnjem periodu, počev od predizborne kampanje 2001. godine pa do danas uglavnom se rukovodili nekakvim euforičnim idejama i nekakvim idejama koje su nacionalne i romantičarske i koje sigurno neće vući dalje. Teško je suočiti se sa tim ali pre ili kasnije, mislim moramo se suočiti sa tim. Mislim da se to zove odgovornost prema onome ko nas je birao ili odgovornost prema budućnosti svoje dece, svoje porodice, svog naroda a to ponekad nije lako.

Ja bih rekao da, u kontekstu svega ovoga ne možemo zaboraviti da smo kroz zadnja dva ili tri meseca prošli kroz vrlo težak period. Ja to moram da kažem u ime zajednice koju predstavljam, da je osam ubijenih Srba svakako nije dobra atmosfera za ove razgovore koji nam slede. Najgore od toga je što mi nismo kao institucija jasno i nedvosmisleno osudili to, što kao institucija nismo jasno i nedvosmisleno dali podršku UNMIK-policiji i Kosovskoj policijskoj službi da preduzme mere i na taj način pozvali stanovništvo da pomogne i saraduje u razrešavanju ovog zločina kao i mnogih drugih zločina koji su se dogodili od 99. godine naovamo. Namerno kažemo 99. godine odkada postoji međunarodna misija ovde, koja je tu došla da sredi stvari, da razreši neke naše probleme, jer očito se nismo mogli dogovoriti ni međusobno bez posrednika.

Kako sad stoje stvari, ni razgovori sa Beogradom ne idu bez posrednika, i nama će trebati posrednici i možda je dobro. Potrebni su nam autoriteti koji će svojom... pre svega svojim ugledom, svojim značajem u međunarodnom i političkom svetu dati pečat koji će dati garancije za ono što se međusobno dogovorimo da se to moramo i da sprovedemo.

Ja bih rekao da, kod većine kolega u Parlamentu, s njima više kontaktiram nego s onima u Vladi, se oseća određena nesigurnost, određena rezerva. Pa, mogu da kažem, i strah od ovih razgovora. Ja to zovem strah od odgovornosti. Mi nismo izabrani ovde..., ja sam to već rekao jedanput, zato što smo lepi, niti što smo, ne znam dobri. Nego zato što smo pametniji od drugih ili što treba da artikulišemo zahteve svoga naroda. To znači da treba da mislimo unapred. Da vidimo šta

zapravo ovim razgovorima možemo da postignemo. Poboljšanje uslova života za običan narod; stvaranje uslova za smirivanje tenzija; postizanje nekog političkog koncenzusa koji će neminovno voditi ka nekim pitanjima koja su za nas važna, a to je borba protiv organizovanog kriminala, nezaboravljajući normalno na sav onaj drugi opšti kriminal koji nam se događa, etnički motivisani - onaj kome mi dajemo poseban značaj; stvaranje uslova za povratak onih koji su raseljeni. Nedavno nam je ovde Kris Paten rekao upravo to. Ono što ne smemo zaboraviti to je da alfa i omega svake demokratije, pogotovo onih koje se nazivaju nove demokratije nekakva multietničnost, koja po meni, u ovom trenutku vrlo teško ostvarljiva ili nije ostvarljiva na način koji bi zadovoljio sve one koji ovde žive. Ali nije nemoguća. Nije nemoguća u nekakvoj perspektivi, nekakvoj perspektivi koja bi stvorila uslove za nekakav ekonomski napredak. Ekonomski napredak se kreira ukidanjem granica a ne stvaranjem novih granica. Ekonomski napredak se kreira stvaranjem uslova da onaj koji sa strane namerava da donese novac i investira ovde bude siguran da će taj novac moći da izvuče za godinu ili pet. Ekonomski napredak se kreira tako što će stvoriti ambijent, u kome, budući i mogući investitor neće razmišljati o tome da li će mu nekakva politička pobuna i promena ugroziti ono što je uložio. To su putevi kako se ekonomski napredak stvara i po meni, treba da dodam tome, da mora da računa da lobi jedan i drugi, oružana jedinica jedna ili ldruga neće da ugrozi njegovu fabriku.

Mi možemo zatvarati oči, možemo jednostavno pričati najbolje o situaciji na Kosovu i metohiji, ali ne zaboravite da se kriminal događa i da je vrlo organizovan, da postoje organizovane jedinice... naoružane jedinice koja ovde deluju mimo onih jedinica koje bi to trebale da rade a to su vojska, KFOR, UNMIK-policija i Kosovska policijska služba. To ugrožava i vašu decu. Nemojte zaboraviti da ćete pre ili kasnije postati žrtve vi. Bojim se da do tog trenutka mi možemo da napravimo mnogo propusta, da izgubimo mnogo vremena a da ne napravimo nijedan potez koji bi mogao da nas vodi u nešto što mi zovemo ekonomski prosperitet.

Malo oko ovih razgovora. Ja ne vidim puno razloga da se ustručavamo zbog toga. Teme koje su stavljene na dnevni red nesumnjivo da ne ostavljaju mesto za bilo kakvu politizaciju. Mislim da su pažljivo birane bar za sada, ne znači da su i usaglašene te teme i treba da budu usaglašene i treba da privremene institucije daju svoje mišljenje o tome. Te teme će pomoći da ... uzeću jednu, samo prvu, to je enerģetika. Vama je valjda jasno da mi ovu zintu ne možemo prezimiti ukoliko ne budemo uvozili struju. Zar je logično da strujuj izvozimo... uvozimo iz Italije ili da je uvozimo iz Rumunije ako nam je tu na dohvat ruke. Uostalom, jedna vrlo dobra saradnja, postojala je i ranije između delova sistema elektroprivrede Srbije i elektroprivrede koja deluje u pokrajini. Zar je logično da telekomunikacija, da poziv iz Mitrovice za Prištinu putuje preko Kraljeva, Kragujevca, Niša i Gnjilana, zar nije logično da on putuje direktno. To su

problemi koji mogu da se razrešavaju. Čini mi se da će se uz to otvoriti teme koje su jako osetljive, to je pitanje povratka, jer u jednoj euforiji koja postoji u jednom rekao bih prilično agresivnoj euforičnoj atmosferi se na direktan ili indirektan način sprečava povratak Srba. To nije održivo i nije trajno. To nije rešenje, jer tako i na taj način se ne mogu stvoriti uslovi za nezavisno Kosovo. To budite ubeđeni. I to sigurno neće uticati na konačan status.

Oko gospodina Hollkera, je neko pomenuo njegovo učešće. Ja se u neku ruku slažem. Ne može i ne treba on da bude medijator. On je predstavnik međunarodne zajednice ovde koja drži i još uvek kontroliše određeni deo rezervisanih, takozvanih rezervisanih prava. Mislim da on treba da bude deo delegacije. I on treba da bude taj deo delegacije jer samo sa njim u delegaciji privremenih institucija mi imamo garancije da će sve što se dogovori moći da bude i ostvarena, implementirana.

Što se medijatora tiče, to će očigledno biti G-8, ne u ličnosti jednog čoveka, nego... Kontakt Grupa, pardon. Znači ne u ličnosti jednog čoveka nego u ličnosti jedne čitave delegacije. Mislim da malo sa više optimizma treba da u te razgovore da uđemo. Spremiti svakako delegaciju koja će moći dostojno da reprezentuje privremene institucije, ne jednu etničku zajednicu nego privremene institucije sa svim onim što se pod tim podrazumeva, koja će da pripremi dnevni red i koji će biti prihvatljiv, koncenzusom prihvatljiv i mislim tako ohrabreno inače delegacija može jednostavno dostojno da reprezentuje i institucije i narod koji ih je izabrao.

Ja verujem da sa tim ne treba otezati, ne treba o dlagati jer to samo može da zaoštri atmosferu. A oni koji su, nerealnim obećanjima svoje birače u izvesnom smislu doveli u zabludu oni će se sa tim suočiti na sledećim izborima ali do tih izbora može da prođe još godinu dana. Mada, ja u ovakvoj situaciji, ako privremene institucije ne budu bile spremne da nose odgovornost, ja sam mišljenja da mi treba da organizujemo vanredne izbore. Neki drugi ljudi će možda moći da nose tu odgovornost. Hvala vam.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Zoti Ramush Haradinaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

RAMUSH HARADINAJ:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Tema e cila po trajtohet sot në Parlamentin e Kosovës është shumë me rëndësi dhe ky diskutim vjen po ashtu në një moment të rëndësishëm por edhe të ndieshëm për procesin në të cilin ne ndodhemi.

Kur flasim për situatën politike, mendoj se është mirë të bëhet një vështrim i situatës së përgjithshme në Kosovë.

Para se të filloj me atë që mendoj se është me rëndësi që edhe Parlamenti i Kosovës të nxjerrë edhe vlerësimet e veta, dëshiroj të theksoj se situata e sigurisë në Kosovë, është stabile, ku përjashtim bën vetëm veriu i Kosovës dhe për këtë natyrshëm sepse populli i Kosovës bashkë me bashkësinë ndërkombëtare, me mekanizmat që shërbejnë në Kosovë kanë arritur rezultate të qëndrueshme.

Ajo që sot del para nesh, me të gjitha format e veta, është një gjendje ekonomike dhe e vështirë, një infrastrukturë e vjetëruar në Kosovë, një papunësi e madhe dhe si rezultat i kësaj edhe një gjendje sociale që është e vështirë, për shumë kategori të qytetarëve tanë.

Mendojmë se e tërë kjo do të ishte më lehtë e përballueshme në rast se Kosova do të ndodhej në situata të veprimit të plotë me përgjegjësitë, gjegjësisht me instrumentet e nevojshme për veprim. Andaj, ajo që na shqetëson më së shumti është një ngecje në ndërtimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës. Pra, konkretisht një ngecje që ka pasuar në kompletimin e Qeverisë së Kosovës, pra në ndërtimin e kapaciteteve të plota për institucionet e Kosovës dhe avancimin e bazës kushtetuese. Si rezultat i kësaj, populli i Kosovës, është mendim imi dhe i Aleancës, po zbehë besimin e vet në qendrat e vendosjes dhe kësaj edhe në njerëzit e zgjedhur të Kosovës. Andaj, veproj se veprimi më efikas dhe i vetmi që do t'i ndryshonte rrethanat për të mirë në Kosovë është ndërtimi i vullnetit politik të popullit të Kosovës, nënkupton hapat që do të ndërmerren për këtë. Rolin kyç për këtë e kanë institucionet e Kosovës, veçanërisht Parlamenti dhe Qeveria.

Ne, si njëri nga partnerët në koalicionin qeverisës në Kosovë, pra kemi ofruar opcionin për hapat konkret në ndërtimi në vullnetit politik të popullit të Kosovës, duke propozuar edhe veprimin e parë për këtë, pra shpalljen e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur në Parlamentin e Kosovës.

Mendojmë se kryerja e këtij veprimi dhe marrja e angazhimeve për veprime të mëtutjeshme sot janë të domosdoshme dhe konsiderojmë se vonesat, në këtë drejtim, janë duke na sjellë dëme në Kosovë.

Si partnerë qeverisë, jemi të gatshëm dhe ftojmë partnerët tanë, në këtë rast partitë politike vendore, që të bashkëveprojmë në shpalljen e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur dhe gjithësesi që ta aprovojmë planin për veprim që do të nënkuptonte planin për implementim të vullnetit politik të popullit të Kosovës, vullnet ky i shprehur, i definuar edhe më përpara.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në vazhdimësi ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunimin e ndërsjellë me faktorët vendor dhe me përfaqësuesit e pakicave, të cilat i konsiderojmë si partnerë shumë të dobishëm në procesin në të cilin ndodhet Kosova. Po ashtu, ne shprehim gatishmërinë për bashkëpunimin e mëtutjeshëm për zgjidhjen e çështjeve dhe të preokupimeve të ndërsjella tonat këtu në Kosovë.

Bashkëpunimi i mirë me bashkësinë ndërkombëtare ka shënuar edhe të arritura dhe rezultate. Kur ky bashkëpunim ka qenë i mirë, kemi të arritura të përbashkëta. Mirëpo, mendoj se ngecjet në bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe të UNMIK-ut kanë shkaktuar edhe pasojat e para për procesin. Nuk bëjmë mirë që t'i fshehim dhe që të mos i shprehim ato.

Në Kosovë janë vërejtur ngecje, sidomos në atë që është kuptuar si proces i ndërtimit të mëtutjeshëm të institucioneve të Kosovës. Pra, që nga pikënisja, që ka qenë Korniza kushtetuese, nuk shënuar asnjë e arritur tjetër. Bile mund të konstatojmë se edhe ajo pikënisje nuk është zbatuar. Po ashtu, mendojmë se baza kushtetuese, e cila ka qenë vetëm si pikënisje, nuk i shërben dhe nuk plason më tutje atë që do të nënkuptonte bazë kushtetuese për zhvillim normal të procesin në të cilin ndodhet Kosova. Mendojmë se i takon vetë UNMIK-ut që të bëjë një vështrim të angazhimeve të veta të deritashme që t'i konstatojë të arriturat, por edhe ngecjet dhe po ashtu që të japë propozimin konkret për dalje apo për zgjidhje të shumçështjeve që kanë mbetë të pazgjidhura në Kosovë. Ndërsa ajo që personalisht mua, por edhe Aleancën na habitë shumë, është një angazhim i UNMIK-ut i ç'orientuar në këto momente. Pra, është një dezorientim në angazhime. Është e çuditshme se si UNMIK-u dhe zoti Hollkeri gjithë angazhimin e vet, që nga ardhja në Kosovë, e ka vetëm për një çështje në agjendën e vet – çka do të ndodhë në mes Prishtinës dhe Beogradit. Pra, për bisedat Prishtinë – Beograd.

Ne e mendojmë këtë çështje të rëndësishme, pra i japim rëndësinë e vet por po ashtu nuk mund të kuptojmë se si UNMIK-u, gjatë gjithë kohës, angazhimin e vet e orienton në këtë çështje. Mendojmë se është tejkalim dhe është anashkalim

i angazhimeve primare dhe në këtë mënyrë po i ikë asaj që është qenësore – çka do të ndodhë në Kosovë, çka do të bën UNMIK-u me Prishtinën.

Mendojmë se, që të ketë sukses angazhimi dhe ndihmesa që jep UNMIK-u për një çështje të tillë të bashkëpunimit ose të shkëmbimeve Prishtinë - Beograd, në radhë të parë UNMIK-u duhet të shënojë të arritura ose suksese në bashkëpunimin UNMIK – Prishtinë. Pra, që të vazhdohet në proces i filluar më përpara.

Ne, si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, nuk mund dhe nuk do t'i japim mbështetje një angazhimi të këtillë, i cili lë anash angazhimet e përbashkëta për ndërtimin e mëtutjeshëm të institucioneve të Kosovës dhe avancimin e bazës kushtetuese. Pra, jemi partnerë për bashkësinë ndërkombëtare, jemi partnerë për UNMIK-un, por përderisa ajo që është primare ...(?)... lihet anash që të ketë ndihmën tonë, mbështetjen, UNMIK duhet të shënojë të arritura në Kosovë. Pra, duhet që Qeveria e Kosovës të kompletohet me ministritë e nevojshme dhe kësaj ne të aftësohemi për bashkëpunim me Beogardin por jo vetëm për këtë, edhe për zhvillim normal të jetës në Kosovë. Në këto rrethana ne do të mund të ishim t'suksesshëm për bashkëpunim edhe me bashkësinë ndërkombëtare.

Mendoj se ne duhet të përballemi me veten, veçanërisht partitë politike që janë nënshkruese të koalicionit qeverisës dhe duhet t'i dalim zot vetes në këto rrethana, në të cilat ndodhemi.

Një e thënë që vlenë për ne nga jeta që na është dëshmuar – ne duhet ta ndihmojmë vetëveten për me qenë t'zot me i ndihmuar të gjithë tjerëve që janë të interesuar për ne. Pra, të bëjmë hapa konkret.

Që të kuptohemi drejt dhe që të mos ketë ndonjë keqkuptim: Mendimi i Aleancës është që ne bisedat me Beogardin nuk i kemi prioritet. Dikush na i ka kërkuar këto biseda dhe ne i mendojmë po ashtu si një çështje të dobishme. Por, si mund të veprojmë ne për me ndodhë këto biseda e të jenë të suksesshme? Ne duhet ta ndërtojmë veten. I kemi dy rrugë: një është të veprojmë vetë – ta shpallim Kosovën shtet sovran dhe të pavarur në këtë Parlament; nxjerrim një platformë për hartimin e kushtetutës, mendoj planin për diskutim publik të këtij drafti o se projekt kushtetute; ta paralajmërojmë referendumin. Në këso situatë, ne mund të shkojmë në bisedime edhe teknike, edhe tjera. Ne jemi të përgatitur, sepse të gjithë ne e dijmë se kjo është një infrastrukturë provë për bisedime tjera, megjithë faktin se ne kemi qëndrimet tona, e dijmë fare mirë se procesi është kah shkon andej. Dhe një formë tjetër është që të mos veprojmë vetëm, por të kërkojmë nga partneri jonë, tash nga UNMIK-u në Kosovë dhe Hari Hollkeri që të vazhdojmë në ndërtimin e institucioneve të Kosovës. Pra, ta plotësojmë Qeverinë me ministri të nevojshme, ta zëmë të rendit, të drejtësisë, të ministrisë së jashtme dhe kësaj ne mund të jemi të përgatitur dhe mund të kthehemi në

partnerë edhe të ndërtuar për biseda. Në rast se ne, si Kosovë, shkojmë në këto biseda çfarëdoqofshin këto, edhe teknike e që mund të shkojmë për shkak të rrethanave politike çfarë janë duke u uzhvilluar dhe të kërkesave që po vijnë tek ne, mendoj se ne jemi duke i bërë dëm vetes. Pra, ne do ta shqyrtojmë seriozisht se si do të sillemi në këto rrethana. Në arst se nuk pasojnë veprime në implementim t'vullnetit tonë, ne do ta shqyrtojmë se si do të sillemi në rrethana tjera. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Zoti Sadik Idrizi në emër të një grupi tjetër parlamentar, të atij joshqiptar dhe joserb.

SADIK IDRIZI:

Parlamentarna grupa druge zajednice je sačinjena od 11 poslanika i kao što vam je poznato ona je u političkom i u etničkom smislu hetoregena. Sastavljena je od više političkih i etničkih subjekata. Deli sudbinu gotovo svih građana Kosova. Najveći deo predstavnika ovih zajednica je integrisan u kosovsko društvo. Tokom rata i nakon rata na Kosovu, pojedine zajednice odnosno predstavnici pojedinih zajednica su doživeli da jedan deo napustio Kosovo i da se još nalazi van njega. U poslednje vreme ima prisilnog povratka, posebno sa Zapada. Smatramo da nisu stvoreni kompletni uslovi za ovakav vid povratka. Mi jesmo da se ljudi dobrovoljno vraćaju, ali ne ako nisu stvoreni održivi uslovi za njihov povratak, posebno dok se ne izvrši povratak oduzete imovine i još nekih drugih uslova, je nemoguć povratak ovih zajednica.

Dijalog između Beograda i Prištine je tu negde! Koliko smo pripremljeni, to će vreme pokazati. Međunarodna zajednica će ga... će izvršiti pritisak da do njeja dođe.

Predstavnici ostalih zajednica smatraju da treba da i oni budu uključeni u ove razgovore, jer postoje pitanja koja su specifična za ove zajednice i da mogu oni dati svoj doprinos. Želimo da budemo uključeni u kosovsku delegaciju i da ... Mi ćemo se naknadno dogovoriti, stvorićemo svoj, da ne kažem – miniplatformu sa našim problemima jer postoje problemi koji su zajednički za sve građane. U pregovorima, ako se razgovara o energetici – struju nemaju ... kad nemaju nemaju svi. Ne isključuje se struja po etničkom principu, ako je nema jedan građanin nema i drugi, onda je to taj problem, i obrnuto. Verovatno će doći na red i neka druga pitanja, značajnija i da treba da budemo uključeni. Jer, u suprotnom, dijalog se može pretvoriti u albansko-srpski dijalog. Ovako će biti

dijalog između Kosova i Srbije odnosno Beograda i Prištine i na taj način želimo da budemo kao deo ove zajednice. Hvala.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Dua t'ua tërheq vëmendjen në një çështje. Mendoj se dëgjuam mendimet valide kompetente të forcës në Parlament dhe kjo përafërsisht zgjati 50 minuta. Ka shumë të paraqitur. Do t'ua jap fjalën të gjithëve. Por, duhet t'i vëmë kornizat. A ta humbim përmbajtjen e asaj që u tha nga udhëheqësit e grupeve parlamentare dhe të kalojmë në debat pa kufij, apo në një mënyrë të marrin pjesë njerëzit që vërtetë mund t'i kontribuojnë kësaj dhe kësaj radhe unë do ta përdorja një parim që e shfrytëzoj shpesh: do dua ta ndiej mendimin edhe të partive të vogla. Do t'ua jap fjalën, por mendoj se shefat e grupeve e kanë paraqitur mendimin, e do të ketë e dhe tjerë diskutues. Në e mër të kësaj, zoti Hasan Meta, është paraqitur. Urdhëroni zoti Meta. Besoj se do t'jetë maksimum koha prej pesë minutave, ju lutem, që t'u japim hapësirë të tjerëve.

HASAN META:

Hasan Meta, Lëvizja Popullore e Kosovës. Zonja dhe zotërinj deputetë,

Vetë tema e përcaktuar për rend dite për Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, të datës 18 shtator 2003 me titull: Shqyrtimi i situatës politike në Kosovë, pa referues të përcaktuar më parë, nënkupton punën e dobët të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës! Tema është komplekse dhe mund të debatohet gjatë dhe në pafundësi prejnga mund të dalin konkluzë që nuk obligojnë askend. Është domosdoshmëri që Kuvendi i Kosovës, kohëpaskohe të debatohet çështje vitale për Kosovën, por jo në mënyrë të përgjithësuar, por të përcaktuara më parë sipas përparësive që kanë. Sidoqoftë, për momentin edhe ky debat do të duhej të jetë konstruktiv në temën e caktuar. Kësaj radhe, përparësi duhet dhënë bisedimeve të shumpërfolura Beograd – Prishtinë, të inicuar dhe të potencuar për momentin nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara zoti Hollkeri.

Ky debat i përcaktuar për seancën e sotme bëhet në kohën kur Kosova dhe qytetarët e Kosovës gjenden edhe në një udhëkryq të madh që mund të jetë me pasoja tragjike. Pra, kemi parasysh të kaluarën e afërm ku faktorit politik shqiptar, në vazhdimësi, i bëhen trysni të ndryshme nga faktorët e ndryshëm nga jashtë për biseda dhe marrëveshje të shumta, rezultat i të cilave kemi sot disa prej atyre që duhet përmendur: Marrëveshja e Rambujesë; Rezoluta 1244, e dalë nga e para; Marrëveshja tekniko-ushtarake e Kumanovës, pa shqiptar; Korniza kushtetuese; marrëveshja e fshehtë Hakerup Çoviq; Marrëveshja për

institucionet e Kosovës dhe bashkëqeverisja pa opozitë të mirëfilltë; ujdia për mosmbrojtjen e Kosovës nga rikolonizimi i 30% të territorit të Kosovës në verium e Mitrovicës dhe enklavat; marrëveshja e Serbisë dhe Maqedonisë për 2.500 hektarë tokë të humbur të territorit të Kosovës. Të gjitha këto po i përmendi që t'i rikujtojmë rezultatet dhe pasojat e dala nga këto marrëveshja.

Të nderuar deputetë të Kosovës, lind pyetja – a mund të arsyetohet e gjithë kjo si pasojë e presionit të bashkësisë ndërkombëtare, bashkëpunimit me bashkësinë ndërkombëtare apo si pasojë e një përcaktimi të gabuar të faktorit politik në Kosovë dhe nëse vazhdojmë me numërimin e përcaktimeve të gabuara politike, politika kosovare nuk qe dhe nuk po është në gjendje t'u bëjë ballë vërsuljeve dhe atakimeve të Serbisë, siç ishte shembulli i marrjes pjesë në zgjedhjet vendore të partive politike të Serbisë; imponimit të daljes në zgjedhje të qytetarëve të Kosovës për kryetar të Serbisë; imponimit të përfaqësimit të serbëve me numër të dy apo trefishuar në Kuvendin e Kosovës dhe imponimit të një veprimi arrogant dhe agresiv të “Povratikut” në Kuvendin e Kosovës si pjesë e Parlamentit të Serbisë në Kosovë. Dhe në fund, politika kosovare nuk pati guxim as fuqi t'i kundërvëhet konceptit të papranueshëm të imponuar të standardeve para statusit.

Koha kur po debatojm për temën e dhnë, e kemi Kosovën në izolim të thellë ndërkombëtar, duke përdorur marifetllëqe të ndryshme dhe vazhdimësi nga qarqet e bashkësisë ndërkombëtare që është në proces direkt në funksion të dobësimit të identitetit politik të Kosovës dhe dobësimit të motivit të shqiptarëve për pavarësi. Këtu bëhet fjalë për dokumentet e udhëtimit dhe të gjithë asaj që rrjedh si pasojë e kësaj mënyre perfide nga bashkësia ndërkombëtare që detyron qytetarët e Kosovës drejt administratës serbe. Strategjia e bashkësisë ndërkombëtare për të mbajtur Kosovën në kolaps energjetik në jostabilitet ekonomik, duke krijuar krizë të thellë ekonomike dhe sociale, që çon drejt paperspektivës jetësore, krijon pasiguri, demotivim të qytetarëve, dëshprim të tyre, krijon edhe më tutje mundësi të panumërta për kriminalizim të shoqërisë kosovare dhe ka për pasojë situatë konfuze politike, siguri dhe jetësore. E gjithë kjo është duke u bërë në funksion të integritetit të Kosovës në Serbi në mënyrë të butë, pa u hetuar dhe për fat të keq të përkrahur edhe nga forca politike vendore.

Bisedimet Beograd – Prishtinë, gjoja teknike, janë teknologji e projektuar dhe e menduar mirë e qendrave të ndryshme në bashkësinë ndërkombëtare, tani të paraqitura si këpurdhat pas shiut të njëzëri për ta futur palën kosovare në këto biseda dhe gjithnjë duke premtuar hyrje në Evropë pa treguar qartë dhe kurë. Presionet e bashkësisë ndërkombëtare janë nga më të ndryshmet, duke kushtëzuar dhe premtuar njëkohësisht, duke filluar nga ringjallja e Grupit të Kontaktit, ringjallja e Moskës dhe interesat e saj për Ballkanin, parqitja e zotit Hollkeri herë si monitorues herë si ndërmjetësues të bisedimeve, Bashkimi Evropian, Briseli, zoti Kris Paten në Prishtinë dhe në Beograd për mesazhe të

ndryshme, Karlla del Ponte dhe Haga, Këshilli i Sigurimit dhe përfaqësitë që janë në Prishtinë.

Nëse rrjedhat i përcjellim me vëmendje, hetohet një lloj politike ndaj Kosovës – heqja e dimensionit ndërkombëtar në bisedimet Beograd – Prishtinë, koha më e papërshtatshme për kosovarët dhe inferioriteti i palës kosovare për këto bisedime.

(Ndërhyrje e kryetarit: Rrumbullaksojeni, zoti deputet, të lutem).

Menjëherë. P o t 'i kthehem i Serbisë, Serbia është e favorizuar në relacion me Kosovës qysh pas mbarimit të luftës dhe sidomos tash. Ajo ka bërë punë të madhe dhe tani dëshiron të integrojë Kosovën prapë nën sovranitetin e saj. Rrethanat janë duke i shkuar përshtati dhe, mos ta zgjasë, m'u aty flenë lepuri.

Deputetë të nderuar, duke mosdashur mëtej të elaboroj. Ne lidhur me bisedimet Beograd – Prishtinë duhet patjetër të pyetemi të gjithë se ku jemi ne si subjekte politike, institucione apo si politikë në përgjithësi.

Lëvizja Popullore e Kosovës, si subjekt i vogël politik në ditët e sotme, por i kahershëm me vetëm një deputet të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, kërkon nga i gjithë spektri politik kosovar, e sidomos nga institucionet e Kosovës, e posaçërisht nga Kuvendi i Kosovës, nga grupet parlamentare, nga Qeveria e Kosovës – të jenë syçelë dhe në nivel të duhur dhe të gjithë hapat që duhet ndërmarrë t'i analizojnë bashkërisht në interes të Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Lëvizja Popullore e Kosovës, ripërsëritë kërkesën për kryetarin e Kuvendit, zotin Nexhat Daci, grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që sa më parë të mbahet seanca solemne e premtuar e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.

Ripërsërisim kërkesën që të jetësohet Rezoluta për vlerat e luftës e Kuvendit të Kosovës përaktësisht të aprovohet ligji i parashtruar që ka të bëjë me statusin e dëshmorit, të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve e veteranëve të luftës; të hiqet dorë nga presionet ndaj Kosovës dhe institucioneve të saj që përmes formave dhe marrëveshjeve të ndryshme teknike të instalohet sistemi serb në Kosovë dhe ftojme bashkësinë ndërkombëtare të punojë mbarë dhe drejt në mënyrë që popullit të Kosovës t'i njihet e drejta për vetëvendosje në mënyrë që sa më parë të zgjidhet statusi i Kosovës.

Dhe, për fund, Lëvizja Popullore e Kosovës, është kundër bisedimeve Beograd – Prishtinë. Nuk do ta pranojmë asnjë marrëveshje të dalë nga bisedimet.

Lëvizja Popullore e Kosovës, kërkon që bisedimet të bëhen pasi që të zgjidhet statusi i Kosovës në bazë të vullnetit të popullit, si e drejtë e patjetërsueshme. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI NEXHAT DADI:

Ju falemnderit. Fatmir Rexhepi, le të bëhet gati Ismajl Kurteshi. Fatmir i keni pesë minuta maksimum. Mos më bjerni në pozitë t'ua marr fjalën, ju lutem!

FATMIR REXHEPI:

Zoti kryetar, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Situata dhe zhvillimet politike në Kosovë... për këtë çështje do të ndaj disa, apo katër veprime që tensionojnë situatën dhe vështirësojnë ecuritë e përgjithshme pozitive që janë bërë në Kosovë.

Nën një. Është zhvillimi tepër-tepër i ngadalshëm ekonomik; mungesa e strategjisë dhe e përgjegjësisë që ka UNMIK-u në plan të parë; pastaj vonesa e Qeverisë në hartimin e programit të zhvillimit ekonomik, si dhe të bashkëpunimit konkret me institucionet relevante ndërkombëtare drejt stimulimit të ekonomisë vendore; investimeve; pjesëmarrjes në tregun e punës ndërkombëtar; perspektivën e vendeve të reja të punës, e të tjera.

Nën dy. Në këtë çështje ndikon drejtpërdrejt rritja e pakënaqësisë tek qytetarët e Kosovës dhe vlimet sociale, si rezultat i pasojave të shkaktuara nga regjimi i Serbisë gjatë dekadës së fundit, bie fjala me vjedhje dhe plaçkitje të mëdha të fondeve të ndryshme që janë bërë në Kosovë, qoftë të atyre të pensioneve, qoftë të kursimeve bankare, qoftë të arsimitarëve apo edhe me luftën dhe gjenocidin mbi popullin, ekonominë dhe pasurinë e Kosovës dhe dëmet që tejkalojnë dia miliarda euro. Të gjitha këto, duhet të kthehen dhe t'i kompensohen qytetarëve të Kosovës, si një parakusht që do të çonte drejt stabilizimit të situatës politike dhe sociale.

Prandaj, as UNMIK-u dhe as Qeveria nuk duhet të heshtin para këtyre dhe shumë fakteve të tjera të ngjashme thuaja se nuk ka ndodhur asgjë në Kosovë parapak vitesh.

Çështja e tretë është se në Kosovë vazhdohet me mosfunksionimin e pushtetit të UNMIK-ut dhe të Qeverisë në tërë territorin e Kosovës. Vazhdon puna joefikase në parandalimin dhe zbulimin e krimeve, si dhe vendosjen e ligjit mbi të gjithë

në mbrojtjen e lirive dhe pasurisë së gjithë qytetarëve. Për këtë duhet të përgjigjet ai që ka kompetencat.

Çështja e katërtë është se vazhdojnë po ashtu provokimet që u thanë dhe ndërhyrjet e shtetit fqinj në formë agresioni kushtetues për rianeksim të Kosovës, për të cilën nga bashkësia ndërkombëtare kemi pritur reagim shumë më të ashpër dhe në vend që të ndëshkohet asaj i hapet dera e aderimit, ende pa i plkotësuar detyrimet ndaj vendeve që ajo ka bërë gjenocid, siç është edhe Kosova.

Unë, si deputet i këtij Parlamenti, edhe tani ripërsëris mbështetjen time për qëndrimet e institucioneve të Kosovës, deklaratat dhe rezolutat me të cilat kundërshtohen veprimet e tilla të Serbisë ndaj Kosovës. Unë shpresoj në alternativën më të sigurtë që qendrat e vendosjes dhe UNMIK-u tani e tutje të bashkëpunojnë edhe më shumë me institucionet e Kosovës, t'i bartin përgjegjësitë në Qeverinë e Kosovës, në proceset drejt arritjes së standardeve, si dhe në krijimin e avantazheve dhe të zotimeve për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Ndërsa, sa i përket dialogut me Serbinë, mendoj se ai duhet të zhvillohet sikur me vendet fqinje. Dialogu dhe agjenda e bisedimeve teknike, apo të përkufizuara të bëhen në nivel të njëjtë nga ana e Qeverisë. Çështje themelore është mediatori dhe garancitë e rezultateve...

(Ndërhyrje e kryetarit: Fatmir, përfundoje të lutem)

... e kreu. Po ashtu vlerësoj në hap me kohën, zhvillimet politike dhe nivelin e bisedimeve ky Parlament i Kosovës është ai që duhet të japë fjalën e fundit, por edhe fjalën e parë nëse vlerësohet se mund të bëhet vonë nesër. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Të falemnderit shumë. Ismajl Kurteshi, le të bëhet gati Smajl Latifi.

ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar, deputetë të nderuar,

Mendoj se Kuvendi sot duhet t'i marrë përgjegjësitë që i takojnë. Tendencat që të tejkalohen institucionet dhe sidomos Kuvendi i Kosovës dhe për çështje të rëndësishme për Kosovën të vendosin individët ose disa institucione, është e dëmshme për ata individë por sidomos për Kosovën, prandaj kjo praktikë është e

papranueshme.

Këto ditë po bëhet fjalë për mundësinë e bisedimeve në mes të dy palëve, të pidentifikuara për Kosovën; pa e ditur cilat janë këto palë – institucionet e Kosovës me ato të unionit Serbi-Mali i zi apo një delegacion mikst unimikokosovar, pa kompetenca ose me kompetenca të kufizuara me Serbinë ose këshillin koordinues të Serbisë për Kosovën. Nuk dihet edhe pse dhe për çka do të bisedohet.

Kuvendi sot duhet të konstatojë se këto bisedime, në këtë moment, janë të imponuara dhe se ky Kuvend nuk ka mandatin të vëhet në shërbim të askujt tjetër përveç të popullit që përfaqëson. Kuvendi duhet sot t'i parashtojë kushtet, pa plotësimin e të cilave nuk mund të bëhet fjalë për bisedime, kushte këto që do të sqarojnë kush me kë dhe për çka do të bisedojnë. Kosova nuk duhet të bisedojë me unionin Serbi-Mali i zi para se të garantohet barazia e plotë në mes të palëve që përfaqësojnë dy vende fqinje. Pala kosovare nuk mund të jetë e barabartë duke patur kompetenca të kufizuara, prandaj para fillimit të bisedimeve institucionet kosovare duhet të kenë kompetenca të plota. Dokumentet e miratuara në Serbi dhe unionin Mal i zi janë pengesë e patejkalueshme për fillimin e bisedimeve, prandaj Kuvendi duhet të kërkojë nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Bashkësia Evropiane t'i shpallë të pavlefshme këto dokumente për Kosovën.

Pasi që bëhet fjalë për bisedime në mes dy vendeve fqinje, ndërmjetësimi i bashkësisë ndërkombëtare, sidomos i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkësisë Evropiane, është i domosdoshëm.

Pas plotësimit të këtyre dhe kërkesave të tjera, të dëgjuara sot nga deputetët këtu në këtë Kuvend, Kuvendi mund të tubohet përsëri dhe të mirret me platformën e bisedimeve në të cilat mund të bisedohet për çështje kontestuese në mes dy vendeve fqinje pa lejuar ndërhyrjen në punët e brendshme të njëjës apo palës tjetër.

Ky Kuvend duhet t'u thotë qartë të gjithë atyre që janë të preokupuar me të ardhmen e Kosovës se për të ardhmen e Kosovës do të vendosë populli i Kosovës përmes deklaratimit të tij të lirë dhe se këtë të drejtë nuk do t'ia delegojë akujt e as Këshillit të Sigurimit. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Smajl Latifaj, le të bëhet gati Millovan Jovanoviq. Smajl pesë minuta të lutem.

SMAJL LATIFAJ:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Në trajtimin që i bëhet situatës së sigurisë sot në Kosovë, sidomos kur bëhet fjalë për kuptimin si dhe kur bëhet parashtrimi i argumenteve për shkaqe të saj, ka një manipulim tejet serioz i cili bëhet në kurriz të shqiptarëve, që janë shumicë në këto troje. Po edhe misioni ndërkombëtar në Kosovë UNMIK, si në shumraste, edhe në këtë të sigurisë, është i prirë t'i akuzojë shqiptarët, në mesin e të cilëve, gjithnjë ka "ekstremistë" në thojza, që duan t'i arrijnë qëllimet e veta në mënyrë "të paligjshme" në thojza.

Sipas praktikës së deritanishme, e cila po përfaqësohet edhe nga Koalicioni "Kthimi" gishti drejtohet nga "ekstremistët shqiptarë" në thojza të cilët janë "fajtori kujdestar" – taktikë që përkon shumëfish edhe me stilin e Beogradit. Rast konkret, kishim edhe deklaratat e zëdhënësve të UNMIK-ut që për rastin Gorazhdec deklaruan se këtë akt duhet ta kenë bërë shqiptarët. Në realitet, prapa këtyre paragjytimeve qëndron një qëllim i pastër politik. Për situatën e sigurisë po spekulohet shumë, edhe kur flitet për shkaktarët e saj. Pikërisht për këtë edhe ne jemi shumë të interesuar të merremi me shkaktarët e një situatë të tillë të tendosur të sigurisë por jo me pasoja të saj apo me përgjegjësitë që ka ky apo ai faktor sigurie këtu në Kosovë. Pa i ditur shkaktarët nuk duhet t'u besojmë aspak kualifikimeve që bëjnë qarqet e ndryshme politike që janë përgjegjëse për gjendjen e sigurisë në Kosovë.

Sa i përket pozitës së sigurisë, si një segment i rëndësishëm që është i ndërlidhur me situatën e përgjithshme politike, e ka burimin pikërisht në Rezolutën 1244 e cila Kosovën e parasheh si pjesë integrale të Serbisë. Me vetë këtë fakt, ajo i bën shqiptarët që me arsye të plotë në këto korniza të këtij procesi të ndihen të pasigurtë. Shqetësimi ynë duhet të jetë serioz sa i përket këtij faktori. Ndërsa, sa i përket aktivitetit që bën Serbia rreth Kosovës e brenda saj, ajo nisët nga veprime politike e diplomatike të mbështetura në vetë këtë dokument famkeq antishqiptar që pastaj shoqërohet nga veprime dhe operacione agjenturore, diverzioniste, shantazhuese që ekzekuton ajo në Kosovë. Serbia, me anë të tilla aksioneve, nuk ka për qëllim vetëm agresionin kushtetues, por shpurjen deri në fund të misionit të saj. Pra, kthimin e saj të serishëm në Kosovë. Tensionimi i situatës së sigurisë përmes së cilës Serbia ka inskenuar pozitën e saj prej viktimës, duke u vetëvrarë, është bërë për të bërë presion në relevancat ndërkombëtare dhe për të siguruar që procesi politik në Kosovë të udhëtojë drejt Beogradit, ashtu siç u veprua edhe me Debëllidënë, me Mitrovicën, me enklavat, e tjerë, vetëm e vetëm që proceset politike të gjejnë zgjidhje me dialog me Beogradin. Vrasjet enigmatike që po ndodhin vërtetë e rëndojnë situatën politike dhe atë të përgjithshme, por le të përkujtojmë se Kosova, edhe pa këto vrasje nuk është aspak e sigurt sepse ajo ende nuk është e lirë.

Prandaj, skenari është i qartë dhe me caqe të qarta politike: shqiptarët akuzohen për kriminalitet, shpesh këtu edhe akuzat shumë të rënda për krime lufte, ndërsa serbët si viktimë të përkrahen dhe ndihmohen. Kjo nuk do të ishte problem, sikur të mos kishim përbazë rrethanat politike në të cilat ndodhemi, kur zbatimi i marrëveshjeve të dëmshme për Kosovën po ndihmohen edhe me këto akuza, ku çështja jonë kombëtare me anën e situatës së sigurisë po vëhet në bangën e akuzës. Prandaj, duke patur parasysh këtë gjendje, të gjithë ne kemi përgjegjësi të rëndë kombëtare edhe para popullit tonë. Kjo gjendje s' domend se nuk mund dhe nuk duhet të pranohet. Mirëpo, për ta tejkaluar këtë gjendje sa më shpejt kërkohet angazhimi ynë jashtëkornizave politike aktuale, pra në një strategji të çlirimit të plotë kombëtar. Kjo sa i përket situatës së sigurisë. Mirëpo, vëmendja jonë duhet të jetë edhe më e madhe rreth dialogut që pritet të mbahet...

(Ndërhyrje e kryetarit: Smajl, rrumbullakësoje të lutem).

... me Serbinë, duke u mbështetur në dokumentet në fjalë, me të cilat qeveriset Kosova Serbisë do t'ia rregullojë dukshëm pozitën e epërsisë në raport me ne. Ne duhet t'i qasemi me seriozitetin më të madh çështjes që do ta ngrisim sot këtu dhe atë në: a duhet të dialogojmë me Serbinë sot, rrespektivisht kurë; a është ky dialog në dobi të Kosovës apo të Serbisë; cilat do të jenë rezultatet e këtij dialogu dhe në ç'dobi ka çështja jonë e pazgjidhur kombëtare nga një dialog i tillë; ç'forcë politike dhe morale kanë pas vetes institucionet aktuale politike të Kosovës sonë përpara një veprimi të tillë politik. T'i shohim me radhë secili nga këto çështje të cilat natyrisht e shqetësojnë çdonjërin prej nesh. Domosdo që së pari është me interes për ne dhe për opinionin tonë kombëtar që të dihet dhe të theksohet se në ç'baza dhe në ç'rrehana politike, ekonomike e shoqërore po përgatitet të zhvillohet ky dialog, duke patur parasysh edhe kundërshtarin tonë, rrespektivisht pozitën e tij në këtë moment. Për të faktuar bazën juridike të dialogut, nuk ka nevojë për shumkohë. Kjo pozitë i përcaktohet me këto dokumente. Edhe ky dialog është kërkesë e këtij dokumenti, i cili duhet të përmbushet si një nga standardet që parashtron ai. Çdonjëri që vështron me objektivitet dhe arsyeshmëri gjendjen në të cilën jemi, nuk do të kishte guxim moral dhe politik që të përfundonte dhe të ulet në një tryezë dhe të dialogojë me atë që e sollën dje Kosovën në një arenë ku Serbia ushtroi gjenocid ndërsa sot në këtë gjendje nënshtrimi, do të t'hotë të bëhesh pjesë e nënshtrimit. Në këto rrethana është e qartë se baza e bisedimeve i tejkalon ...

(Ndërhyrja e kryetarit: Zoti deputet, përfundoje të lutem dhe për vetëm gjysmë minuti!)

...shqiptarët e kanë të qartë pozicionin e vet. Në këto rrethana është e qartë se baza e bisedimeve i tejkalon shpejt kufijt e të ashtuquajturave bisedime për çështje praktike ose teknike apo në interes të qytetarëve dhe kjo çështje merr

përmasa për një trajtim shumë më serioz dhe parimor. Të shohim më tutje se ç'do të fitojnë pra shqiptarët në bisedimet me pushtuesit për të zgjidhur siç thuhet probleme praktike.

Ne mendojmë, si LKÇK kemi nevojë të bisedojmë në mes veti dhe të heqet dorë nga varshmëria e të tjerëve, duke synuar ndërrim qenësor të politikës o në në funksion të orientimit të drejtë dhe të mobilizimit të forcave për ta ndryshuar statuskuonë. Ndërsa, strategjinë dhe konsensusin për dialog, nuk e shohim të suksesshëm. Kjo është rrugë e gabuar. Ne nuk e ndjekim, jo pse kemi teke ose përfaqësojmë një pikëpamje që mbronë interesat e një subjekti politik, porse nuk duam ta lidhim fatin e popullit shqiptar në një rrugë pakrye.

LKÇK strategjinë dhe konsensusin e sheh të nevojshëm vetëm në rrafshin kombëtar, si një nevojë dhe mundësi që t'i orientojë të gjitha energjitë që ka populli ynë.

Për ta zgjidhur problemin e vet, LKÇK konsideron se secili bartë përgjegjësinë mbi vete...

(Ndërprerje në ton)

(Prej këtu përshkruhet pjesa përfundimtare e diskutimit të dorëzuar me shkrim)

LKÇK duke e njohur dhe analizuar gjendjen politike, duke i analizuar rrethanat politike, kornizën e bisedimeve dhe bazën e tre, është e bindur se këto bisedime do ta afrojnë Kosovën më shumë kah Serbia. Me këtë gjest do të dëshmohet se Serbia ka të drejtën që të mirret me zgjidhjen e "çështjeve teknike" të "qytetarëve të vet" në Kosovo. Me këtë hap asaj i jipet peshë e rëndësishme dhe kyçe në çështjen e Kosovës drejt shtimit të kontrollit politik mbi ne.

Prandaj, LKÇK mendon se për ta penguar një politikë të tillë, duhet që të ndërtojmë një politikë të përbashkët dhe një strategji të qartë të veprimit në rrugëzgjdhje tjetër, të realizueshme dhe që përkon me aspiratat tona kombëtare.

Ne duam që t'ia bëjmë me dije gjithë opinionit përparimtar demokratik botëror, se fati i Kosovës nuk mund të parashihet në kuadër të asnjë shteti të përbashkët me Serbinë. Të gjithë e dinë dhe duhe tta kuptojn se ky edhe ka qenë shkaku i luftës që lamë pas, dhe nëse nuk mënjanhet, ai do të jetë ëshkaku edhe për një luftë të ardhshme me Serbinë. Kosova nuk mund ta pranojë që t'i imponohet pushtimi në emër të angazhimit për kurrfarë stabiliteti derisa ai "stabilitet" synohet të ndërtohet mbi lirinë tonë. Neve nuk bën të na imponohet që me çdokush të bisedojmë me Serbinë, dhe në asnjë mënyrë për fatin tonë të vendosin të tjerët, sepse kështu nuk i kontribuohet stabilitetit, paqës e lirisë së

popujve. Përkundrazi, kështu mund të përligjet vetëm tirania mbi popullin shqiptar ende të paçliruar.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Millovan Jovanović. Le të përgatitet zoti Shefki Sejdiu.

MILOVAN JOVANOVIĆ:

Poštovane kolege, poštovani predsedniče, poštovani ministri,

Da su u pitanju poslanici srpske koalicije «Povratak», ovo sigurno ne bi bilo dozvoljeno, ni minut, a kamo li 15-20 minuta ovakvog predavanja. Molim vas, i o vama će biti reči, gospodine predsedniče. Niste ni vi toliki demokrata kao što se predstavljate! Političku i bezbednosnu situaciju na Kosovu i metohiju iz jednog ugla gledano naravno, karakterišu pre svega nasilje i teroristički napadi usmereni prema srpskom narodu na Kosovu i metohiju. Pod dva, što možemo da primetimo je odsustvo političke volje kod albanskih lidera u Prištini pre svega, da se politička klima oblikuje u pravcu afirmacije, etničke tolerancije, mira a samim tim i prosperiteta na Kosovu i metohiju. Ne može se zaobići ni organizovani kriminalitet, korupcija i opšta privredna stagnacija. Na sve ovo ukazivali su i Specijalni predstavnik gospodin Holkeri kao i evropski komesar gospodin Kris Paten, prilikom nedavnog boravka u Prištini. Evropski i američki zvaničnici stalno ukazuju albanskim liderima da ako žele napredak moraju da ispune odgovarajuće standarde, takozvane standarde pre statusa. Lično ja imam utisak da je u pitanju sledeća logika: oni svakako znaju da ... oni izgleda da znaju da Albanci, mislim na lidere, ne na Albance u celini, ne žele u stvarnosti nikakve standarde na terenu, kako ih je definisala međunarodna zajednica, ali će naravno međunarodna zajednica stalno insistirati na standardima, pre bilo kakvih ozbiljnih razgovora o statusu. I tako se to može otegnuti u nedogled narednih, mislim čak i decenijama. Taoci ovakve politike polako postaju građani i Srbi i Albanci, a naravno i svi ostali. Kreatori političke scene, putem masmedija truju građane navodno ukorenjenom mržnjom vekovima što je najobičnija laž i proizvod propagande. Setimo se primera Francuske i Nemačke koje sada žive kao prosperitetne nacije, a bile su vekovima u konfliktima, čak znamo i za neke tridesetogodišnje pa i vekovne ratove. Zašto da dozvolimo da i naše mlade generacije budu pogrešno usmerene na put mržnje i oduzmemo im pravo na slobodu i napredak, kako bi se zadovoljile ambicije bolesnih tipova koji su danas lideri na političkoj sceni, ne naravno svi!!! Međunarodna zajednica treba da posveti pažnju ovom pitanju i pomogne građanima Kosova i metohije kako bi nove političke opcije sa liderima koji imaju zdrav razum izbile u prvi plan i biračima na drugačiji način predstavili ukupnu situaciju.

Vidite, Srbi i Albanci su sasvim skladno i sve bolje i bolje živeli nakon drugog svetskog rata, ako izuzmemo izvesne periode a posebno ove pod režimom Miloševića. Ovaj period se sada uzima kao osnova za srbufobiju i tendenciozno se stvara predstava da su svi srbi bili i sprovodioci takve politike, pardon, što je čista besmislica. S druge strane, zaboravlja se da su u poslednjem veku i srbi u nekim periodima bili pod pritiscima. Na primer, znamo za vreme Turske, 41., 45., 68. 89 i tako dalje. No to je sve arbitrarno i prepustimo to istoričarima. Mi treba da se bavimo budućnošću. Dakle, ni albanci nisu bili baš belo cveće u izvesnim periodima, na ovim prostorima. Dakle perspektiva postoji, a mi treba da je oblikujemo, naročito prema potrebama mladih, kako bih smo ih oslobodili naših predrasuda i frustracija. Treba dakle da se radi u kućama, porodicama, školi, putem umetnosti, naravno i putem masmedija. Samo će tako doći bolja budućnost za sve.

I na kraju, par konstatacija kao finale. Ipak, ne smemo zaboraviti da su poslanici Srpske koalicije još uvek voze u oklopnim transporterima, što najbolje ilustruje kakva je sloboda kretanja, pardon, i ukupna bezbednosna situacija, pardon. Poslanicama se ne dozvoljava ostvarivanje mandata tako što im se ne dozvoljava da govore, jer predsednik Daci, to je uradio prošlog puta, sada nam je dozvolio, može samovoljno, dakle nedemokratski da prekine svaku tačku dnevnog reda i pozove se na većinu Skupštine, kao što je to uradio kada je na dnevnom redu bio povratak, kao tema dnevnog reda, kada je bio povratak prognanih lica. Imovina i dalje uzurpirana, mislim na srpsku imovinu, sa namerom da se dobar deo pljačka a ona se sada i koristi bez naknade, ili uz pomoć HPD nezakonito prodaje. Dakle, ljudska prava za srbe u celini ne važe. To se mora promeniti pre ili kasnije, na ovaj ili onaj način!!! Hvala.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Zoti Shefki Sejdiu, le të bëhet gati Muhamet Kelmendi dhe lus për rrespektim të kohës. E këto që i tha ky le të prishen prej procesverbalit se s'kanë lidhje dhe s'po i komentoj hiq Millanoviq a Millovanoviq, ...

SHEFKI SEDJIU:

Që të mos abuzoj shumë me kohën, në dirkursin tim do të përdori më tepër terma, pra me nocione do të manipuloj kësaj radhe dhe do të jam sa më i shkurtër. Do të përqëndrohem në dialogun.

Dialogu duhet të përgatitet, unë mendoj, mirë, mbi bazë të platformës që aprovohet në këtë Kuvend dhe vetëm këtu.

Tjetër, në kuadër të kësaj përgatitjeje, duhet të bëhet përzgjedhja serioze e problemeve si dhe përcaktimi i rregullave, kritereve dhe shfrytëzimi i argumenteve. E këto duhet të jenë, qysh mendoj unë, të mbështetura në aktualitetin, në prioritetin, në relevancën, në adekuatën, në qëndrueshmërinë e tyre, në vërtetësinë e tyre dhe në kompatibilitetin e tyre. Sidomos duhet të kemi kujdes të rrespektimi i rregullave të lojës. Përafërsisht ashtu siç rrespektohet rregulla e lojës, për shembull, në shah. Janë dy palë kundërshtarë, ekzistojnë rregullat dhe secila figurë e ka vlerën e vet, edhe sillet sipas rregullave vet. Pioni shkon për dy fusha, merr anash e kurrësesi mbrapa dhe para e tjerë. Të shkohet një potez për një potez, mos të ndodhë vjedhja e tyre, për shembull. Të luhet dy poteza e ky tjetri të flejë, të mbetet në gjumë.

Tjetër, shpeshherë është dëshmuar në bisedimet se Serbia ka manipuluar me argumente që nuk janë të qëndrueshme dhe i ka klasifikuar si, për shembull, argumenti historik si e quan ai dhe argumenti etnik, duke ngatërruar historiken me kulturoren, me fetaren dhe mitologjinë të pavërteta. Nëse startohet me paragjykime, edhe me argumente të tilla të shpifura, të drejtë mbi Kosovën ka më tepër Roma, që ishte këtu 600 vjet; më tepër ka Bizanti, që ishte këtu 700 vjet; më tepër ka Turqia, që ishte këtu 500 vjet. Të drejtë mbi Vojvodinën më tepër ka Hungaria sesa Serbia, e tjera, e tjera, sipas këtyre kritereve të shpifura besa edhe reale. Shqiptarët duhet të shkojnë me qëndrimin se e kanë argumentin në dorë edhe historik edhe argumentin etnik. Historik! Ju lutem, shkenca sllave, edhe serbe edhe bullgare: – kapitullon para të vërtetës se Naisusi, që dëshmohet në shekullin e gjashtë, po edhe Skupi, edhe Astibosi, edhe Linidusi, edhe Skardusi, edhe Drinusi, të gjitha këto janë formësuar sot dhe ekzistojnë mbi bazë të mjeteve të shqipes. Dhe, ky është ai argumenti më i fuqishëm, kur të bisedohet për argumentin historik. Për argumentin etnik, urdhëroni dokumentet mesjetare, që nga Krisobulat e deri te Defteret, edhe në Kanonikun e Dushanit, thotë – srba, arbanasa i vllaha. Ata vetë! Prandaj, ju lutem problemi i Kosovës është i madh. Kosova është e pushtuar pasi që më 1912 u çlirua me forca të veta kundër turqve. Asnjë fyshek për Kosovën, në vitin 1912, Serbia se ka bërë sepse s'e ka konsideruar të veten. Pastaj, e ka okupuar dhe ka vënë marrëdhënie tipike kolonialiste, në frymën e kohës.

Prandaj, Kosova duhet të konsiderohet si problem i kolonisë dhe bisedat duhet të bëhen në raport me kolonizatori dhe i kolonizuari. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Muhamet Kelmendi, le të bëhet gati Sala Ahmetaj.

MUHAMET KELMENDI:

Zonja dhe zotërinj, i nderuari zoti kryetar,

Partia e Unitetit Kombëtar Shqiptar Unikombi përshëndet rendin e punës në veçanti situatën aktuale politike që u shtrua sot për ta shqyrtuar këtu, sepse përmes kësaj mendojmë se dalin tri çështje jashtëzakonisht të mëdha që, jo vetëm për institucionet e Kosovës por edhe për faktorin ndërkombëtar dhe kombin shqiptar në përgjithësi duhet të paraqiten si evidente në punën e tyre.

Çështja e parë dhe e ngutshme dhe pa të cilën dhe kundër të cilës jo vetëm ky institucion por askush s'mund të eci përpara, është pikërisht shpallja e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës nga ana e këtij Kuvendi të Kosovës. Në këtë drejtim na flasin shumë faktorë. Unë po i përmendi disa: është vullneti historik i popullit dhe qytetarëve të Kosovës para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës; është përbërja e këtij Kuvendi i cili del nga vota e lirë në zgjedhje të përgjithshme si faktor i dytë dhe faktori i tretë – është gjendja aktuale ekonomike dhe sociale, e cila është jashtëzakonisht e rëndë, mosbartja e kompetencave tek organet e Kosovës, mospatja e mundësisë së organizimit të institucioneve të drejta dhe të mirëfillta që e çojnë çështjen përpara dhe natyrisht e ekzistimit edhe të mëtutjeshëm të enklavave serbe të cilat na kanë vështirësuar në veçanti rendin dhe sigurinë në Kosovë. Dhe, në fund, si faktor që flet se duhet d'omosdo të shpallet shtet i pavarur dhe sovran, është intervenimi apo më mirë të themi përzierja në punë të brendshme të Kosovës dhe atë në mënyrë papresedan nga ana e Qeverisë së Beogradit përmes akteve juridike dhe politike të nxjerra.

Duke shpallur shtetin e Kosovës, krijohet dhe ndërtohet çështja e dytë, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme – në dërtimi dhe fakti dhe de jure i shtetit të Kosovës, duke nxjerrur kushtetutën e shtetit të Kosovës, duke ndërtuar shtetin dhe institucionet e pavarura dhe në varshmëri me kushtetutën e Kosovës dhe duke ecur në raporte me shtetet ndërkombëtare dhe me fqinjët në këtë kontekst e shohim edhe raportin me Serbinë por duke ndërtuar edhe atëherë, edhe me ato kushte, edhe pse jemi shtet i pavarur dhe sovran, një platformë të mirëfilltë mbi të cilën do të delë se çka duhet të bisedohet, ku duhet të bisedohet dhe me cilën rrjedhshmëri, në cilin vend dhe me ndërmjetësimin e kujt duhet të ecet në drejtim të bisedimeve të tilla.

Ne mendojmë se pa shtetin sovran dhe të pavarur të Kosovës barazia e Kosovës me asnjë subjekt në rajon dhe në botë nuk mund të arrihet dhe nuk mund të bëhet. Kompetencat janë jashtëzakonisht të dobëta dhe të ulëta, prandaj nuk ka mundësi të barazisë për të ecur në drejtim të realizimit të çfarëdolloj marrëveshjeje me çfarëdokend tjetër.

Dhe çështja e tretë, e ngutshme që ne mendojmë pas çështjes së dytë, pas ndërtimit defaktok të shtetit të Kosovës, është e drejta që kombi shqiptar dhe qytetarët në tërësi të Kosovës, të deklarohen për të ardhmen e tyre nëpërmes organizimit të një referendumi të përgjithshëm. Ne nuk mund të flasim për integritet as rajonale as evropiane; ne nuk mund të flasim për një shoqëri demokratike në qoftë se një popull të tërë i mohohet e drejta që të deklarohet lirshëm me referendum për të drejtën e bashkimit mbi bazën një shtet komb. Prandaj, vetëm në qoftë se populli është i bindur në rrugën në të cilën ecë, në qoftë se populli pyetet për të ardhmen e vet, ka mundësi të ndërtojë një shoqëri të lirë, kemi mundësi të ecim përpara, kemi mundësi të ndërtojë një shtet të lirë dhe natyrisht të barabartë me të gjitha shtetet tjera dhe të futet ky shtet në kuadër të institucioneve evropiane. Është alogjike të flitet për integritet rajonale, në qoftë se nuk kemi integritet ndërshtetë; në qoftë se nuk largohen kufijt e vendosur nga pushtimet e gjata për çka parafolësi foli dhe në qoftë se nuk ka lidhje të drejtpërdrejta me të gjitha fushat midis pjesëve të ndryshme të popullit shqiptar. E kjo relizohet vetëm përmes organizimit të një referendumi të përgjithshëm ku qytetarët e Kosovës do të vendosin për të ardhmen e vet. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Sala Ahmetaj, le të bëhet gati Bajram Kosumi. Po hiqni dorë. Atëherë le të bëhet gati Edita Tahiri.

SALA AHMETAJ:

Nocioni atdhe, si nocion gjeografik, ekziston vetëm në planin teorik dhe abstrakt. Praktikisht atdheu për ne ende është koncept i ngushtë i paqartësuar dhe me mendësi të robit. Ndjenja e inferioritetit që hetohet tek faktori politik shqiptar lidhet edhe me faktin sepse institucionalisht për atdheun, me konceptin e vërtetë të tij, ne nuk kemi menaxhuar asnjëherë vetë. Dilema mos të keshë dhe të jeshë na përcjell vazhdimisht. Dje, donim ushtri por nuk donim të ishim ushtarë. E sot duam shtet, por nuk jemi të përgjegjshëm për të ndërmarrë hapa të domosdoshëm për krijimin e tij. Këtë mangësi duhet ta tejkalojnë politikanët duke mos e pjesëzuar, copëzuar ose përvetësuar përgjegjësinë. Atdheu nuk është partia, nuk është as ideologjia. Prandaj, për fatin e tij asnjë lider nuk guxon t'i japë të drejtë vetëvetës të marrë vendime pa konsensus.

Për t'u tejkualuar kjo gjendje, urgjentisht duhet të hartohet një strategji dhe platformë kombëtare e Kosovës. Është fatkeqësi që ende s'e kemi bërë. Kjo ka të bëjë edhe me sfidën e identitetit dhe me krizën e identitetit. Duke u

ballafaquar me këto sfida, ne do ta zbërthenim edhe teorinë se nacionalja është vlerë.

Prandaj, ky Kuvend, si institucioni më i rëndësishëm dhe më i përgjegjshëm duhet ta marrë përgjegjësinë për hartimin e një strategjie dhe platforme kombëtare për Kosovën. Në këtë strategji do të duhej që të parashiheshin edhe kushtëzime të caktuara për bisedime eventuale me Beogradin, edhe për faktin se UNMIK-u kompetencat i ka vetë, kurse përgjegjësitë ua lë kosovarëve.

Ndër çështjet parësore që duhet të kërkojë ky Kuvend, është marrja e kompetecave dhe thyerja e kornizave. Meqë për të lëvizur procesin historik, duhet të kalojmë në veprime, i pëlqeu dikujt ose jo. Ne nuk mund të rrijmë gjithmonë si nxënës të dëgjueshëm edhe kur na thonë me cinizëm – se Kosova do të jetë në Evropë pavarësisht çfarë do të jetë statusi i saj. Jo zotëri të nderuar, Kosova është në Evropë gjeografikisht, por asaj nuk i duhet hyrja në Unionin evropian nën shtetullën e dikujt.

Ne duhet t'u kundërvihemi kualifikimeve politikisht të dëmshme dhe me paragjykime që u bëhen shqiptarëve nga qarqe të caktuara që thirren në kualitetin e kombit dhe në teorinë se “shqiptarët s'janë të pjekur për të pasur shtet”, se “shqiptarët dje ishin kundërrivolucionarë, irredentistë, seperatistë” kurse sot terminologjia ka evoluar dhe ata quhen “kriminelë, terroristë” e tjerë. Dhe, kështu dje kërkesat e shqiptarëve për barazi, satanizoheshin nga jugosllavia kurse sot këtë kërkesë fisnike dhe këtë përcaktim për pavarësi dhe trajtim të barabartë, human në shpirtëror, pra këtë kërkesë për prestigj e jo vetëm për të plotësuar nevojat biologjike UNMIK-u mundohet t'i sanatozohet duke tentuar ta ndrydhë identitetin kombëtar në emër të multietnicitetit, ose shumetnisë së paqenë dhe duke tentuar që me a ktrim të bëjë pajtim të dhunshëm në mes të viktimës dhe xhelatit ende pa u tharë plagët dhe gjaku.

Dhe, ne kërkojmë që e drejta për vetëvendosje të universalizohet e jo me veprime të këqia që bën djalli të ndëshkohet Kosova dhe populli i saj. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Edita Tahiri, le të bëhet gati Mahir Jagxhillar.

EDITA TAHIRI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Së pari, më lejoni të them se debati i sotëm për situatën politike po tregon edhe një herë qasjen e vonuar të këtij Parlamenti dhe një politikë reaktive që ne po e udhëheqim këtu përballë situatave të rënda nëpër të cilat po kalon Kosova.

Shpresoj dhe dua në fakt fuqimisht të sygjeroj që të ndërrojmë këtë praktikë, të jemi proaktiv dhe t'i paraprijmë gjërave sepse jemi institucioni më i lartë i këtij vendi, të cilit populli ia ka dhënë votën dhe ne duhet të jemi përgjegjës për të gjitha veprimet që po i bëjmë.

Lidhur me situatën politike, ne të gjithë po shohim se Kosova ka hyrë në një fazë shumë të ndieshme dhe indikatorët e gjendjes, të mos i përmend, se kolegët e mij i thanë, janë dhe flasin për një situatë ku ne vërtetë kërkojmë që të bëhet një mobilizim i ri dhe i fuqishëm i të gjithë faktorëve relevant, politik dhe institucional të Kosovës.

Qënga Mitrovica, që mbahet e ndarë, qënga prekja e kufijve të Kosovës dhe zvogëlimi i territorit të saj; enklavave e deri te ekonomia e varfër dhe papunësia e madhe, të mos them se siguria vazhdon të jetë e brishtë. Krejt këta indikator flasin për një situatë që kërkon, në radhë të parë nga faktori vendor, një qasje ndryshe, një qasje më serioze, me një përgjegjësi më të madhe.

Ne të gjithë e dijmë se UNMIK-u është këtu përgjegjësi numër një për situatën dhe ne kemi parë që politikat e UNMIK-ut deri më tani në fakt i kanë dhënë zhvillime pozitive të situatës. Mirëpo, ato janë jashtëzakonisht të ngadalshme dhe kohëpaskohe edhe të pafokusuara. Politika e UNMIK-ut, standardet para statusit, faktikisht po tregohet se po e çojnë Kosovën në një rreth vicioz për faktin se shumë prej këtyre standardeve po varen drejtpërsëdrejti nga statusi dhe këtu vijmë në shprehje ne si faktor vendor të jemi proaktiv dhe të japim projektin tonë si duhet dalë nga kjo gjendje. Në fakt, edhe me Rezolutën 1244 ne tanimë kemi hyrë në fazën e fundit të protektoratit që edhe me hartën e rrugës që është caktuar nga Këshilli i Sigurimit ne kemi hyrë në fazën legjitime të vendosjes së statusit final të Kosovës. Dhe tani ne duhet të jemi ata të cilët me politikat tona aktive duhet të ç'bllokojmë situatën.

Çështja e dialogut, në fakt, në parim dialogu është një çështje për të cilën ne jemi dëshmaur më së shumti në këtë rajon apo në hapësirat e ish jugosllavisë. Kosova është vendi i vetëm i cili iu qas në mënyrë paqësore dhe me dialog krizës së dhjetëvjeçarit dhe pranoi luftën vetëm atëherë kur ajo mbeti opcioni i fundit. Prandaj, ne nuk kemi nevojë të dëshmohejmë a jemi për dialog, por ky dialog për çështje praktike do përgatitur mirë, në kuptimin që të jetë i

suksesshëm. Ne kemi përvojë të dialogojmë me Serbinë dhe ne njohim qartë obstrukcionet që Serbia din t'i bëjë dhe po i bën. Po i bën me faktin se ka bërë një varg atakesh apo agresionesh kushtetuese vetëm sa për të bërë pra situatën e rëndë dhe për të vënë në pozitë kosovarët që t'i thonë jo kësaj. Por ne duhet të jemi të kujdesshëm në kuptimin që dialogu për çështje praktike...

(Ndërhyerje e kryetarit: Rrumbullaksojeni ju lutem)

... Zoti kryetar, jeni shumë i padrejtë. Dikujt 15 minuta dhe dikujt 3-4 minuta, ju lutem pak një qasje më, të lutem më konstruktive.

Pra, është fjala që dialogu për çështje praktike duhet të ndahet qartë nga ndonjë manipulim eventual me çështjen e bisedimeve për statusin. Sepse, për statusin e Kosovës nuk duhet të artikulohe mi në formë dialogu. Serbia ka humbur të drejtën edhe legale, edhe politike, edhe legjitime që të bisedojë për statusin e Kosovës. Prandaj, dialogu për çështje praktike, i udhëhequr nga bashkësia ndërkombëtare me SHBA dhe Bashkimi Evropian, por jo edhe dialog për statusin final. Për statusin final duhet të vendosë populli i Kosovës, pra vullneti i tij do të fletë ër pavarësinë e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet vërtetë me parimet demokratike ta njohë këtë vullnet në mënyrë që të japë kontribut stabilitetit dhe paqës së qëndrueshme në këto hapësira. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Para se t'ia jap fjalën Mahirit, pastaj Sylejman Çerkezi le të bëhet gati, një konstatim. Është një parim fundamental. Ata që kanë më së paku në Parlament në aspektin kohor dhe jo vetëm një person, si ta shfrytëzojnë rastin e mediave, janë plotë s ulme, plotë kritika për mospunën e Parlamentit. D he kjo duhet të përfundojë ose kryetari duhet të ndërrohet për shkak të mosrrespektimit të kohës dhe të mosqenies së deputetit në Parlament. Prandaj, ju lutem, para se të mbani leksione në Parlament, merrne një pasqyrë, shiqojeni veten dhe kohën në të cilën keni qenë në Kosovë, jeni në Kosovë dhe punoni në Parlament. Mahir Jaghillar, Sylejman Çerkezi, ka edhe 20-30 debatues, po ju lus vazhdimisht rrespektone kohën, nëse jo do të marrim një qëndrim tjetër demokratik me vota çka të bëjmë më tej.

MAHIR YAĞCILAR:

Sayın başkan, sayan bakanlar, değerli milletvekilleri. Kosovada bugün yeni bir realite ve durum vardır, hepimiz bunun farkındayız. Farkındayız ki Kosovada da bi çıkmaz vardır, siyasi çıkmaz vardır, bu da hergünkü hayatta sorun yaratmaktadır. Şimdi zaman geliyor , dialoglar için ve ciddi bir dialoglar için.

diskutim që bartë me vete edhe problemet dhe pasojat e gjendjes në të cilën jemi tani.

Sa u përket çështjeve të bisedimeve në mes palës shqiptare dhe ... Prishtinë – Beograd dhe absolutisht në radhë të parë është kusht që Beogradi duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës në mënyrë që bisedimet të kenë kuptim.

Diskutimet e ashtuquajtura teknike, në radhë të parë, duhet parë se këto janë politike, parimore dhe jetike për çështjen e Kosovës, ku për këtë natyrë të bisedimeve duhet të bërë me Këshillin e Sigurimit e jo me Beogradin, të pjekja e kushteve të mbajtjes së refrerendumit për pavarësi të Kosovës të mbikëqyra dhe të pranuar nga faktori ndërkombëtar, e drjetë kjo për të gjithë popujt për vetëvendosje dhe po ashtu edhe për popullin e Kosovës.

Ndërsa sa i përket bisedimeve, do të jenë teknike nga këndvështrimi i Beogradit, pasi që Beogradi ishte kundër bisedimeve deri në momentin e nxjerrjs së deklaratës nga kuvendi i tyre dhe menjëherë pas kësaj ishin të gatshëm për bisedime, sepse për ta vërtetë këto bisedime do të keni karakter teknik.

Përfundimisht, mendoj se duhet të punojmë me Këshillin e Sigurimit më tepër sesa me çështjet teknike. Sepse, duke u marrë me çështje teknike edhe politika kosovare po merr fatkeqësisht ngjyra vërtetë teknike. Ju falemnderit.

KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Unë do t'ju lutja për vëmendje para se të ... Ju po shihni se përqëndrimi njëqindpërqind ka ra, nuk dëgjon kush kend. Janë bërë dy orë debati shumë serioz, shumë konstruktiv, shumë të dobishëm. Unë kam dy propozime: Nën një, ta përmbylim këtë, dhe grupet parlamentare le t'i studiojnë të gjitha diskutimet dhe le t'i paraqesin në Kryesi, në formë të përfundimeve dhe propozimi i dytë është që të bëjmë një pauzë dhe të vazhdohet me listën që është listë shumë e madhe e debatuesve.

Prandaj, ju lutem, kush është për vendimin e parë që sot ta rumbulaksojmë këtë, le të çojë dorën.

(Flitet prej vendit, nuk dëgjohet qartë)

KRYETARI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Kush është kundër, le të çojë dorën. Le të numërohen kundër kush është, sepse për janë shumica.

(Flitet prej vendit, nuk dëgjohet qartë)

A abstenon ndokush për këtë propozim? Nuk ka abstenime. 14 janë kundër.

Prandaj, konstatoj se ka përfunduar debati për pikën e parë të rendit të ditës.

Grupet parlamentare, të gjitha le t'i nxjerrin konkluzat e veta dhe në mbledhje të ardhshme apo tjetër, do t'i aprovojmë.

Tani kemi pauzë gjysmë ore dhe pastaj do të vazhdohet me rendin e ditës.

(Transkriptit i bashkëngjiten diskutimet e dorëzuara me shkrim të deputetëve – të përshkruara nga origjinali: Gani Koci; Blerim Baruti; Lulzim Zeneli; Berat Luzha; Ramadan Kelmendi, Sabile Basha; Sabit Rrustemi)

GANI KOCI:

Siguria: Më duket e pakuptimtë përpjekja e këtij Kuvendi për të debuarit rreth çështjes së sigurisë për faktin se i tërë ky segment shoqëror dhe institucional është kompetencë e UNMIK-ut dhe KFOR-it. Ky Kuvend duhet të debatohet dhe të dali me qendrimin decidiv se Institucionet e Kosovës nuk kanë as më të voglën përgjegjësi për situatën e keqe ose të mirë të sigurisë dhe akuzat dhe fjalet që i hudhen këtyre institucioneve janë të pa baza dhe shfajsim i KFOR-it dhe UNMIK-ut.

Rendi dhe qetësia publike përcaktohen, jo nga sjellja e qytetarëve por nga sjellja dhe veprimet e tyre strukturave që kanë përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe zbatimin e ligjit.

Dialogu: Mendoj se nuk mund të zhvillohet asnjë dialog me SMZ as për të ashtuquajturit “çështje teknike” pa një dialog të hapur dhe serioz ndërmjet gjithë spektrit publik shqiptar dhe pa një marrëveshje publike mbi bazën e së cilës do të bëhej një platformë që do të obligonte të gjitha institucionet shtetërore e politike në çfardo bisedimesh dhe me këdo që të bisedoj për Kosovën dhe të ardhmen e saj.

Qeveria si e tillë është rezultat i marrëveshjes publike, prandaj ajo nuk e ka të drejtën të ofrojë asnjë dokument për bisedimet eventuale, nese ai dokument ose ajo platformë nuk është mbi bazën e një marrëveshje dhe një koncenzusi paraprak të subjekteve politike shqiptare. Deklarimet veç e veç të liderëve politik dhe shtretorë nuk mund të obligojnë askend.

Nuk mund të shkohet në asnjë dialog me Sërbinë nëse paraprakisht nuk definojnë këto çështje:

1. Raportet e institucioneve të Kosovës me ato të UNMIK-ut, të drejtat, detyrimet, dhe kompetencat
2. Niveli i bisedimeve (SMZ-Kosovë, Serbi – Kosovë etj.).
3. Cilat janë çështjet teknike dhe sa prejudikojnë ato statusin e ardhshëm të Kosovës.
4. Cili është roli i bashkësisë ndërkombëtare dhe në veçanti i SHBA-ve në këto bisedime.

Në fund ne mund të pranojmë që UNMIK-u të rijë edhe njëmijë vjet në Kosovë por Sërbinë nuk do ta pranojmë asnjë sekond. Këtë fakt bashkësia ndërkombëtare duhet ta ketë të qartë.

BLERIM BARUTI:

Shqyrtimi i situatës politike në Kosovë

Pas periudhës së emërgjencës dhe rindërtimit – fazës së mbijetesës – Kosova po hyn në fazën e ngritjes së cilësisë së jetës duke u orientuar në forcimin e stabilitetit politik, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik.

Me rastin e këtij debati si një çështje shumë të ndieshme duhet t'i kontribuojmë të gjithë së bashku duke mos u kursyer por duke u angazhuar maksimalisht.

Situata pëolitike do të jetë edhe më e mirë sa më shumë që të respektojmë rendin dhe ligjin në vendin ku po jetojmë, të jemi të ëgjithë të barabartë para ligjit dhe të përgjegjshëm e ndërgjegjshëm në veprimet e sjelljet.

Duhet ta pranojmë realitetin e ri të krijuar në Kosovë. Rrolin e shumicës ndaj pakicës si dhe obligimet e pakicës duhet të jenë në nivel të standarteve. Pakicat duhet të jenë urë e komunikimit e bashkëpunimit dhe të përqendruar në vendin ku jetojnë e mos të jenë të instrumentalizuar nga të tjerët. Në këtë mënyrë edhe proceset integruese të pakicave të arsyetohen në angazhimet e ndersjellta duke i dhënë shansë ardhmërisë dhe lumturisë Kosovare.

LULZIM ZENELI:

I nderuar Kryetar i Parlamentit, Të nderuar deputet,

Të përmbledhësh në formë prezentimi gjendjen aktuale në Kosovë për një periudhë kohore nuk është e lehtë. E them këtë për vetë faktin se dinamika e zhvillimeve politike dhe shoqëror në Kosovë favorizon një konkludim të tillë. Situata aktuale politike dhe zhvillimet e gjithanshme në Kosovë dhe rreth saj shikuar nga prizmë i ndërtimit të prespektivës dhe bazuar në argumentet egzistuese dhe reale mund të konkludojmë se;

Institucionet e Kosovës në këtë fazë me gjithë progresin e shënuar ende s'kanë arritur shkallën e dëshiruar të funksionalizimit të plotë dhe e tërë kjo ka ndodhur si rezultat i ritmit të ngadalësuar të bartjes së përgjegjësive nga autoriteti i UNMIK-ut dhe do të thosha nga PSSP-së tek Institucionet vendore. Një transfer më i shpejtë i kompetencave në këtë relacion do të ndikonte në shtimin e punës dhe efikasitetit të institucioneve vendore në përputhje me përgjegjësin dhe mandatin që kanë.

Mosshtrirja e pushtetit dhe e përgjegjësive të UNMIK-ut në pjesën veriore të Kosovës, konsiderohet edhe sot e kësaj dite hendikepi kryesor i normalizimit e jetës në Kosovë dhe i përmirësimit të gjendjes së sigurisë në vend por edhe më gjërë.

Për këtë çështje që përseritet për të satën herë nga ky vend, kërkohen të ndërmiren masa emergjente dhe funksionale të autoriteteve të UNMIK-ut dhe autoritetëve vendor, çka do të rezultonte me uljen e shkallës së dhunës dhe të provokimeve të vazhdueshme në këtë pjesë të Kosovës.

Natyrisht, duke qenë si përgjegjësi kryesore e UNMIK-ut dhe autoritete të tjera, por duhet gjithsesi që institucionet tona të angazhohen më shumë në drejtim të pasqyrtimit real të pozitës së tyre karshi të gjitha sfidave që janë prezente thujtse në vazhdimësi.

Gjendja e sigurisë ashtu siç e dimë të gjithë, varion me shifra të ndryshme, varësisht nga koha dhe situata. Shperthimet dhe vrasjet e fundit që kanë ndodhur në Kosovë, s'janë asgjë tjetër veçse një përpjekje e disa grupeve dhe individëve që të zbehin imazhin e Kosovës para bashkësisë ndërkombëtare, të minojnë progresin dhe të arriturat e gjertanishme në Kosovë në këto vitet e fundit.

Vlerësoj se KFOR-i, Policia e UNMIK-ut, SHPK-ja me një angazhim shumë më të madhë dhe me një bashkpunim të ndërsjelltë, do të mund të ndikonin shumë në uljen e shkallës së krimit dhe të avansimit të premisave të përmirësimit e gjendjes së sigurisë në Kosovë.

Një ndërë çështjet kyqe të politikës vendore, që ndërlidhet pashmangshëm me shumë procese në vend dhe në rajon është politika e jashtme dhe bashkëpunimi në sferën ndërkombëtare. Konsideroj se shtimi i kontakteve me institucionet ndërkombëtare, intesifikimi i përpjekjeve për ndërlidhje dhe bashkëpunim ndërkombëtar do të shënonte hapa pozitiv në konsolidimin e mëtejme dhe avancimin e demokracisë vendore si dhe krijimit të një pasqyre më reale për gjendjen faktike në Kosovë para institucioneve dhe opinionit ndërkombëtar.

Në këtë drejtim institucioneve të Kosovës duke filluar nga Presidenti i Kosovës. Qeverisë dhe parlamentit të Kosovës t'ju krijohet dhe të kenë mundësi dhe hapsirë të ushtrimit të përgjigjesive në këtë fushë dhe një herë e përgjithmonë të tejkalohet kjo barierë e izolimit që për fatë të keqë po vazhdon.

Dhe së fundit, çështja e fillimit të kontakteve apo bisedimeve për çështje praktike me Unionin Serbi dhe Mali i Zi.

Në këtë mes qëndrimi ynë është më se i qartë, çdo hap apo çdo veprim që ndërmirret duhet të jetë pjesë e projektit që korospondon me vullnetin dhe përcaktimin e popullit të Kosovës, duhet të jetë pjesë e procesit të afirmimit tonë në jetësimin e vullnetit të qytetarëve të Kosovës.

Që të kemi një proces rezultativ, nga praktikat e mëhershme dhe të njohura mirë, nevojitet kohë dhe përgaditje duke potencuar në këtë mes angazhimin e drejtpërdrejt dhe rolin udhëheqës të bashkësisë ndërkombëtare, në rend të parë të SHBA-së dhe Unionit Evropian.

Kosova, ashtu siç ka ditur dhe dëshmuar në të kaluarën, ashtu edhe tani duhet të dëshmojë dhe të afirmoj përcaktimin e vet të njohur për prosperitet dhe stabilitet të vazhdueshëm në rajon.

Të nderuar deputet,

Kosova tashmë përfundimisht ka hyrë në një proces të pandalshëm dhe të pakthyeshëm të përcaktimit dhe të ndërtimit të së ardhmes së vet, e ky përcaktim varet drejtpërsëdrejti nga angazhimi dhe përkushtimi ynë në krijimin hapësirave të reja për një të ardhme çfarë e dëshirojmë të gjithë ne.

Puna, angazhimi dhe vendosmeria në këtë drejtim është esenciale dhe ajo duhet të jetë e përbashkët, kjo është garanca jonë e sigurt dhe alternativa e vetme për një ardhmeri të Kosovës,

Nga ne këtë e presim qytetarët e Kosovës, këtë e presin edhe miqët tanë, fundi këtë e kemi obligim. Ju faleminderit!

BERAT LUZHA:

Të nderuar kolegë,

Kuvendi me vonesë e shqyrton situatën politike, në të cilën ndodhet Kosova, kurse përkeqësimit të kësaj situate po i kontribuon çdo ditë regjimi në Beograd, i cili ndaj Kosovës ka po atë çasje që kishte edhe regjimi i Milosheviqit. Beogradi, hapur dhe pa pengesa nga bashkësia ndërkombëate, po vepron në dëm të të ardhmes së Kosovës, kurse institucionet tona dhe klasa jonë politike heshtin deri në absurd.

Është paradoksale se si, si rrethanë rënduese për Kosovën, merren disa raste të veçuara të vrasjeve enigmatike. Për këto vrasje, jo vetëm strukturat e shtetit serb, por edhe disa qarqe ndërkombëtare, i akuzojnë dhe i shpallin fajtorë apriori shqiptarët. Si është e mundur që vrasjet e pasqaruara, edhe atëherë kur policia dhe organet tjera kompetente deklarojnë se nuk dijnë gjë, t'i ngarkohen një etniteti të tërë dhe në gjykatore të nxirret vetë Kosova.

Ne e dimë, kolegë të nderuar, se vrasjet përshkruhen si shumë profesionale dhe e dimë se kush janë profesionista të vrasjeve në Kosovë. Ne e dimë se në Kosovë ka shumë shërbime sekrete nga shumë vende të botës dhe sidomos ekziston sigurimi famëkeq serb, i cili, si në të kaluarën, edhe sot, është jetësisht i interesuar ta destabilizojë Kosovën. Nëse Beogradi thotë se vrasjet kanë autorë shqiptarë, pse ne të mos dyshojmë se ato i bëjnë vetë ata që bëjnë me gisht nga ne, me qellim që të arrijnë efekte politike. Dihet se nga këto vrasje nuk fitojnë asgjë shqiptarët. Ata, përkundrazi, humbin dhe humbin shumë. Nga logjika e thjeshtë del se askush nuk vepron kundër vetëvetes, që të humbë. Derisa nuk kemi konfirmime zyrtare për autorët e krimeve, derisa për këtë nuk dinë as institucionet kompetente vendore e ndërkombëte, logjika na thotë se krimet mostruoze i bën ai që fiton nga ato. Kjo ka ndodhur në Kosovë në të kaluarën. Të kujtojmë rastin e Martinoviç para disa vjetëve, rast i cili u ekspluatua aq shumë për interesa politike të regjimit të Milosheviqit e kundër popullit shqiptar.

Na thotë mendja se autorët e krimeve i dijnë ata që deklarojnë se ishin në dijeni qëmë parë se do të ndodhte krimi. Gjithashtu, autorë mund të jenë ata që kanë në të kaluarën dhe që vrasin ende, ata që i vërsulen me arrogancë çdo tentative për stabilizimin e Kosovës. Kosovarët janë jetësisht të interesuar të të mos ndodhin vrasje, sidomos vrasje enigmatike dhe ndërnacionale. Ne jemi të interesuar të stabilizohet sa më shpejt Kosova dhe këtë ia kemi arritur në pjesën më të madhe.

Mendoj se është detyrë e Kuvendit që sot t'i përgjigjet provokimeve të Beogradit me hedhjen poshtë të të gjitha akteve që i ka nxjerrë në mënyrë të

njëanshme për Kosovën. Këtë e pret opinionin nga ne. Gjithashtu, në bisedimet me Serbinë e me Malin e Zi, duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Jo njëherë jemi mashtruar dhe kemi pësuar nga bisedime të improvizuara, të pabarabarta e të pasinqerta. Institucionet e Kosovës, nuk do të duhej të shkojnë në bisedime, çfardoqofshin ato, teknike apo politike, të paprgatitura dhe pa një platformë të përbashkët, që do ta nxirrte ky Kuvend. Përgjegjësia eventuale do të binte te institucionet tona dhe te forcat politike.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar – të nderuar deputet

Kur ne shqyrtojmë situatën politike e të sigurisë në Kosovë, duhet të nisemi nga këta dy faktor:

1. Cilat janë kompetencat e Kosovarëve në ndikimin e rrjedhave të proceseve politike pozitive apo negative për të krijuar kushte më të mira të sigurisë.
2. Dhe dy – sa janë të mvarura këto procese politike nga ngjarjet në shtetet fqinjë – në rajon dhe në Qendrat e vendimarrjes.

Gjendja e sigurisë në Kosovë - krahasuar me atë kohë se afërt është shumë e mirë ndonëse ne nuk jemi të kënaqur me nivelin e arritur të sigurisë dhe proceset politike në Kosovë.

Për këtë flasin disa ngjarje të fundit të cilat ishin të pa dëshiruara për ne. Në veçanti rrjedha e proceseve politike dhe pasiguria qytetare që dominon tani mbi katër vite në Kosovën veriore krijon shqetësime të mëdha, nga se në këtë pjesë të Kosovës ende nuk është siguruar liria e qarkullimit si. Psh. në tërë pjesën veriore të qytetit në fshatrat shqiptare të Leposaviçit nuk mundësohet kthimi i qytetarëve në pronat dhe shtëpit e tyre si dhe akoma nuk bisedohet për 26.836 refugjat shqiptarë që jetojnë në kushte shumë të rënda në Mitrovicë dhe gjetiu.

Mbështetur në të dhënat statistikore të krimit dhe numri i përqindjeve (%) në raport me popullsin rezulton se Kosova ka shkallën më të ulët të kriminalitetit, kur kësaj i shtohet fakti se Kosova posa ka dalë nga një gjenocid i tmershëm, ku jeta zhvillohet pa ligje autokton – Kosova nuk është vend i pa sigurt dhe as burim i pasigurisë në raport me shtetet fqinjë.

Me gjithë këtë; faktorët që ndikojnë në atë që Kosova të trajtohet si shtet me pasiguri jo të plotë janë:

1. Sjelljet e vazhdueshme të Beogradit, duke i përdorur gjitha metodat për ta destabilizue Kosovën, proces në të cilin janë angazhuar edhe serbët e Kosovës.
2. Politika permanente e Serbisë që përmes formave gjëja – Kushtetuese, Kosovën ta kthje nën juridikcionin e Serbisë.
3. Mos reagimi me kohë dhe adekuate i Bashkësisë Evropiane, Këshillit të Europës, OKB, Institucioneve dhe mekanizmave ndërkombëtare të Instaluar në Kosovë ndaj politikës së Beogradit të orjentuara kundër Kosovës dhe popullit shumicë të saj.
4. Kompetencat jo të plota të Qeverisë së Kosovës, organeve të drejtësisë dhe të shërbimit policor e në veçanti mungesa e Ministrisë së drejtësisë kushtëzojnë pamundësin e një sigurie më të mirë.
5. Mos ndalimi dhe pengimi i veprimve të disa shërbimeve policore sekrete të Serbisë në Kosovë, (në veri të Kosovës-enklava) dhe fillimi i ndërtimit të Kishës ortodokse në veri të Mitrovicës.
6. Deklaratat armiqësore të politikanëve serb ndaj Kosovës dhe shqiptarëve të saj.
7. Mos zbulimi i asnjë rasti të krimit dhe denoncimi aprior politik i shqiptarëve për to.
8. Mos definimi i çartë i standardeve për Kosovën, nga se standardet duhet ditur paraprakisht për cilin nivel zhvillohen: për ndonjë far autonomie, autonomi të zgjeruar – çdo herë mbrenda Serbisë apo ndonjë Republikë federale mbrenda Unionit S-MZ, apo për shtetin e pavarur të Kosovës për të cilin është përcaktuar shumica e popullit.
9. Mungesa e Ministrisë së drejtësisë dhe mos zbatimin i Ligjit.
10. Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik.
11. Shkalla e lartë e papunësisë, dhe gjendja e rëndë sociale,
12. Zhvillimi i situatës në procesin e privatizimit dhe paknaqësit që burojnë nga ky proces.
13. Mos nënshkrimi i disa Ligjeve që ka miratuar ky Kuvend nga përfaqësuesi special i sekretarit të KS të OKB-së.

14. Mos integrimi i plotë politik, ekonomik, Juridik e administrativë i Kosovës – provë 18,83% të teritorit të Kosovës Veriore – mbi të cilën Serbia nuk po e varros iden e sundimit të Kosovës.

Ka edhe disa faktor tjerë që ndikojnë në proceset politike dhe sigurimin në Kosovë. **Ju faleminderit!**

SABILE BASHA:

I nderuari zoti kryetar, Deputetë të nderuar

Polarizimet e qëndrimeve në rrjedhat historike të Kosovës dhe Serbisë që nga fillimi kanë qenë diametralisht në kahje jo të njejta.

Duke i përcjellë ngjarjet historiko-politike nëpër kohë si ne aspektin historiko-politik dhe profesionalo shkencor lehtë mund të përvijohen relacionet, ngjarjet dhe kohërat të cilat u regjistruan jo vetëm në shkrimet historike por edhe në kujtesat tona e të gjeneratëve të tjera, për pasojat e dhembëshme që i shkaktoj ndarja teritoriale nga fuqitë e mëdha në Konferenca ndërkombëtare.

Gjatë gjithë historisë dhe shekujve në këtë pjesë të Ballkanit perëndimor, shqiptarët që mbeten jashtë teritorit administrativo-politik shqiptarë, lanë gjurmët e një popullate të përvuajturë të përcjellur me vuajtje, skamje, asgjatime, tortura, burgosje, debime dhe deportime ndër më të ndryshmet që Serbia i kishte përgaditur në Elaboratet e veta për çfarosjen e shqiptarëve e cila u dëshmuar deri në muajt e fundit të dekadës të shekullit të kaluar.

Ata të cilët filluan të luftojnë prë diç më shumë të drejta, filluan të ndiqen dhe burgosen deri më tri dekada. Vorrezat e të përndjekurve politik shqiptar sot gjenden edhe te shtetet më demokratike e evropiane, e mos të flasim për varrezat e ndryshme masive të viteve të fundit të cilat shtrihen që nga viset më të thella të Kosovës e deri të metropila më e madhe e Serbisë-Beogradit.

Parashtrohet pyetja, si mund të flitet për hapjen e bisedimeve kur dihet se ende nuk janë tharë vorrezat e nuk janë gjetur as të zhdukurit e mos të flasim për shkatrimet dhe dëmet materiale.

Dhe bota më në fund u bind për Serbinë hegjemoniste dhe primitivizimin e treguar ndaj shqiptarëve. Serbia do të duhej që para se të kërkoj falje për të gjitha të bëmet ndaj shqiptarëve gjatë gjithë një shekulli e më tepër, e sidomos në dekadën e fundit, do të duhej të insistoj për një fqinjësi të mundshme, të mirë po e theksojë, nëse është e mundur, ndërsa sa u përket miqëve ne do të dijmë ti

zgjedhim vet. Prandaj, edhe bota më është mësuar më qëllimet agresive të Serbisë dhe nuk duhet që agresivitetet e saja

juridiko-politike ti tolerojë edhe më tutje, sepse ato tensionojnë situatën në rajon. Prandaj finalizimi i statusit të Kosovës shtet të pavarur dhe sovran do e lehtëson dhe do çartëson nivelin e bisedimeve me Serbinë si partnere e barabartë siç po thuhet për raste teknike.

Tani, parashtrohet pyetja për bisedime me Serbinë. E ne e dijmë se ato janë zhvilluar edhe në kushte dhe rrethana kur ka qenë situatë e paeskaluar, dhe jo njëherë, por rezultatet kanë qenë ato që janë pritur prapa rezultate. Andaj çdo bised me Serbinë do zgjasin në pakufi dhe rezultatet dihen.

Do të shtoja, se faktori ndërkombëtar, do të duhej ta ketë në dijeni se në shqiptarët jemi të lodhur nga padrejtësitë e shumta që na u kurdisën gjatë shekujve. Jemi të lodhur nga ideologjit e huaja, dhe jemi të lodhur nga robëria shekullore në trojet tona. Dhe njëherë e përgjithmon duhet treguar si faktorit ndërkombëtar njëashtu edhe atij vendor se gjithëçka është e kapërcyeshme, përveqë se nëse është fjala për rirobërim. Kurrë më këmbë okupuse serbe dhe e askujt tjetër mbi trollin e lënduar të Kosovës. Qytetari kosovar tani më nuk është i detyruar të mendoj për lirin. Situata e tanishme e tij është, si ta ruaj ate, dhe ta legalizoj ndërkombëtarisht shtetin e ri të Kosovës. Jam e bindur thell se kjo do të ndodhë, varësisht se në ç'shikallë do të bëhen integrimet, jo vetëm si procese mbrenda etnisë dhe rajonit, por edhe në aspektin më të gjerë të globalizimit. Më në fund ishte ajo vetëdije politike që nuk na mungoi asnjëherë për sublimimin e të gjitha aspiratave shekullore të popullit për qëllimin suprem pra-për lirin dhe pavarsin e Kosovës.

SABIT RRUSTEMI:

Situata politike në Kosovë

Pavarësisht gjërësisë së temës për debat, më duket se strumbullari më i madh që karakterizon gjendjen politike në Kosovë, së paku në këta gjashtë muajt e fundit, është pikërisht njëri nga tetë standardet e bashkësisë ndërkombëtare karshi Kosovës, dialogu me Beogradin.

Rreth këtij strumbullari janë sjellur e pështjellur thuaja të gjitha zhvillimet tjera politike, të cilat ose kanë dashur për ta stimuluar këtë dialog, ose për ta penguar. E s'do mend si gjithëherë, edhe një pjesë që ka shprehur dhe ende mbanë hezitimet e veta karshi këtij dialogu apo thënë më drejtë, bisedave për çështje teknike-praktike që kanë të bëjnë mes Kosovës dhe federeatës serbo-malazeze.

Mendoj se faktori shqiptarë, në këtë rast krerët e institucioneve shtetërore dhe politike të Kosovës janë përpjekur për ta bërë krejt atë që varet prej tyre. Shembull konkret përveç tjerash është edhe apeli drejtuar qytetarëve të Kosovës të cilët për arsye që tashmë dihen, janë zhvendosur nga Kosova, me përfundimin e luftës. Një apel që ka të bëjë para së gjithash për serbët dhe lojalët e tyre gjatë regjimit të kaluar, për t'u kthyer në shtëpitë dhe pronat e veta në Kosovë.

Ky shembull i udhëheqësve kosovar u mirëprit edhe në opinionin kosovar po edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Posaqërisht edhe nga OKB, gjegjësisht Këshilli i Sigurimit, në raportimin e fundit për Kosovën nga ish administratori Mihael Shtajner.

Për fat të keq, vetëm nga serbët e Kosovës po edhe jashtë Kosovës pati hezitime ndaj këtij apeli si dhe kundërreagime për ta zhvleftësuar atë. Faktori politik shqiptar, i ndërgjegjësuar në masë të mirë, e pranoi këtë apel si një realitet kosovar dhe nuk pati kundërreagime.

Por, imazhi i mirë që iu rikthye Kosovës, është halë në sy për Beogradin. Unë këtë e ilustruj me incidentet e dhimbshme por tejet të dyshimta që ndodhën gjatë kësaj vere në Kosovë, ku u dëmtuan qytetarë serbë. Por, u bënë përpjekje edhe për ta përmbysur atë imazh për Kosovën dhe për shqiptarët duke aluduar në ta, pas veprave mizore që u kryen në Gorazhdec, Cërnice po më parë edhe në Kastriot dhe në disa pjesë tjera ku shtrihen fshatra serbe në Kosovë, një pjesë e të cilave dolën si incidente të shpifura apo të inskenuara.

Është për keqardhje që organet e sigurisë dhe të hetuesisë, kryekëput ndërkombëtarë, që nuk po i zbardhin këto incidente tragjike më shpejtë apo, nuk po janë më vigjilentë për t'i penguar para se të ndodhin.

Në këtë mbase po ndikon edhe moskontrolli fare i kufijve të Kosovës dhe depërtimi i elementëve ekstremë veçanërisht në momente të ndijshme dhe me interes për Kosovën. Prandaj edhe po krijohet hapësirë për të aluduar po edhe për të manipuluar për Kosovën dhe në kurriz të shqiptarëve, si gjithëherë që është bërë nga ana e Serbisë.

Unë këtu, vë në spikamë edhe moszbardhjen e shumë krimeve të rënda që kanë ndodhur edhe kundër shumë emrave të shqiptarëve në Kosovën e pasluftës, të cilët ishin figura politike e atdhetare të Kosovës, pa i përjashtuar edhe figurat ushtarake, të cilat u vranë në rrethana misterioze.

Po të bashkëpunohej më tepër me elementin vendor të Kosovës, gjithsesi me Shërbimin policor të Kosovës, gjegjësisht po të bartej një pjesë e përgjegjësive

të sigurisë dhe hetuesisë tek vetë kosovarët, këto incidente do të zbardheshin më shpejtë po, mbase edhe do të priteshin që në nismë, pa ndodhur.

Kjo, me kusht që kufijtë e Kosovës të jenë të mbikqyrur non-stop 24 orë, në mënyrë që të dihet kush po hyn e kush po del nga Kosova, në ç'kohë dhe përse.

Tash për tash një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Po ka ndodhur ajo tjetra, tjetërsimi i tokës së Kosovës, pikërisht në kufijtë e saj, një përgjegjësi kjo e OKB-së, së cilës nuk i është dalur zot.

Në kontest me dialogun dhe pengimin e tij, unë ndërlidhë edhe tendencat tashmë naive të Beogradit që përmes deklaratave apo preambulave kushtetuese tentojnë përfshirjen e Kosovës, duke bërë agresion kushtetues si dhe duke nxitur e keqpërdorur sërish serbët e Kosovës, për qëllime të ngjashme me regjimin e kaluar.

Ne jemi deklaruar edhe më parë ndaj këtyre tendencave. Kjo s'do të thotë që s'duhet të deklarohemi sërish po, jo edhe të trazohemi pas çdo karremi që lëshohet prej Beogradit kur tashmë e dijme se është një realitet krejt tjetër këtu, janë edhe dokumentet ndërkombëtare bashkë me praninë e tyre këtu dhe, këto i obligojnë si neve ashtu edhe të tjerët rreth nesh.

Fatmirësisht, s'hqiptarët në Kosovë përherë kanë qenë për dialog dhe zgjidhje paqësore. Këtë e kemi dëshmuar edhe në rrethanat më të rënda të ekzistencës sonë, në fillimin e viteve nëntëdhjeta përmes peticionit "Me dialog kundër dhunës" dhe në vazhdimësi. Edhe tash, jo pse këtë e kërkon më këmbëngulje bashkësia ndërkombëtare. Po, pse dialogu gjithëherë dhe në çdo kohë ka qenë intencë jona.

Edhe kësaj radhe, nuk kemi arsye për të hezitur. Por, me dinjitet dhe të përgatitur ta kryejmë punën për të cilën jemi mandatuar dhe obliguar.

Si Kuvend për ta mbështetur këtë dialog. Si Qeveri për t'u përgatitur si duhet për këto biseda, në mënyrë që përmes tyre ta bëjmë hapin më të madh drejt shtetësisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Andaj, duke krijuar një klimë më të mirë për këto biseda, duke ju kontribuar për të mirë dhe në favor të realitetit të Kosovës dhe pavarësisë së saj sidomos nga serbët e Kosovës, do të krijoheshin rrethana dhe kushte më të mira edhe për jetësimin e projekteve tjera siç janë kthimi i të zhvendosurve shpërlyer nëpër shtëpitë dhe pronat e veta. Por, edhe zbardhja e fatit për mijëra shqiptarëve të zhdukur.

Institucionet e Kosovës dhe subjektet politike shqiptare më shumicën dërmuese të qytetarëve të saj, janë të orientuar në zhvillimin e mbarë dhe të sukseshëm të këtyre proceseve që ngrisin edhe më lartë shkallën e tolerancës, mirëkuptimit dhe përgjithësisht të demokracisë në Kosovë, e cila dosido do të rezultojë me pavarësimin e saj.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

(Vazhdimin e seancës plenare e kryesoi Hydajet Hyseni, bashkëkryesues, anëtar i Kryesisë së Kuvendit)

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Të nderuar deputetë, ju lutem për vëmendjen tuaj. Do të presim edhe pak për të filluar punën.

Të nderuar deputetë, meqë kemi edhe kuorumin e nevojshëm, dhe sipas rendit të ditës, pas një pauze të zgjatur e të stërzgatur, nëse jeni dakord fillojmë me punën.

Në rend dite kemi shqyrtimin e dy projektligjeve:

Projektligjin për produktet dhe pajisjet medicinale; pastaj Projektligjin për inspektoratin sanitar dhe pikat tjera vijuese.

Projektligji për produktet dhe pajisjet sanitare u është shpërndarë deputetëve me kohë.

Besoj se materialet i keni marrë. E pranishme është edhe ministresha e shëndetësisë, zonja Resmije Mumxhiu, të cilën e përshëndesim sepse, me sa e di, është hera e parë që merr pjesë në Kuvend. Zonja ministre e keni fjalën.

RESMIJE MUMXHIU:

Ju falemnderit. Do të mundohem të flas në gjuhën shqipe që t'ua lehtësoj përkthimin, për mos me angazhua përkthyesin. Më parë, kërkoj falje për gabimet të cilat mund t'i bëj gjatë leximit të tekstit.

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë dhe kolegë,

Kam kënaqësi sot para jush të bëj prezentimin e ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale. Më lejoni që së pari të theksoj disa fakte në lidhje me këtë sferë të legjislacionit para se të hyj në sqarimin e mëtutjeshëm të përmbajtjes së ligjit.

Kosova është rajon i vetmi në kontinentin e Evropës që nuk ka ligj që rregullon këtë sferë të rëndësishme dhe esenciale për shëndetin e përgjithshëm publik. Fakti se na mungon një ligj i këtillë është mëse alarmant, meqenëse derisa të rregullohet kjo sferë e legjislacionit shëndeti publik mbetet i rrezikuar nga produktet dhe pajisjet medicinale, të cilat vazhdojnë të vërshojnë tregun e Kosovës me një kontroll superficiale në mungesë të ligjit me anë të të cilit do të vihej baza ligjore që kontrollon edhe sigurimin e pajisjeve dhe produkteve medicinale që importohet dhe prodhohet në Kosovë të jenë të kualitetit të duhur.

Do të mundohem që të mos marr shumë kohë nga koha juaj e çmuar, kështu që po ju bëj një prezentim të shkurtër për esencën e ligjit, meqenëse e keni ju para veti dhe do ta shqyrtoni edhe nëpër komisionet parlamentare përkatëse.

Ligji përmban 5 kapituj.

Kapitulli i parë, përmban dispozitat e përgjithshme ku përfshihen qëllimi dhe aplikimi i ligjit; definicionit dhe rregullat e interpretimit të ligjit dhe autoritetet kompetente për mbikëqyrje e implementim të ligjit.

Kapitulli i dytë. Ky kapitull është edhe kurriz i këtij ligji. Titullohet – produktet medicinale. Kapitulli përmban dispozitat që rregullojnë pa përjashtim të gjitha sferat dhe aspektet e produkteve medicinale, apo përndryshe barnave, duke filluar që nga prodhimi, importi, eksporti, tregtimi i tyre me shumicë, dispensimi dhe qarkullimi farmaceutik me pakicë, prodhimi i tyre në farmaci dhe laboratore galenike, autorizimi i marketingut për produktet medicinale, klasifikimi i statusit të dispozitave të tyre, hulumtimet kimike. Ky kapitull gjithashtu përmban edhe rregullat që praktikohen në shtetet me zhvillim të lartë mbi reklamimin dhe promovimin e garancionin e kualitetit të produkteve medicinale, farmakovigjilencën, shkatërrimin e produkteve medicinale që mund të jenë të dëmshme për mjedisin si dhe dispozitat mbi garancionin e kualitetit të produkteve imunologjike, medicinale dhe produkteve medicinale të derivuara nga gjaku apo plazma e njerëzve.

Me fjalë të tjera, ky kapitull që, siç e thash edhe më parë, është esencë e këtij ligji, është hartuar në mënyrë që të jetë kompatibil, me standarde farmaceutike evropiane, por në të njëjtën kohë janë marrë parasysh edhe specifikat dhe realiteti i kësaj materie në vendin tonë.

Kapitulli i tretë. Kapitulli i tretë përmban gjithashtu dispozitat që rregullojnë sferën e pajisjeve medicinale. Këtu desha të përmendi edhe faktin që jo pse jemi reon i vetmi gjeografik në Evropë që kishte mungesën e këtij ligji, pajisjet medicinale, domethënë materia që rregullon ky kapitull, kanë qenë të neglizhuara plotësisht, pajisjet medicinale kanë hyrë në treg tonin të Kosovës pa përmbushje të asnjë standardi më të ulët të kualitetit dhe efikasitetit për përdorimin e tyre. Me implementimin e këtij ligji, jemi të sigurtë se kjo situatë do të ndryshohet. Këtu kemi përfshirë dispozitat që rregullojnë klasifikimin e pajisjeve medicinale, plasimin e tyre në treg, vënia në shërbim, etiketimin, prodhimin, import-eksportin e tyre, përdorimin e tyre profesional, mbikëqyrjen e rregullimit të tyre, përfshirë këtu edhe monitorimin e efekteve që mund të dalin nga përdorimi i tyre, si dhe çështjet tjera të natyrës profesionale të kësaj fushe.

Kapitulli i katërtë. Ky kapitull qeverisë, strukturon funksionet dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për zbatimin e këtij ligji. Përgjegjësinë për zbatimin e ligjit e mban Agjencioni i Kosovës për produktet dhe pajisjet medicinale, nën jurisdikcionin e Ministrisë dhe që është shtylla e ministrisë të destinaura specifikisht për këtë sektor. Domethënë, për sektorin farmaceuti, përgjegjësi të pjesërisht për zbatimin e këtij ligji mban edhe shërbimi veterinar i Kosovës, në ato sfera ku ligji rregullon produktet medicinale për veterinarin.

Dhe kapitulli i pestë, kapitulli i fundit. Ky kapitull përmban dispozitat, standardet që përfshijnë çdo legjislacion modern dhe që përmban nënshkrimet globale, dispozitat kalimtare dhe ato përfundimtare, domethënë mbajnë përmbylljen e ligjit me dispozita sigurie në radhë të parë përmasat që duhen ndërmarrë në rastin e shkeljes flagrante të dispozitave të këtij ligji dhe procedurave të tij dhe abuzimet tjera që mund të bëhen me anë të keqinterpretimit të dispozitave të këtij ligji.

Si përfundim të prezentimit të esencës së ligjit, duhet të theksohet se ligji për produktet e pajisjet medicinale është përpiluar nga ekspertët kombëtar dhe ndërkombëtar që kanë një përvojë të gjatë në këtë fushë dhe që një pjesë e tyre kanë marrë pjesë në përpilimin e ligjeve të këtij lloji në rajon, kështu që janë marrë parasysh edhe përvojat rajonale që kanë të ngjarë me realitetin e Kosovës nga ky aspekt.

Ligji është kompatibil, me legjislacion evropian dhe të gjitha konventat ndërkombëtare të kësaj fushe, nga çdo pikëpamje. Megjithatë, sikur që e ceka edhe më sipër, gjithmonë janë marrë parasysh specifikat dhe realiteti në Kosovë me qëllim që zbatimi i tij të jetë sa më efektiv dhe i përshtatshëm kushteve tona.

Më lejoni, i nderuar kryesues, të nderuar deputetë, që në përmbyllje të këtij prezentimi, të theksoj edhe njëherë nevojën urgjente me të cilën përballohet Kosova sot për rregullimin e kësaj sfere të shëndetësisë së popullsisë së Kosovës

dhe me këtë rast të apeloj edhe një herë për mirëkuptimin tuaj në procedimin sa më të shpejtë drejt miratimit dhe fuqizimit të këtij ligji. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë zonjën ministre për ekspozenë... Do të dëshiroj të përkujtoj se në fund të debatit është mundësia për t'iu paraqitur përsëri Kuvendit me sqarime të nevojshme, nëse konsiderohet nevoja për t'iu paraqitur.

Hapim debatin për shqyrtimin e Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale.

Sipas procedurës së pari komisionet parlamentare, Komisioni funksional, pastaj komisionet e mëdha, grupet parlamentare nëse konsiderojnë të nevojshme natyrisht të marrin fjalën dhe të japin mendimin e tyre dhe më vonë deputetët e interesuar. Propozoj që derisa të dëgjojmë paraqitjet e përfaqësuesve të komisioneve parlamentare edhe të bëhet paraqitja e diskutantëve të interesuar, në mënyrë që pasi të mbyllet lista e të paraqiturve të dijmë dhe planifikojmë kohën sa do të zgjasë dhe të mos na gjenerojnë diskutimet prej diskutimi në diskutim.

Fjalën e ka kërkuar në emër të Komisionit funksional për çështje medicinale, zonja Nafije Gash.

NAFIJE GASH:

Sayın başkanvekili, değerli bakanlar, değerli Kosova milletvekilleri,

Si kryetare e Komisionit për shëndetësi, pas leximit të Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale, konsideroj se ky Projektligj duhet të miratohet në shqyrtimin e parë, sepse siguron bazën themelore për rregullimin e të gjitha aspekteve për sigurimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale dhe rrespektimin e standardeve me qëllim të sigurimit të cilësisë e të mbrojtjes së shëndetit të popullsisë së Kosovës, si dhe në normimin e veprimtarisë në lëminë farmaceutike, ashtu edhe në mbrojtjen e furnizuesve e të shfrytëzuesve të produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Të metat në rregullimin e disa çështjeve që parashihen me këtë Projektligj do të përmirësohen gjatë shqyrtimit në komisione. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë zonjën Gash.

Pyes, a janë përfaqësuesit e komisioneve të mëdha të interesuar t'i drejtohen Kuvendit.

Nëse jo, në radhë janë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Fjalën e ka kërkuar në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike zoti Naim Jerliu.

NAIM JERLIU:

I nderuari kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Është shumë e qartë se Kosovës i ka munguar legjislacioni përkatës i cili i referohet lëmisë së produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale, prandaj me anë të këtij Projektligji pretendohet të mbulohen zbrastësitë që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Duke marrë parasysh se, siç u tha në prezentimin e ekspozesë së ministres Kosova është pothuaj si i vetmi vend në Evropë pa një legjislacion të tillë dhe bazë për rregullimin e qarkullimit dhe elementeve tjera që kanë të bëjnë me produktet dhe pajisjet medicinale, sigurisht se është i pashmangshëm konkludimi se një situatë e tillë është e rrezikshme jo vetëm për Kosovën por edhe më gjerë. Prandaj, është shumë e kuptueshme që një propozimligj i këtillë, Projektligj i këtillë pretendon të sigurojë bazën e nevojshme fundamentale për rregullim të të gjitha aspekteve në lidhje me kualitetin, sigurinë dhe efikasitetin e produkteve medicinale dhe të pajisjeve medicinale me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të popullatës së Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka shqyrtuar me vëmendje këtë propozimligj dhe ashtu kemi patur goxha kohë që ta shqyrtojmë për arsye se është kohë të gjatë në procedurë parlamentare, prandaj më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës të theksoj se ne mbështesim miratimin në parim, në leximin e parë të këtij Projektligji, para se gjithash duke patur parasysh rëndësinë e tij si legjislacion që mbulon një fushë shumë të rëndësishme dhe po ashtu me synimin që në statet tjera, në statet pasuese të mirren në konsideratë mungesat dhe po ashtu ofrimin të zgjidhjeve joadekuate të propozuara në këtë Projektligj, për çështje në fushën që pretendon të mbulojë Projektligji.

Megjithatë, më lejoni që shkurtazi t'i qasem disa nga vërejtjet që çdonjëri prej jush që ka lexuar me vëmendje bie në sy në këtë dokument dhe fillimisht dua të

them me keqardhje se edhe ky Projektligj vjen para nesh si një dokument që përëshkruhet nga një gjuhë, thënë thjesht, vështirë e kuptueshme, që duket që vie për pasojë të përkthimit apo interpretimit të dobët të materies së adoptuar nga dokumente evropiane dhe ndërkombëtare që janë marrë për bazë gjatë përpilimit apo hartimit të tij.

Ky është një fenomen që po e përcjell punën e këtij Parlamenti dhe nuk është e çuditshme që në këtë Projektligj do të gjeni formulime me plot gabime, lëshime, paqartësi teknike e gjuhësore, deri në nivelin e ndryshimeve në përmbajtje nga teksti në versione të ndryshme gjuhësore.

Unë do të përmendi vetëm një shembull, që në dukje të parë, mund të jetë lëshim i vogël, por që në përmbajtje është esenciale. Për shembull në versionin shqip kemi përdorim të fjalës së shprehur "fiziologjike", në vend të fjalës "psikologjike". Për ata që marrin vesh këtë lëmi kjo do të thotë ndryshim esencial.

Mendoj se një gjuhë e këtillë e përbën këtë dokument, këtë Projektligj shumë të komplikuar për t'u interpretuar në të ardhmen dhe neve do t'na mbetet që në procedimin e mëtejshëm të kemi punë në amendamentim dhe përmirësim përmbajtësor të Projektligjit, të merremi krahas kësaj edhe me aspekte tjera, pra të përmirësimit të gabimeve tjera gjuhësore të përkthimit me të cilat normalisht ne si Parlament nuk do të duhej të mirremi.

Unë gjithashtu dua të theksoj se për bindjen time Projektligji pretendon të rregullojë dhe përcaktojë detyra edhe në fushat që normalisht nuk do të duhej të binin në domenin e një legjislacioni të këtillë, pra i takojnë një domeni tjetër, siç është për shembull rasti me trajtimin e fushës së import-eksportit në sferën e veprimtarisë që adreson ky Projektligj.

Gjithashtu, një mangësi tjetër për mua është adresimi që Projektligji i bën agjencisë kosovare për produkte medicinale duke i dhënë kompetenca të cilat nuk janë në përputhje me kompetenca dhe detyra më të shpeshta të agjencioneve të këtilla në Evropë dhe në botë.

Projektligji, po ashtu, jo vetëm një herë, në disa raste u referohet rregulloreve të caktuara të UNMIK-t, të cilat referime për mua janë të pakuptimta dhe të panevojshme kur dihet se me aprovimin e këtij ligji ky do të jetë legjislacioni në fuqi për fushën të cilën e rregullon.

Megjithatë, më lejoni ta përfundoj. Duke patur parasysh rëndësinë dhe nevojën e një ligji të kësaj natyre për Kosovën, por para se gjithash duke besuar në mundësitë që këtë Projektligj ta përmirësojmë dhe begatojmë ndjeshëm gjatë procesit të leximit të dytë, gjegjësisht të amendamentimit, Grupi Parlamentar i

Lidhjes Demokratike të Kosovës mbështet aprovimin në parim të tij, me besimin se ne do të japim kontributin maksimal që të plotësohet dhe të shmangen të gjitha mungesat të cilat në këtë stad të tashëm e përshkojnë si materie. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit zoti Jerliu. Fjalën e ka zonja Teutë Hadri, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Le të përgatitet deputeti Cveta Vujiçiq, në emër të Grupit "Kthimi".

Edhe njëherë porosis deputetët që paraqitjet për diskutim t'ia bëjnë Sekretarisë, kurse Sekretarisë do t'i kërkoja që për mbledhjet tjera të përgatisë formularë të veçantë sikur që jemi marrë vesh për paraqitje për diskutim në të cilin do të shënohej edhe emri dhe cilësia, shikoni ju ato tash çështjet procedurale, në të cilën deputeti paraqitet për diskutim. E keni fjalaën zonja deputete.

TEUTË HADRI:

Të nderuar deputetë, i nderuar zoti kryesues, e nderuara zonja ministre,

Ashtu si e tërë ekonomia e Kosovës, edhe shëndetësia pësoi një shkatërrim të paparë nga e kaluara dhe dhuna serbe. Shëndetësia e Kosovës u plaçkit, u varfërua dhe u shkatërrua nga verbëria primitive serbe. Të gjithë sektorët e shëndetësisë, duke filluar nga sektori primar, sekundar dhe terciar ishin jofunksional për punë dhe të shkatërruar gjer në bazë. Enteve shëndetësore nuk u kishin mbetur asnjë pajisje shëndetësore as produkte medicinale. Kishin mbetur vetëm muret e ndërtesave. Një shkatërrim të tillë nuk kishte patur mundësi t'i shpëtonte as farmacia e Kosovës. Të gjitha farmacitë ishin plaçkitur, djegur dhe shkatërruar. Vetëm të kujtojmë, pas luftës nuk kishte asnjë farmaci private që funksiononte për shitjen e produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale. Të vetmet farmaci ishin mini-farmacitë shtëpiake që mbanin të sëmurit kronik në shtëpitë e tyre në Kosovë.

Kjo gjendje solli farmacinë e Kosovës në një kaos të vërtetë, ku u bë ngadalësimi dhe krijimi i një gjendjeje të pasigurtë shëndetësore, sepse mungonin burimet financiare natyrore. Por, me formimin e Qeverisë së përkohshme të Kosovës dhe formimin e Minsitrisë së Shëndetësisë, u bë riorganizimi dhe rifunksionalizimi elementar i shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve farmaceutike. Ministria e Shëndetësisë në organogramin e saj formoi një nga drejtoratet më kyçe, ku rëndësi të veçantë i dha edhe drejtorisë së farmacive. Kjo drejtori, me ndihmën e bordit të vet të palodhur dhe Shoqatës së

Farmacistëve të Kosovës bëri organizimin, funksionalizimin dhe riaktivizimin e të gjitha farmacive publike dhe atyre private që ekzistonin më parë në Kosovë. Ministria e Shëndetësisë, në mbledhjet e para të saj, pranë misionit vetëadministrues në Kosovë, me përfaqësuesin e saj të parë, zotin Gilbard, e pastaj zëvendësin e tij Hani Vori, bëri presion disaherë në rendin e ditës që administrata e UNMIK-ut të ndihmojë shëndetësinë e Kosovës dhe Ministrinë e Shëndetësisë për aktivizimin e gjiganteve prodhuese medicinale siç ishin në Kosovë, si "Farmedin", "Farmakosin" dhe Qendrën për Prodhimin e Infuzioneve në Fushë-Kosovë. Kërkoj njohjen e statusit të këtyre qendrave prodhuese, të cilat do të luanin një rol të rëndësishëm dhe kyç në mbarëvajtjen e punës së shëndetësisë në Kosovë. U bënë katër vite pas luftës,... nga administrata e UNMIK-ut edhe sot këto qendra nuk u dihet statusi i tyre si veprojne. Kujt i përgjigjen këto qendra dhe kush bën kontrollimin e tyre pasi edhe Ministria e Shëndetësisë nuk ka njohuri. Edhe Komisioni i shëndetësisë pranë Kuvendit të Kosovës, në disa mbledhje të tij që ka mbajtur ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë të informojë për këto qendra dhe të formojë sa më parë ligjin për shëndetësi.

Nevoja për nxjerrjen e këtij ligji për produktet dhe pajisjet medicinale është e një rëndësie të veçantë, sepse Kosovës i mungon një ligj i tillë, e që qytetarët e saj kishin nevojë për një ligj.

(Vërejtje nga kryesuesi: Ju lutem t'i afroheni pak më tepër mikrofonit, sepse ka vërejtje nga teknika lidhur me përkthimin)

...sepse ky ligj do t'i përmbushë dhe plotësojë të gjitha zbrastësit ligjore që ka patur farmacia e Kosovës. Ky ligj siguron bazën themelore për funksionimin dhe sigurimin e kualitetit dhe efikasitetit të produkteve medicinale, të cilat synim kryesor kanë mbrojtjen dhe sigurimin e shëndetit publik të qytetarëve të Kosovës dhe ky ligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat për fabrikimin, importimin, eksportimin, përdorimin dhe kontrollimin e cilësisë së barnave që do t'i përdorin qytetarët tanë.

Prandaj, nxjerrja e këtij ligji është e vetmja alternativë që siguron dhe garanton eliminimin e të gjitha të metave, zbrastësirave që kanë patur qytetarët e Kosovës prej luftës deri më sot. Njëherit ky ligj do të avancojë privatizimin e rrjetit farmaceutik, i cili ka qenë përparësi për qytetarët tanë që në farmacitë private kanë qenë të furnizuara me të gjitha produktet medicinale, duke filluar nga tabletat e thjeshta deri te pajisjet medicinale për ndërhyrje dhe intervenca operative, përçka qytetarët tanë e kanë patur më të lehtësuar të mos dalin jashtë shtetit për një preparat të thjeshtë, apo pajisje të thjeshtë medicinale për intervenca operative.

Prandaj, këto farmaci fatmirësisht i kanë plotësuar kërkesat. Sot në tërë Kosovën janë të njohura 236 farmaci private dhe punën e kanë bërë të palodhur për t'i shërbyer Kosovës gjatë kësaj kohe dhe këtij vakumi.

Dhe si punë prioritare, pas miratimit të këtij ligji, mbetet nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria që t'i marrë të gjitha masat, t'i shfrytëzojë të gjitha fondet e Qeverisë dhe ato donacione të jashtme dhe ta bëjë së pari organizimin e një laboratorit zyrtar medicinal për kontrollimin e kualitetit të produkteve dhe pajisjeve medicinale që sot Kosovës i mungon dhe nën dy: të riaktivizojë të gjitha qendrat prodhuese që ka Kosova për funksionim sa më të mirë të shëndetësisë së Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputeten Hadri. Fjalën e ka deputeti Cveta Vujçiq, në emër të Grupit Parlamentar "Kthimi", le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Përkujtoj se paraqitjet në emër të grupeve mund të zgjasin deri në 10 minuta.

CVETA VUJČIĆ:

Poštovano Predsedništvo, kolegenice i kolege, gospođo ministarka. Meni je zadovoljstvo da pozdravim gospođu ministarku, moju školsku drugaricu i sa posebnim zadovoljstvom ovo mogu da istaknem.

Godinu i po dana funkcionisemo a da za ovom govornicom o zdravlju nije bilo ni reči. Po prvi put nalazi se Nacrt zakona o medicinskim proizvodima i medicinskim napravama. Izgleda prioritet nad prioritetima u zdravstvenom sistemu. Prvi zakon iz kabineta ministra zdravlja. Zdravstvo, kako tako funkcionise, lekari rade, njima ne smeta što se ministri menjaju ili ih nema. Oni imaju svoju etiku koju poštuju ili ne poštuju. Ona je jedno za sve, o bilo kojoj naciji ili nacionalnosti se radilo, gdegod se našli humanost nema granica, ne poznaje nacionalnost. Mnogi, kažem ne poštuju.

Nacrt zakona o medicinskim produktima i medicinskoj opremi, napisanje na 46 stranica, sačinjen od 6 poglavlja i 36 člana, sa dosta grešaka, kako u stručnoj terminologiji tako i jezičkoj. Jezikom koji su se autori koristili nije srpski književni jezik. Rečenice su konfuzne, misao nedovršena, mnogo što-šta nedorečeno. Termini nepoznati. Ovakav prevod direktno udara na ljudska prava, jer ljudska prava govora i pisanja u skladu su i sa ustavnim okvirom koji se, nažalost sve manje poštuje. Zakon je usaglašen sa međunarodnim standardima. Možda je dobar ali posle korekcije možemo govoriti.

Primer da je to tako, poslužiću se i samim ovim zakonom. Na stranici 10. član 3.1.1 pa onda ii) «Kosovsko telo oza procenjivanje konformiteta za medicinske naprave odgovorno za izdavanje deklaracije, konformiteta u slučajevima medicinskih naprava proizvedenih u Kosovo ili validaciju deklaracije konformiteta od strane jednog spoljašnjog tela za procenjivanje konformiteta u slučajima kad jedna medicinska naprava je proizvedena u inostranstvu i je namenjena za uvoz u Kosovo». Molim vas, apsolutno misao i sve ostalo što sam rekla, da ne ponavljam, nerečeno, nedorečeno i konfuzno.

Na pripremi zakona je rađeno dugo vremena. U tekstu na strani 3. postoji jasno koliko. I tom prilikom su navedenom nacrtu zakona mnoge institucije kao što je i ministarka reče i poznati međunarodni domaći pravници izneli svoje pozitivno mišljenje, bez predstavnika srpske nacionalne zajednice, koji, kao i do sada, nisu radili na izradi zakona. Grupa koja je radila, sačinjena je 8. 4. 2003. Mislim svi smo bili tu i mogli smo se i dogovarati. Iako loša..., loša urađena verzija, na srpskom jeziku može se suočiti, kao i do sada, i ovde se protežu elementi državnosti.

Pa predlažemo da se ova verzija na srpskom danas ne prihvati već vrati na doradu i onda tek možemo govoriti o ovakvoj verziji ... i ispravnoj verziji jer zakon o zdravstvu odnosno ovakvoj medicinskoj dokumentaciji ... nama je itekako svima potrebna. Hvala.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit zonja Vujçiq. Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

ZYLFIJE HUNDOZI:

Zotni kryesues, kolegë të nderuar,

Për shkak të mungesës së ligjit në këtë lëmi, ka patur gjer më tani mjaft parregullsi dhe miratimi i këtij ligji ishte i domosdoshëm edhe më parë. Ligji rregullon punën në sektorin farmaceutik në Kosovë, qartë përshkruan dhe precizon veprimtarinë në këtë lëmi nga aspekti ligjor, prej marrjes së licencave për punë me pakicë dhe shumicë të produkteve medicinale e gjer ke mënyra e distribuimit dhe qarkullimit të tyre. Është në harmonizim të plotë me ligjet e shteteve që do të anëtarësohen në Bashkësinë Evropiane në vitin 2004 dhe të atyre shteteve që tani janë në Bashkësi Evropiane. Është kornizë përgatitëse për

nxjerrjen e akteve tjera normative siç është regjistrimi i barnave, gjë që paraqet një ndër çështjet më kryesore në farmacinë e Kosovës, për shkak se gjertani në tregun kosovar kanë ekzistuar barna të llojllojshme, me prejardhje të dyshimtë pasi që nuk e kanë patur përmbajtjen e kontrolluar, kanë paraqitur rrezik potencial për shëndetin e popullatës këtu. Me këtë ligj sigurohet që në tregun kosovar do të gjenden vetëm produkte që do të përmbushin kriteret e standardet për kualitet, siguri dhe efikasitet në veprimin e tyre. Kontrollimi i kualitetit do të sigurohet nëpërmjet laboratorit zyrtar për kontroll të kualitetit të produkteve medicinale e që gjer më tani nuk ka ekzistuar. Këtu i drejtohem drejtoreshës Teuta Hadri, me ligj është i paraparë laboratorit për kontrollimin e barnave. Supozohet një periudhë përgatitore prej dy viteve, kështu që më duket se aty keni keqkuptim. Përcaktohet rregullativa ligjore për pajisje medicinale, ku parashihet përdorimi profesional i tyre, monitorimi i efekteve anësore, kushtet elementare për përdorim. Përpunimi detajor i sektorit farmaceutik, nga aspekti ligjor, në këtë Projektligj bën të vështirë të jipen vërejtje dhe ne shpresojmë se ky ligj do ta gjejë zbatimin e vet në praktikën e përditshme.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, përkrah në parim miratimin e këtij ligji. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputeten Hundozi. Megjithatë, drejtë për replikë është drejtë e pakontestueshme, prandaj urdhëroni....

TEUTË HADRI:

Unë e falënderoj doktoreshën se ka dhënë mendimin e vet, por më vjen mirë se këtu është edhe zonja ministreshë dhe mund të japë edhe kjo ndonjë sqarim - a ekziston ai laborator brenda Qeverisë së Kosovës, apo të Ministrisë së Shëndetësisë apo jo.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit. Edhe një reagim, sipas rregullores, i fundit për replikë.

ZYLFIJE HUNDOZI:

Unë nuk thash se ekziston tani. Ai nuk ka ekzistue, dhe e dijmë çfarë probleme kemi pasë gjatë kohës së helmimeve kur është dashur mostrat e gjakut me i çue

në shtete tjera dhe është dashur me vërtetue se nuk jemi popull histerik por një popull normal. Ai s'ka ekzistuar dhe s'ekziston, por në ligj është i paraparë, që është shumë me rëndësi ajo... Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi dhe le të përgatitet deputeti Hasan Meta.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra,

Më lejoni që fillimisht t'i theksoj tri çështje thelbësore:

E para. Tani një kohë të gjatë, u theksua këtu disa herë se propozimligjet nuk i përmbushin kriteret formalo-juridike, andaj duhet kërkuar nga propozuesit që mundësisht dhe obligativisht t'i eliminojnë këto dobësi, nga se propozimligjet janë të përkthyer dobët dhe përkthyesit nuk e njohin lëndën të cilën e përkthejnë. Ose, Qeveria del me propozime por nuk i harton vetë propozimet. Kjo nënkupton mungesën e sovranitetit juridik të hartimit të ligjeve nga vendorët që është element përmbajtësor i hartimit të një ligj.

E dyta. Binduni se ne me të vërtetë po merremi me çështje kozmetike të propozimligjeve sesa me përmbajtjen e normës juridike ngase në leximet e para kësaj çështjeje nuk i kushtojmë rëndësi dhe jemi të obliguar që ta begatojmë ligjin gjegjësisht propozimligjin gjatë procedurës së miratimit në Kuvend, pa marrë parasysh se çfarë propozimligji vjen, është obligim yni.

Dhe, e treta. Kërkoj nga Sekretaria e Kuvendit, shërbimi konkret, që me rastin e radhitjes së amendamenteve për votim në Kuvend të zbatohet rregulla e prioritetit, se amendamenti i Komisionit funksional është çdoherë përparësor në shqyrtim dhe vënie në votim, nga se do të eliminoheshin shumë paqartësi gjatë procedurës së votimit.

Në tërësi, mendoj se, duke u pajtuar e dhe me Grupin Parlamentar dhe lolësit paraprak, ne duhet ta përkrahim këtë propozimligj sepse Kosovës i duhen ligjet, ndoshta edhe të dobëta nga përmbajtja dhe ana formale.

Megjithatë, në veçanti Kosovës i ka munguar ligji për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale, mungesë e cila në këtë lëmi ka kërkuar parregullsi të shumta, dëshmitarë të së cilës jemi ne dhe në veçanti në importin pa kriterë, pa

cilësi, pa afate të produkteve medicinale në vend që të shërohet popullata jonë, ajo është sëmuar. Ky ligj së paku do t'i rregullojë ose do të pretendojë të rregullojë disiplinën dhe ndërgjegjen e sektorit farmaceutik, e në veçanti në tregun e barnave dhe pajisjeve teknike. Projektligji duhet të përcaktojë qartë kriteret dhe procedurat e komisionit qendror dhe lokal që bëjnë kërkesën dhe pranimin e barnave e të teknikës së mjekësisë, me një metodologji të punës jo të byrokracisë e që eliminon keqpërdorimet duke ndaluar definitivisht dhe përfundimisht që barnat dhe teknika medicinale të përfundojë në ambulancat private, siç është praktikë që të gjithë e dijmë. Barnat në Kosovë porositen, shpërndahen dhe konsumohen në kundërshtim me parimet e etikës mjekësore me konventa ndërkombëtare të shëndetësisë e tjera, duke patur çdoherë parasysht qëllimin profiter dhe shumpak shëndetin e pacientëve.

Në këtë veprimtari, si pasojë e privatizimit, janë kyçur edhe shumë profiterë të kohës, pa përgatitje adekuate profesionale me çka shkaktojnë parregullësi në furnizim të popullsisë. Nocionet – produktet medicinale është aq i gjerë saqë në të mund të përfshihen edhe substanca narkotike e tjera, për të cilat duhet dhënë sqarime. Ligji duhet ta sanksionojë përgjegjësinë e personit juridik dhe atij fizik që merret me prodhimin, importimin dhe eksportimin, si dhe qarkullimin me shumicë e pakicë të barnave, dhe pajisjeve teknike medicinale, kur ato shprehen negativisht në të sëmuarit në Kosovë, që prap është dukuri për të cilën nuk e thamë asnjë fjalë.

Nenet dhe dispozitat janë shumë të gjata. Janë jashtë të gjitha standardeve formalo-juridike dhe si të tilla vështirë do të aplikohen, por lënë mundësi për interpretime subjektive të cilat në të vërtetë në praktikë nuk do të aplikohen, ngase ndihet papërgjegjësi rreth nocionit të certifikimit të barnave. Për shembull, a do të certifikohet një bari për treg, për shërbim të pacientit, për analizë serike, për import, për biznese, për hulumtime klinike, galenike dhe për qëllime të tjera. Kompetencat për zbatimin e këtij ligji nuk janë sqaruar në mes Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale, Shërbimit Veterinar, organit këshilldhënës, Shërbimit për përkrahje teknike si dhe barnatoreve të cilat duhet të rregullohen sipas nenit 3 dhe alineve që pasojnë, në nenin 4 pika d) dhe i).

(Vërejtje nga kryesuesi lidhur me zgajtjen e diskutimit)

... Se sa ky ligj, vetëm edhe një minut, nuk është në pajtueshmëri me normën dhe rregullën juridike do ta lexoj nenin 36, 37 dhe 38. Dëgjoni, ju lutem. Ky ligj është... gjuha mbizotëruese. Çka nënkupton? Ky ligj është prezentuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Versioni zyrtar i këtij ligji është në gjuhën shqipe. Në rast të ngritjes së ndonjë konflikti nga ky apo në lidhje me këtë ligj, që dyshon domethënien, interpretimi apo konstruktimi i cilësdo çështje, merret versioni në gjuhën angleze. Është i padrejt dhe si i tillë nuk mund të qëndrojë.

Dhe, në fund, ky ligj tejkalon të gjitha dispozitat e ligjit të aplikueshëm që prap nuk është në harmoni me atë që kemi thënë dhe ky ligj, mendoj duhet të përkrahet por duhet të përmirësohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputetin Kelmendi. Fjalën e ka deputeti Hasan Meta dhe një njoftim, besoj për shumkë i mirë, është ky diskutanti i fundit i paraqitur për këtë shqyrtim.

(Diskutimi i dorëzuar me shkrim, i përshkruar nga origjinali i z. F. Këpuska)

FETIJE KËPUSKA:

Padyshim se nga dita në ditë bëjmë hapa shumë të rëndësishëm në rregullimin ligjor të shumë lëmive më interes për popullatën e Kosovës. Në këtë drejtim është me interes të veçantë edhe vendimi për shtruarje në rënd dite të seancës së Kuvendit edhe e Ligjit për Prodhime Medicinale dhe për Paisjet Medicinale.

Me miratimin e ligjit të propozuar do të përmbushet zbrazëtira ligjore në këtë veprimtari. Miratimin e tij e bën jo vetëm të domosdoshëm, por shumë të ngutshëm vet mungesa e rregullativës gjegjëse. Një gjendje e tillë, pa rregullativë ligjore paraqet rrezik potencial dhe të përhershëm për shëndetin publik të popullatës së Kosovës, dhe rrjedhimisht në tërë rajonin. Miratimi i ligjit do t'i sanksiononte marrëdhëniet e gjithmbarshme në këtë veprimtari, do t'i përcaktonte saktësisht subjektet, raportet e tyre dhe detyrimet e përgjegjësitë që kanë të bëjnë me çështjet e prodhimeve dhe të paisjeve medicinale. Siç është thënë edhe në propozimin e prezantuar për këtë seancë, miratimi i këtij ligji është i domosdoshëm, pasi që të gjitha çështjet nga kjo veprimtari duhet ngërthyer brendapërbrenda përcaktimeve ligjore. Kështu do të mbylleshin hapësirat dhe zbrazëtitë të cilat pastaj mund të shërbejnë dhe shërbejnë herë pas here si bazë për punë e veprime të paligjshme, për shpërdorime, trafikim mallërash, mosverifikim cilësie, skadim afatesh të këtyre prodhimeve etj. Transformimet dhe ndryshimet që synohen të bëhen me miratimin e këtij ligji duhet të jenë në pajtim me rrjedhat bashkëkohëse në këto veprimtari, natyrisht gjithnjë në interes të kërkesave të vet qytetarëve të Kosovës – pra të atyre të cilëve u referohet ky ligj i cili duhet të ketë qëllim mbrojtjen e shëndetit publik të popullatës.

Në radhë të parë ligji duhet të përcaktojë qartazi kriteret e kushtet për prodhim dhe plasimin e tyre në treg, duke siguruar gjithnjë tek të gjitha produktet me cilësi sipas standardeve bashkëkohëse, efikasitet të tyre dhe siguri për

popullatën, konkretisht për personat që u dedikohen. Konsideroj se ligji i propozuar është gjithpërfshirës, pasis që i ka përcaktuar saktësisht subjektet dhe obligimet e raportet e tyre që nga autoritetet publike e private, personat juridik dhe personat fizik që merren me import-eksport, me qarkullim me shumicë e me pakicë, si dhe ka përfshirë edhe aktivitetet dhe subjektet tjera që ndërlidhen me këto veprimtari.

Pasiqë është ky debat parimor, do të ndalem e të përqëndrohem vetëm në disa aspekte të ligjit të propozuar. Mendoj se duhet ashpërsuar dhe si të tilla pastaj edhe respektuar rigorozisht kriteret për lëshimin e autorizimeve për prodhimin e produkteve medicinale, por njësoj edhe me rastin e importimit të tyre – duke përmbushur kriteret e standardet bashkëkohëse ndërkombëtare. Kjo me rastin e prodhimit nënkupton angazhim të punëtorëve të kualifikuar, paisje adekuate dhe prodhime në pajtim me kushtet e licencës, siguri, kontroll e inspektim të vazhdueshëm të prodhimeve, duke siguruar cilësi të lartë, siguri dhe efikasitet të prodhimeve.

Është me një interes jetik të parashifen dhe përcaktohen saktësisht procedurat, rregullat dhe detyrimet e subjekteve në lëmin e importit dhe të eksportit të këtyre prodhimeve. Por, unë dëshiroj të përqëndrohem tek importi, tek tregëtimi me shumicë e pakicë i këtyre prodhimeve. Janë paraparë procedurat që nga licenca, autorizimi i marketingut, certifikatat, mbajtja e të dhënave të detajuara e të specifikuar, burimet, destinimet, si dhe të dhënat për sasinë, datat, afatet, inspektimet, kontrolli etj. Tërë këto procedura dhe e tërë kjo rregullativë duhet të sigurojë cilësi të lartë të prodhimeve medicinale, që nënkupton kontrollim të përhershëm të cilësisë. Në këtë aspekt AKPM përmes Laboratorit Zyrtar për Kontrollin e Kualitetit të Prodhimeve Medicinale duhet vazhdimisht të bëjë verifikime të përhershme të dokumentacionit, inspektim si dhe të vet prodhimeve, të cilësisë dhe afateve. Duhet parandaluar në mënyrë efikase përpjekjet e rastet e kontrabandimit të këtyre prodhimeve, si dhe sanksionimin dhe ndëshkimin e ashpër të personave që bëjnë veprime të tilla. Futja e këtyre prodhimeve, me prejardhje dhe më cilësi shumë të dyshimtë, përmes kanaleve të ndryshme në formë kontrabandimi, së paku sjellë dëm të dyfishtë – dukshëm e dëmton buxhetin modest të Kosovës dhe dukshëm rrezikon shëndetin publik të popullatës.

HASAN META:

E nderuara Kryesi, e nderuara zonja ministër, të nderuar deputetë. Me rregulla të gjuhës shqipe, mund të thuhet kësisoj!

Është e tepërt të folet për domosdoshmërinë e një ligji të tillë, që i ka munguar Kosovës. Është e tepër të folet, që e dijmë të gjithë për laramaninë e

gjithmbarshme që zotëron këtu në tregun kosovar të produkteve medicinale, të tjera, e të tjera. Por unë këtu dua të shpreh një mendim të Shoqatës Farmaceutike të Kosovës, anëtar i së cilës jam edhe unë. Ky ligj është tërhequr një herë nga procedura dhe është pakashum ajo që pengon që ligji bazik nuk ka dalur ende, ligji për shëndetësi në përgjithësi dhe kjo duhet të jetë atje diku dhe dua t'i lexoj që të mos ju marr kohë shumë.

Propozohet ky ligj të kthehet në rishqyrtim në Ministrinë e Shëndetësisë për këto arsye: Me aprovimin e këtij Projektligji, prejudikohet ligji bazik, ligji për shëndetësinë e Kosovës që pritet të aprovohet më vonë. Dispozitat e Projektligjit për produktet dhe pajisje, në disa raste, janë në kundërshtim me projektligjin për shëndetësi, insitutin e kualitetit të barnave, licencimin e farmacistëve dhe barnatoreve, e të tjera. Ligji për shëndetësi duhet të jetë ligji i parë i aprovuar dhe nga ky ligj do të derivohen të gjitha ligjet dhe aktet tjera nënligjore që trajtojnë materien e rregullimit ligjor të shëndetësisë. Disa dispozita të Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale, çështja e licencimit, institucioneve shëndetësore rregullohen me ligjin për shëndetësi dhe aktet tjera dhe nënligjore të nxjerra nga ky ligji. Materia që duhet të trajtohet në këtë ligj duhet të përfshijë vetëm produktet dhe pajisjet medicinale dhe nuk duhet të përfshijë çështjet e licencimit të farmacistëve dhe barnatoreve, shih neni 101 të Projektligjit për shëndetësi.

Dhe, do të lutsha komisionet adekuate që t'i marrin parasysh, që kanë arritur me kohë, të gjitha këto vërejtje, komente, amendamente të cilat i ka dhënë Shoqata Farmaceutike e Kosovës dhe t'i kenë parasysh. Kemi dy mundësi, ta refuzojmë këtë ligj apo, me përmirësime, ta begatojmë dhe të shkojë. Unë jam për atë që të merren parasysh të gjitha komentet këtu prej njerëzve që merren me këto punë dhe të begatohet ky ligj dhe të aprovohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputetin Meta. Me kaq përfundon shqyrtimi në parim i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale.

Lus deputetët që të deklarohen lidhur me aprovimin e Projektligjit i propozuar dhe shqyrtuar në parim.

Kush është për? Le të numërohen votat. Shumica është për.

Kush është kundër? 8 vota kundër.

A abstenon ndokush? Nuk ka abstenime.

Konstatohet se Kuvendi i Kosovës, me shumicë dërmuese të votave, aprovoi Projektligjin për produktet dhe pajisjet medicinale, në parim.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority...
- Kundër – Protiv – Against.....08.....
- Abstenime – Uzdrzanih – Abstained.....00.....

Të falemnderit për vërejtjen. Është fjala për aprovim në parim. Kurse sa për njoftim, për shqyrtimin e mëtejshëm, janë të obliguara Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, Komisioni për shëndetësi, si komision funksional dhe i pari më i rëndësishmi për këtë ligj, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për komunitete që këtu nuk qenka i shënuar. Ne porosisim që shqyrtimi të bëhet në afatin e caktuar sepse nganjëherë shqyrtimi në komisione po vonon pastaj në shqyrtimin e mëtejshëm.

Nëse jeni dakord, meqë ky ligj shkoi shpejt dhe s' shohim të arsyeshme të bëjmë ndonjë pauzë, vazhdojmë me shqyrtimin e Projektligjit të dytë, po ashtu i sponsorizuar nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria për Shëndetësi.

Është fjala për shqyrtimin e parë, në parim të Projektligjit për inspektoratin sanitar.

Teksti i Projektligjit është shpërndarë me kohë deputetëve. Nëse keni ndonjë vërejtje urdhëroni.

Fjalën e ka minsitresha e shëndetësisë zonja Mumxhiu. E keni fjalën, urdhoni.

RESMIJE MUMXHIU:

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë dhe kolegë,

Kam nderin që para jush t'ju prezentoj edhe ligjin për inspektoratin sanitar të Kosovës. Inspektorati sanitar i Kosovës vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe është organ ekzekutiv i specializuar për kontrollin e kualitetit të ushqimit, pastaj zbatimin e masave për pengim dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitëse si dhe kontrollimin e kushteve higjieno-sanitare të objekteve, industrialo-ushqimore, tregtaro-ushqimore, shëndetësore, hoteliere, kulturore, edukativo-arsimore, sportive, të objekteve të mbajtjes së higjienës personale, e

Itjera, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të popullsisë. Ushqimi jokualitativ ose i pakontrolluar është një prej shkaqeve kryesore të sëmundjeve në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, por më tepër zhvillimi ekonomik dhe globalizmi i tregut botëror si dhe ndryshimet në mënyrën e të ushqyerit me konsum më të madh të produkteve të industrializuara, pastaj rritja e konsumit të ushqimit jasht shtëpisë, si dhe futja e masave bazë të higjienës kanë ndryshuar profilin epidemiologjik të sëmundjeve me prejardhje ushqimore, duke ekspozuar konsumatorë me lloj të ndryshme kontaminuese.

Duke patur parasysh periudhën katërvjeçare të pasluftës, mbrojtja e shëndetit të popullatës nuk ka qenë në nivel të duhur për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore të organizimit të inspektoratit sanitar, prandaj ka qenë mëse e domosdoshme të propozohet ky ligj.

Pas shumë konsultimeve me ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar të kësaj fushe si dhe trajnimet jasht vendit për përgatitjen e këtij propozimligji dhe duke u bazuar në modelet e vendeve tjera me popullsi të vogël dhe sipërfaqe të përafërme me vendin tonë, arritëm ta krijojmë një Projektligj me standarde ndërkombëtare i cili gjendet para jush, për të cilin mendoj se kemi pasë nevojë qysh më herët.

Tani kemi institucionet e Kosovës që deri më tash kanë funksionuar me rregullore të ndryshme, që në bazë të mendimit tim, nuk kanë qenë aq funksionale dhe është parë nevoja urgjente e propozimit të ligjit që normalisht me të punët do të ecin shumë më mirë dhe Kosova do të ketë një popullatë të shëndoshë.

Me këtë Projektligj do të kemi kontroll shumë më efikas të ushqimit, higjienës që do të ndikojë drejtpërdrejt në shëndetin e gjithë popullatës.

Për përmirësimin e këtyre kushteve, është e domosdoshme implementimi i sistemit të ri të kontrollit të ushqimit "Hasap" çka don me thënë analiza e rrizikut të pikës kritike të kontrollit të ushqimit, ky sistem i ri i kontrollit të ushqimit që është implementuar në shtetet evropiane me standarde të larta. "Hasap" është një sistem shkencor, racional dhe sistematik që realizon identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve gjatë prodhimit, përpunimit, fabrikimit, përgatitjes dhe garantimin e ushqimit për konsumatorë.

Me aprovimin e këtij Projektligji do të rritet efikasiteti i punës së inspektoratit sanitar dhe njëherit do të krijohen kushtet për ngritjen ekonomike të vendeve që është synim i secilit prej nesh.

Pra, të nderuar deputetë, në fund po ju përsëndes dhe po ju falënderoj për durim dhe mirëkuptim.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Të falemnderit zonja ministre.

Hapim debatin për Projektligjin e paraqitur. Procedura është e njëjtë. Lusim përfaqësuesit e komisioneve, së pari a të funksional, zonja Nafije Gash, pastaj komisionet tjera të interesuara, grupet parlamentare - natyrisht nëse janë të interesuar dhe deputetët.

NAFIJE GASH:

Ju falemnderit. Unë prap si kryetare e Komisionit parlamentar për shëndetësi jam që Projektligji për inspektoriatin sanitar të Kosovës të miratohet nga ky Kuvend në shqyrtimin e parë. Në punën në komisione kërkoj që të eliminohen disa mangësi në rregullimin e kësaj lëmie shumë të rëndësishme për shëndetin publik në Kosovë.

Mesa vërejta, në këtë Projektligj, nuk figuron emërtimi "Dispozitat e përgjithshme" që do të ishin të obligueshme në përmbushjen formale, por edhe përmbajtësore të ligjit.

Në strukturën e inspektorëve, me këtë Projektligj parashihen inspektorët rajonal, gjë që duhet të ndryshohet e organizimi të jetë në nivel komunal, ashtu si është edhe me Komizën kushtetuese.

Struktura organizative e inspektoratit sanitar, në Projektligj është përcaktuar të bëhet me akt të veçant nënligjor të cilin e nxjerr Ministria e Shëndetësisë, mirëpo natyra e bërjes së ligjeve, rregullimi e normimi i lëmisë së caktuar na thotë se kjo duhet të rregullohet me këtë ligj.

Prandaj, angazhohem që përmirësimet në këtë Projektligj të bëhen deri në shqyrtimin e dytë në komisione. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Të falemnderit zonja Gash. Kemi një listë të paraqitur, por pa e sqaruar nëse jo në emër të komisionit ose të grupit parlamentar. Ju lutem që të sqarohet kjo merastin e paraqitjes. Po synoj që në emër të komisioneve tjera, nuk ka marrë parasysh listën. Është paraqitur Blerim Baruti, por synoj në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ashtu apo jo?

(Përëgjigja, prej së largu: – Jo)

Atëherë, a ka të paraqitur në emër të komisioneve, së pari? Nëse ka, atëherë po e ndryshojmë rendin. Tomë Hajdaraj, në emër të ...

TOMË HAJDARAJ:

Zoti kryesues, deputetë të nderuar,

Ne sot miratuam në parim Ligjin për produktet dhe pajisjet medicinale dhe kemi në diskutim ligjin, gjegjësisht Projektligjin për inspektoratin sanitar. Ndërsa, unë mendoj se për të përdorë sa më shumë... sa më pak produkte medicinale, është me rëndësi të përdorim sa më shumë produkte të shëndetshme ushqimore. Andaj, meqenëse kemi edhe ministren këtu, më vjen keq që nuk është ministri për bujqësi, të cilit i kemi bërë ftesë me datën 1. 9. domethënë në mbledhjen e Komisionit parlamentar për bujqësi dhe i njëjti nuk është këtu, për arsye të tij, shfrytëzoj rastin që para jush të kërkoj në emër të Komisionit, por mendoj edhe në emrin tuaj po që se ia doni të mirën familjes tuaj, që sa më parë të formohet agjencioni i kontrollit të kaulitetit të ushqimit. Këtu u fol për shëndetin, faktikisht për shëndetin ... Ju lutem! Por unë mendoj që është kërkesë unanime e Komisionit dhe e ministrisë për bujqësi, gjegjësisht të sekretarit përmanent që me këtë agjencion të udhëheqë Ministria e Bujqësisë. Kur them këtë, kam parasysh faktin se qënga farma gjegjësisht ara deri në tryezën e bukës kujdesin më të rëndësishëm e kanë profesionistët e lëmisë së bujqësisë, duke u nisur prej veterinerëve, teknologëve të ushqimit, e fitosanitarëve dhe agronomëve. Njëherit, bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë është i pakontestueshëm, por dihet që për kualitetin kush kujdeset, ndërsa për shëndetin dihet se kush kujdeset.

Është kërkesa urgjente, për arsye se Bashkësia Evropiane ka ndarë një fond të konsiderueshëm për formimin e agjencionit për kualitetin e ushqimit. Andaj, nëse ne deri në vit të ri, më së largu po them, nuk formojmë agjencionin, atëherë do të humbim edhe mjetet financiare të dedikuara për këtë qëllim, njëherit do të humbim edhe para popullatës gjegjësisht kur kemi parasysh faktin se këto ditë njerëzit e autorizuar dhe të paautorizuar po japin prononcime të ndryshme në mjete të informimit, duke u nisur prej organizatave të cilat më parë janë marrë dikur "jugoinspektit" për të mos thënë edhe e kanë quajtur veten "kosovakontroll" pas lufte, pastaj kemi prononcime tjera, por kisha dëshiruar që të vëhet pikë njëherë këtij problemi dhe të mirren vesh Ministria për Bujqësi, si bartëse e punëve në përgjithësi gjegjësisht Ministria për Shëndetësi si finalizuese për shëndetin e ushqimit. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Të falemnderit zoti deputet. Është paraqitur për diskutim, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës deputeti Naim Jerliu.

NAIM JERLIU:

I n deruar kryesues, të n deruar ministra, të n deruar kolegë deputetë, po dëgjoj dikend që po thet shkurt dhe vërtet do të bëj përpjekje të jam i shkurtër.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar dhe diskutuar Projektligjin për inspeksionin sanitar dhe e mbështet aprovimin në parim në leximin e parë duke konsideruar se ky është një legjislacion që mbulon një fushë të rëndësishë së veçantë dhe ka qëlluar që sot për herë të parë po diskutojmë dy projektligje në lëmin e shëndetësisë, të sponsoruar nga Ministria e Shëndetësisë, mbase tejet vonë, por është shummirë që, më në fund, edhe kjo fushë po bëhet me legjislacionin përkatës të aprovuar nga ky Parlament.

Ne mbështesim aprovimin apo miratimin në parim të këtij Projektligji, normalisht duke patur vërejtjet tona, edhe parimore, edhe vërejtjet tjera që sigurisht do t'i procedojmë mëtej në diskutimin e mëtejme të Projektligjit.

Unë vetëm do të theksoj njërën nga vërejtjet kryesore parimore: Ky Projektligj është i ndarë në tri segmente, komponentën e organiazimit, kompetencat e inspektoriatit sanitar dhe kundërvajtjet sanitare. E kam fjalën për aspekte të orga nizimit të inspektoratit sanitar dhe krijimin e një strukture që është quajtur në Projektligj inspektorati regjional e cila strukturë në princip bie ndesh me strukturimin e qeverisjes në Kosovë, për arsye se ne kemi nivelin e qeverisjes qendrore dhe atë lokale, gjegjësisht qeverinë... nivelin qendror dhe atë nivelin komunal, ndërkaq, administrativisht nuk ka një strukturë të mesme në Kosovë.

Prandaj, duke besuar se në procedurën e mëtejme do ta amendamentojmë, përmirësojmë dhe pasurojmë e begatojmë këtë Projektligj, mbështesim procedimin e tij në parim. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Të falemnderit zoti Jerliu. Në radhë është deputeti Sejdullah Hoxha, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës.

Dëshiroj të jap një sqarim. Në emër të koalicionit "Povratak" është Svetomir Samarxhiq, apo si deputet... Në dakord.

SEJDULLAH HOXHA:

I nderuari kryesues, të nderuar kolegë, e nderuara zonjë ministreshë,

Edhe pse edhe Ligji paraprak që u aprovua, përafërisht janë komplementarë dhe e plotësojnë njëri-tjetrin, mua ma merr mendja se këto ligje ndoshta është dashur shumë më herët të aprovohen, mirëpo më mirë dikur se kurrë. Sido që të jetë edhe Grupi Parlamentar i PDK ka shqyrtuar këtë ligj dhe mendon që ligji në parim duhet të pranohet, madje unë do të jipja edhe komplimente, - se në krahasim me shumë kritika që u drejtuan për ligjet, në aspektin e gabimeve gjuhësore, ky ligj, edhe teknikisht edhe gjuhësisht më duket më i pranushëm se shumë ligje tjera, ndoshta që kanë kaluar nëpër këtë Parlament dhe për këtë – Grupit punues, i cili ka qenë mjaft korrekt, natyrisht ka edhe shumë gjëra të cilat duhet të diskutohen në komisione. Ma merr mendja se komisioni me angazhimin e vet do t'i pranojë të gjitha vërejtjet, të cilat do të vijnë nga anëtarët dhe nga njerëzit tjerë të cilët janë të interesuar në këtë situatë kur përveç kaosit farmaceutik, siç e dëgjuat që ekziston në tregun kosovar, edhe komisionet, edhe inspektorati nuk ka funksionuar si duhet. Ma merr mendja se me këtë Projektligj janë përfshirë shumë gjëra dhe në mënyrë komplementare do të plotësohen gjatë punës së komisioneve.

Grupi Parlamentar i PDK, në parim përkrah këtë ligj. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit zoti Hoxha. Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, le të përgatitet deputeti Svetomir Samarxhiq.

ZYLFIJE HUNDOZI:

Zotni kryesues, kolegë të nderuar. Unë do të mundohem të jam sa më e shkurtër. Kolegët e mij i thanë shumicën e së vërtetës që sot ekziston. Mirëpo, aprovimi sa më shpejt i këtij ligji dhe zbatimi në praktikë është mëse i domosdoshëm. Me aplikimin e mirëfillt të tij, shpresoj se do të evitohen parregullsitë sanitare që kanë ekzistuar gjatë më tani në Kosovë, e ato kanë qenë të shumta: shitja e ushqimit nëpër rrugë; nuk është ditur përmbajtja dhe prejardhja e tij dhe shumë parregullsi të tjera që kanë bërë që numri i të sëmurave me sëmundje ngjitëse në Kosovë të jetë në rritje e sipër.

Në lagjën Velania të Prishtinës, ku ndodhet Prezidenca e Kosovës, në të cilën ndodhet Çerdhja e fëmijëve, shtëpia e kryetarit të Parlamentit – që katër vite janë hedhur me tona mbeturina, të cilat edhe më tutje janë aty. Për çdo ditë aty kalojnë shumë delegacione të huaja, që shpesh vizitojnë Prezidencën. E tërë kjo ka qenë një mesazh me shumkuptime për këto delegacione të huaja.

Ligji është i qartë dhe në hollësi përshkruan veprimet e inspektoratit sanitar dhe shpresojmë se tani po përmbushen edhe ato zbrahtësi ligjore, që po cekën se kanë ekzistuar e që nuk kanë lejuar organet përkatëse që të veprojnë.

Unë po mbaj premtimin se do të jemi të shkurtër. Për mangësi të këtij ligji, kontributin tonë do ta japim në komisionin përkatës ndërsa Grupi ynë Parlamentar i Aleancës për Ardhmerinë e Kosovës përkrah këtë ligj në parim. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit, zonja deputete. Fjalën e ka deputeti Samarxhiq dhe le të përgatitet Blerim Baruti.

SVETOMIR SAMARDŽIĆ:

Gospodine predsedavajući, gospođe ministre, dame i gospodo poslanici,

Igrom slučaja ja sam dugo u ovoj materiji, radiću dugo na preventivnoj zaštiti na Kosovo i metohiji i radeći u saveznoj sanitarnoj inspekciji i u principu opšte je moje mišljenje da jedan ovakav zakon treba doneti. Da li ovakav zakon ili nešto drugo što ću kasnije kazati, je veliko pitanje – organizaciono.

U svakom slučaju, radi se o tome da je to jedno veoma – veoma osetljivo pitanje i da se ne sme doneti na brzinu. Osim toga, da ponovim ono što su ranije govornici kazali da je on izmasakriran jezički što zbilja unosi neke nejasnoće. To ćemo ispraviti, to nije problem, nadam se. Međutim, radi se o principijelnom pristupu da li takav zakon treba da bude donesen u ovom obliku, odnosno da li će se Kosovo i metohija odlučiti da ima zakon o sanitarnoj inspekciji ili zakon o inspektoratu. Neko je kazao da je ovo kompatibilan sa zakonima Evropske Unije! Mislim, prema informacijama koje imam, da nije. Apsolutno da nije. Jer, Evropska Unija traži efikasnu i efektanu kontrolu, posebno mislim na granici. Znači, ideja je da se inspektorat, u kome će biti sanitarna inspekcija, veterinarska, fituinspekcija i po nekim, da ali tržišni ili ne, to su sada druga pitanja. Znači, ako mi rešimo da imamo sanitarnu inspekciju, kao zasebnu, onda

takav zakon može da ide. Ne u ovakvom obliku, jer recimo apsurd je da zakon o sanitarnoj inspekciji donosi ministarstvo zdravlja a da se u kadrovima lekari stavljaju na osmo mesto po prioritetima. Ne mogu biti tehnolozi, ne mogu biti veterinari, poljoprivredni stručnjaci i tako dalje prioritetni u radu ministarstva zdravlja. Jedan primer. Takvih primera ima puno.

Drugi je primer, ko će vršiti analizu o materijalima koji se kontorlišu i hrani koja se kontroliše. U jednoj susednoj zemlji, koja je u tranziciji takođe i koja ima veliku ekspanziju u gradnji, desilo se da, ovaj... da su kupili gvožđe na tržištu i da su to kupili gvožđe iz Ukrajine. Danas imaju veliki problem jer imaju ... uzračnost. Druga naša zemlja, u vreme kada smo imali Černobilj. Je napisala velikim slovima – u toj zemlji nema uzračnosti, a onda malim slovima – ta zemlja nema instrumente za merenje toga. Pitanje je: da li smo mi spremni za sve ovo odnosno moramo biti spremni ali ko će vršiti analize, pod kojim uslovima, nigde ne piše ko će dati sertifikate ustanovama koji će to vršiti, slažete se, koji stručni profili će to raditi, da li će biti verifikovano od strane međunarodne organizacije, i tako dalje. Jer na granicama Evropska Unija traži, kazao sam, efektivnost i efikasnost. Oni mere vreme ulaska robe na svaku teritoriju. Neposredno posle rata, kada sam ja otišao da živim u Beogradu, prvi kontakt sa Albancima koji su živeli u kraju, gde sam ja inače iz Peći, mene su zvali odmah Albanci vlasnici trgovinskih radnji! Radi se o tome da je roba morala da prođe kroz teritorije Srbije i kako ćemo to da rešimo, po kojim propisima.

Znači, zaboravimo politiku, zaboravimo rat, zaboravimo sve!? Ovo supitanja od izuzetnog životnog značaja, hrana je u pitanju, ozračnost je u pitanju, laboratorije su u pitanju i mora se zakon doneti na jedan izuzetno osetljivi način. Mislim da, nemojte da se uvredite za predlagače zakona, da se mora vratiti, ne samo na doradu jezičku nego na konceptijsku doradu. Da li inspektorat, da se vrati na ono osnovno, da li inspektorat raditi ili usavršavati ovaj zakon.

Neko je govorio: nemamo zakone. Pazite, neko je stidljivo, ovde kazao, da su to zakoni broj 21/82, 27... i takok dalje. Inspekciji se ovoga puta daje nadzor nad zaraznim bolestima. Kosovo i metohija je teritorija sa najrizičnom ekološkom situacijom u Evropi. Dati drugim profilima, kontrolu zaraznih bolesti, je užasan rizik. I znate, ja imam podatak da, radeći na području Drenice, neću da kažem na mojim rukama ali često se do dešavalo, je umrla 51 osoba od gripske hemaragijske groznice, jedinstvene bolesti u Evropi! Ne možemo takvim ljudima, bez takvih kontrola dati....., bez takvih kvallifikacija, dati mogućnost kontrolisanja takve bolesti. Zakon o sanitarnoj inspekciji je produžena ruka zakonu o zdravstvenoj zaštiti.... Mnogim drugim ustanovama, i da ne kažem, od osnovnog pitanja, što zakon nije regulisao ono što je za nas na Kosovu jako interesantno, a na kom jeziku će građani dobiti rešenje, a da li će imati pravo žalbe, i tako dalje.

Predlažem da se zakon ili uredi detaljno, ili da iz njega izađu pravilnici jer jvidim ideju da je tako nešto urađeno tako, i tako, u suštini da ga treba vratiti na suštinsko, konceptijsko razmatranje pa tek onda ga doneti jer su izuzetno osteljivo pitanje. Hvala vam.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputetin. Fjalën e ka deputeti Blerim Baruti, le të përgatitet zonja Remzije Nimani.

BLERIM BARUTI:

E nderuara Kryesi e punës, i nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra të pranishëm,

Më lejoni që të paraqes pikëpamjet e mia në shqyrtimin e parë të Projektligjit për inspektoratin sanitar të Kosovës. Në vazhdën e begatimit të ligjvënies në Kosovë hyn edhe ky ligj me rëndësi të veçantë për Kosovën, sepse me anën e këtij ligji do të fillojë një ndryshim cilësor i jetës së popullatës në Kosovë; do të kemi ushqim më kualitativ; kontroll të rregulltë në këtë fushë; ajr më të pasur; tokës më pak do t'i humbet kualiteti. Me një fjalë do t'i afrohem më afër familjeve evropiane ngase deri më tani nuk kemi patur të rregulluar këtë lëmi me kornizë ligjore.

Më gëzon fakti se ligji është përpiluar në mbështetje të ligjeve të ndryshme të shteteve evropiane, por edhe i përshtatur me specifikat vendore. Në kuadër të ligjit, edhe në Kosovë do të përdoret sistemi i ri i kontrollit të ushqimit, analiza e rrezikut të pikës kritike të kontrollit të ushqimit apo e njohur me shkurtesën JSSP ("Ej-si-si-pi").

Organizimi sanitar do të jetë i shtrirë në katër nivele, por njërën do ta përmendja tani, inspektoratin sanitar të kufirit. Deri më tani importi ishte i pakontrolluar; dyshimi ishte evident në mallrat e sjellura në treg; flitej për vezët e dyshimta të importuara; mishi i dyshimt, ndoshta edhe nga lopët e çfrenuara; kripa pa përbërje të jodit; mielli pa përbërje të komponenteve të domosdoshme ushqyese; duhani pa asnjë gjurmë identifikimi se është i kontrolluar; benzini me ujë; hekuri si material ndërtimor i rrezatuar i importuar nga Ukrajina; ushqimi; pijet dhe medikamentet shëruese me afat të skaduar me prejardhje mjaft të dyshuar, e çka jo tjetër. Në këto mallra të dyshimta, bota është shumë e ndieshme sepse ndikojnë në rrezikimin e shëndetit të popullatës. Gjatë kësaj periudhe kemi patur një erodim të kualitetit të jetës në përgjithësi.

Prandaj, fare përfund, megjithë mangësitë që janë evidente në ligj, konsideroj se ky ligj do të begohet e plotësohet me sygjerime e propozime përmbajtësore deri në leximin e dytë gjegjësisht amendamentimin e tij, ashtu që të marrë formën finale. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputetin Baruti. Fjalën e ka deputetja Remzije Nimani, le të përgatitet, i fundit, për këtë debat Fadil Kryeziu.

REMZIJE NIMANI:

Zotri kryesues, zonja dhe zotërinj deputetë, ministra të nderuar,

Projektligjin për inspektoratin sanitar, vlerësoj se duhet ta përkrahim sepse dihet rëndësia dhe roli i tij, ngase mbrojtja sanitare duhet të ketë një prioritet dhe në veçanti aplikimin e standardeve ndërkombëtare në lëminë e inspektoratit sanitar.

Është mëse e domosdoshme që të gjitha çështjet nga kjo lëmi të përcaktohen me ligj. Ky Projektligj nuk jep zgjidhje për të gjitha çështjet e standardeve sanitare, duke mos i përcaktuar në mënyrë të plotë kompetencat e inspeksionit sanitar komunal.

Vlerësoj se Projektligji në fjalë është dashur që më tepër t'u kushtojë kujdes këtyre çështjeve: mbikëqyrjes së artikujve ushqimorë dhe sendeve të përdorimit të përgjithshëm; kushteve të prodhimit dhe të qarkullimit të mallrave; cilësisë, kualitetit dhe afatit të prodhimeve ushqimore; sigurimit të ujit të pijshëm që të jetë në gjendje të rregullt higjienike.

Në këtë Projektligj është dashur t'u kushtohet një kujdes më i madh sëmundjeve ngjitëse, që vetëm përmenden sipërfaqësisht. Pastaj, zbatimi i masave të posaçme për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse. Të aplikohen masat ndëshkimore për shkelësit e dispozitave ligjore.

Me këtë Projektligj është dashur të përcaktohet edhe kryeinspektori sanitar komunal apo rajonal që është përmendur në ligj dhe kriteret profesionale se kush mund ta ushtrojë këtë funksion.

Gjithashtu, për të gjithë bartësit e sëmundjeve ngjitëse dhe përhapësit e tyre, përveç gjobave të parapara, duhet përcaktuar edhe izolimi apo karantina.

Mendoj se përveç inspeksionit sanitar të Kosovës, ... mandej në ligj është përmendur edhe ai rajonal që s'duhet të ekzistojë dhe atij kufitar duhet të ekzistojë edhe inspektori sanitar komunal. Për çudi ky inspektor është eliminuar që dihet se është bazë e çdogjëje.

Megjithkëto vërejtje dhe sygjerime, unë propozoj që ta përkrahim Projektligjin në parim por është e nevojshme që me amendamente të reja ta plotësojmë nëse dojmë të kemi një ligj të mirë dhe të aplikueshëm. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputeten. Fjalën e ka, po e përsëris, i fundit për këtë debat – Fadil Kryeziu. Sipas rregullores polemika ose replika mund të jetë vetëm nëse është përmendur emri... Është shqyrtimi i dytë në të cilin... Megjithatë s'mund të lejojmë... Është shqyrtimi i dytë në të cilin mund të vazhdohet edhe debati edhe polemika.

FADIL KRYEZIU:

Zoti kryesues, e nderuara zonja ministreshë, të nderuar kolegë deputetë,

Në botën moderne, në praktikat moderne parlamentare është i njohur dhe është shumdemokratike sistemi i lobimit në sjelljen e ligjeve dhe kjo ka rëndësi ndoshta edhe për praktikën tonë parlamentare, për arsye se institucionet që mund të jenë edhe jashtë qeverisë ose ministrive të angazhohen sa më shumë që ne t'kemi ligjet që sferat e jetës t'i organizojmë në mbështetje të ligjshme e të tjera.

Prandaj, edhe ky ligj që sot e kemi në shqyrtimin e parë në parim më ngjanë në atë formë për arsye se pa një sistem lobimi që vjen nga kryeinspektori sanitar i Kosovës, me shumë të drejtë që përkrahet nga Minsitria e Shëndetësisë dhe Qeveria dhe na sillen neve këtu para. Por, gjatë shqyrtimit të ligjit, domethënë bie në sy një tendencë e centralizimit të kompetencave dhe të organizimit në këtë drejtim. Pra, inspektorati sanitar i Kosovës në përgjithësi largohet pra edhe prej kompetencës komunale të kësaj administrate lokale, e cila është drejtpërdrejt, pra në kontakt të drejtpërdrejt me të gjitha sferat që merret. Së fundi, dikush këtu nga deputetët tha se kjo veprimtari do të duhej të rregullohet paraprakisht me ndonjë ligj tjetër, pra të inspektorateve apo diçka të ngjashme, por unë mund t'ju them se inspektorët sanitar edhe në nivele komunale sot punojnë dhe kanë një kujdes për aq sa kanë mundësi profesionale, kapacitete gjithashtu materiale që bëjnë kontrollin e të gjitha këtyre sferave të jetës.

Prandaj, do të doja që në pjesën e organizimit të inspektoriatit sanitar të Kosovës, para se gjithash të shikohen edhe implikimet buxhetore të një centralizimi të tillë të organizimit të inspektoratit dhe në anën tjetër, gjithësesi në këtë strukturë, të jetë inspektoriatit sanitar komunal.

Në anën tjetër, gjatë leximit të neneve tjera, për shembull – nuk specifikohet inspektori ose shefi i inspektorëve, bën planifikimin dhe mbledhjen e mostrave të ushqimit dhe ujit; ku i dërgon ato, çfarë bën me to. T'ua sjell një shembull që ka qenë mjaft problemati dhe medial kur flitej për mundësinë e pranisë së gentamicinës ose garamicinës në qumështin e importuar, shiqoni. Dhe kjo analizë do të duhej të shkojë të bëhet në Shkup ose kudoqoftë në vendet tjera të rajonit dhe besoni ose të besojmë ne në besueshmërinë e këtyre hulumbimeve, kur ekzistojnë mundësi edhe tjera pra të nxjerret si rezultat qoftë përmes rrugëve e kanaleve tjera.

Në anën tjetër flitet për një inspektor në 15 mijë deri në 25 mijë banorë. Ju lutem ne kemi rajone që kanë edhe 500 mijë banorë, prandaj përpjestoni dhe shihni sa do të jetë numri i inspektorëve por edhe në nivel të një komune.

Së fundja do të ngreh këtu në potencim ligjet e zbatueshme, nenin 38. Ju lutem ky ligj tejkalon thotë të gjitha dispozitat e ligjit të aplikueshëm që janë në kundërshtim me këtë ligj. Në qoftë se ai ligj i aplikueshëm nuk ka dispozita në kundërshtime me këtë ligj, domethënë mbetet edhe më tutje në fuqi.

Mendoj se ky ligj duhet të begatohet, të amendamentohet si duhet dhe të plotësohet duke qenë i plotëfuqishëm pavarësisht të ligjeve paraprake dhe t'i hedhë ato si papërdorshme. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputetin. Falënderojmë të gjithë deputetët për kontributin e tyre. Përkujtojmë përfaqësuesin e Qeverisë nëse dëshiron t'i drejtohet Kuvendit përsëri me vërejtjet tjera, ka mundësinë. Nëse jo, atëherë konstatojmë se Kuvendi ka kuorum të nevojshëm, prandaj edhe mund ta hedhim në votim, do të thotë në votim në parim të Projektligjit për inspektoratin sanitar të Kosovës.

Kush është për? Qart shihet, është shumica dërrmuese.

Kush është kundër? 13 vota kundër.

A abstenon ndokush? Nuk abstenon askush.

Konstatohet se Kuvendi i Kosovës, e përsëris i Kosovës, e miraton në parim Projektligjin për inspektoratin sanitar.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- | | |
|------------------------------------------|-----------------------------|
| - Për – Za – For..... | Shumica – Vecina – Majority |
| - Kundër – Protiv – Against..... | 13 |
| - Abstenime – Uzdrzanih – Abstained..... | 00..... |

Kalojmë në pikën e fundit për këtë seancë: Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 25 shtator 2003.

Së pari si njoftim. Ju jeni njoftuar se për seancën e ardhshme, do të thotë vijuese, është paraparë shqyrtimi i dytë i Projektligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe mjedisit të punës dhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Sot ne kishim një debat, të cilin nuk e përfunduam dhe në Kryesi do të shqyrtohet pastaj kur do të vjen në rend të ditës vazhdimi i saj.

Fjalën e ka kërkuar zonja Brovina, pastaj zoti Lirak Çelaj.

FLORA BROVINA:

Para se ta aprovojmë rëndin e ditës për mbledhjen e ardhshme, unë kujtoj se duhet ta zgjidhim – çka ndodhi me pikën numër 1, kur do të raportohet, domethënë a u formua komisioni, a u nxorr ndonjë rezyme nga pika numër 1 që u debatua deri tani.

Së dyti, propozoj që ky Kuvend të formojë një komision ad hoc i cili do të analizonte të dhënat se çka ndodhi në Burgun e Dubravës, ku vdiqën pesë të burgosur, dhe t'na jipet përgjigja. Domethënë... komision parlamentar ad hoc? Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë zonjën Brovina. Unë jam i obliguar të bëj një sqarim, aq sa mund të bëj. Së pari, për pikën e parë Kuvendi vendosi me votë. Është e drejtë e deputetëve pastaj që të kenë qëndrimet e tyre dhe t'i shqyrtojmë. Për idetë për të

formuar komisione, mund të merret në konsideratë, por ka edhe forma të tjera të cilat mund të adresohen dhe të shtrohen çështjet do të thotë me procedurë të rregullt me shkrim ose përmes përfaqësuesve në Kryesi. Zakonisht, çështjet që konsiderohen të n gutshme, është e u dhës të shtrohen në fillim të se ancës k ur flitet për rendin e ditës, natyrisht nëse krijohet hapësirë për të. Deputeti Lirak Çelaj e ka fjalën.

LIRAK ÇELAJ:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë,

Unë pata të njëjtin shqetësim si Flora, do të thotë nuk po e përsëris, për pikën e parë, por unë po insistoј që kjo të futet medoemos qysh tash në rend dite për mbledhjen e ardhshme dhe të mos zhagitet çështja e sigurisë dhe e deklaratës që u morëm vesh që grupet parlamentare ta nxjerrin. Sepse, kam frik se kjo pastaj do të zhagitet dhe pastaj do të devalvohet edhe vetë rëndësia e këtij dokumenti. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka deputetja Stojanka Petković dhe pas saj e ka kërkuar fjalën deputeti Rangjell Nojkiq.

STOJANKA PETKOVIĆ:

Ja bih zamolila da sa sledlećeg sastanka zakon o radu odložimo za još jednu nedelju dana zato što suviše malo vremena imamo. Komisija nije obradila taj zakon. Drugo, što se tiče funkcionalne komisije a ni ostale komisije još uvek nisu imali to na svojim sastancima i nemamo njihove amandmane. Potom nije ni uskladena verzija engleske – albanske i srpske, tako da mislim da taj zakon ne bi bio spreman za iduću sednicu. Hvala.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputeten. Unë dëshiroј të shfrytëzoј rastin edhe për t'ju njoftuar se edhe në mbledhjen e fundit të Kryesisë, Kryesia ka marrë qëndrim që amendamentet të shqyrtohen dhe të procedohen me kohë, sipas rregullores, pesë ditë para se të shqyrtohen në seancë plenare, përndryshe nuk do të merren në shqyrtim. Do të shqyrtohet propozimi në Kryesi dhe pastaj do të merret qëndrimi adekuat. Deputeti Nojkiq.

RANDEL NOJKIĆ:

Gospodine predsedniče! Dame i gospodo. Mi smo danas imali...? Mi smo danas imali debatu po prvoj tački dnevnog reda koja nije završena. Završena onako kako je završena, mislim da je napravljena jedna, u nizu presedana, razumete, jedna diskriminacija da ne može da se o tome diskutuje, a ono što je interesantno – mi danas usvajamo dnevni red za narednu sednicu i ja ne vidim da će ta tema da se nastavi. Ovde, vi ste trebali da predložite, razumete, nastavak te teme... Ostalo je apsolutno jedno konfuzno stanje zapravo, kakvi su zaključci, šta je rešeno po tom pitanju, da li ćemo u opšte razgovarati i kada ćemo razgovarati. Mislim da, pošto je procedura takva kakva jeste, vi znate kad god mi predložimo dnevni red, vi kažete a to ste trebali ranije, pa je to trebalo radno predsedništvo... odnosno Predsedništvo Skupštine da o tome razgovara. Evo ja iniciram da Predsedništvo Skupštine Kosova i metohije, na narednoj sednici ponovo stavi tačku dnevnog reda prvu o kojoj smo danas razgovarali. Hvala.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju lutem vetëm një sqarim, deputetë të nderuar. Jemi në pikën në të cilën shqyrtohet ose më mirë të them Kuvendi informohet me rendin e përcaktuar të mbledhjes së ardhshme. Sipas procedurës, mund të kundërshtohet ndonjë nga pikat dhe atëherë ka një procedurë. Por nuk është tash koha kur duhet të propozohen pika të reja. Ne mund të bëjmë si të doni ju, por nuk është në rregull. Prandaj, ju lutem që të rrespektohet rregullorja dhe propozimet të bëhen me shkrim siç është paraparë procedura.

Që të mos gjenerojmë diskutim pas diskutimi, unë propozoj që të dëgjojmë edhe dy paraqitje, që janë të paraqitur zoti Kelmendi dhe zoti Tomë Hajdaraj dhe me kaq të mbyllet. Është e drejtë e tyre, ju lutem të mos më përziheni... Dhe, ju lutem në kuadër të procedurës dhe të rregullores që të mos... Është mundësia që të jetë ashtu, por megjithatë deputetëve s'do t'ua marr fjalën, ju lutem.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra. Unë kërkoj falje nga të gjithë që janë prezent që dola, por jam i shtyer të dal sepse situata që sot u trajtua në pikën e parë politike dhe e sigurisë në Kosovë nuk u theksua aspak situata e cila është jashtëzakonisht dramatike në qytetarin e Mitrovicës dhe në pjesën veriore që ka të bëjë me 18.83 përqind të territorit. Atje, pa lejen e organeve komunale, por me miratimin e bashkësisë ndërkombëtare ka filluar të ndërtohet kisha ortodokse në mesin e shqiptarëve, aty ku nuk lejohen të kthehen 26.830 shqiptarë refugjat në pjesët tjera të Kosovës. Besoj se është e arsyeshme

për këtë çështje edhe të diskutohet në Kryesi të Kuvendit edhe në mekanizmat tjerë të institucioneve të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit. Urdhëroni zoti Hajdaraj dhe me kaq mbyllim ju lutem këtë pikë.

TOMË HAJDARAJ:

Zoti kryesues, meqenëse kryesuesja e Komisionit parlamentar për mirëqenie sociale tha se nuk kemi mundësi ta përgatisim ligjin për lexim të dytë, në emër të Komisionit parlamentar për bujqësi, kisha dëshiruar që për mbledhjen e ardhshme, domethënë për sot një javë të futet në procedurë leximi i parë i ligjit mbi pesticidet, ligj i cili është veç i përgatitur bukur mirë dhe kemi kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të mundësojë që ky ligj me të vërtetë të vjen duke patur parasysh rëndësinë e tij.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Të falemnderit. Kryesia do t'i ketë në shqyrtim këto.

Me kaq mbyllim seancën. Seanca e ardhshme është sipas rendit të entjen dhe lidhur me këtë do të informoheni përmes Kryesisë. Ju falemnderit.

Seanca përfundoi punën në orën 14,00